Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 10 (171) / TETOR 2020. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË.

REPORTAZH

Një ditë me nxënësit e shkollës 9 vjeçare “Hasan Leka”

Nga **ZABIT LLESHI, SHAQIR SKARRA** — Faqe 9

PROFIL

Pesëdhjetë vjet me penë, me pasion dhe përkushtim të epërm...

Nga **DUKAGJIN HATA** — Faqe 14

BOTIME

Bashkim Lleshi boton librin “Një jetë maleve - 3”

— Faqe 19

HOMAZH

Naim Buci, ikja e një njeriu që e deshi shumë Lurën dhe Dibrën

— Faqe 21

Bechtel kërkon Skavicën përmes ndihmës së qeverive



Pamje nga Lugina e Drinit të Zi, e cila do të mbulohet nga ujërat e Skavicës. Foto: *Hajredin Toca*

- **RAMA: Ky memorandum... do të fusë në rrugën përfundimtare të realizimit një ëndërr 50 vjeçare, që është ndërtimi i HEC-it të Skavicës. Gjë që e kthen Shqipërinë nga një vend i pasur në burime hidroenergjitike, por i varur në vijimësi nga moti dhe nga importi, në një vend sovran në aspektin e prodhimit të energjisë”, tha kryeministri Rama në ceremoninë e nënshkrimit të marëveshje**
- **KRACH: Ky projekt historik do të jetë një pasuri kombëtare për popullin e Shqipërisë dhe një që vazhdon të ndërtohet mbi lidhjet tona tashmë të ngushta”.**
- **SHANO: Skavica duhet të ketë një projekt që mbron mjedisin në afatgjatë, e mbi të gjitha duhet të jetë një projekt model sa i përket kompensimit të pronës private, dhe rentës që duhet të përfitojnë bashkitë që preken nga kjo vepër.**

— Faqe 3

OPINIONE

Rebelohu Dibër në shekullin e ri!

Nga **SHEMSI PRENÇI** — Faqe 4

Amerikë! Ku do i çosh dyzetmijë dibranë?

Nga **ABDURAHIM ASHIKU** — Faqe 4

RECENSË

Metamorfoza e Kamber Farrukut në librin e tij “Kur shkriheshin akujt”

Nga **AHMET PRENÇI** — Faqe 7

VEPRIMTARI

Aty ku e nisi...!

Gazetari sportiv Defrim Methasani, rikthehet në shkollën e mesme “Nazmi Rushiti” në Peshkopi, tashmë me një tjetër mision të tij të ri.

Nga **BUJAR KAROSHI** — Faqe 13

VEPRIMTARI

Në 60-vjetorin e lindjes Halil Rama promovon librin kushtuar vendlindjes

Nga **AGRON SEJAMINI** — Faqe 10

ETNOKULTURË

Dasma si një hapësirë publike

Nga **ALBAN TUFA** — Faqe 15

VËZHGIM NË TERREN: SI PO ECIN PUNIMET

Qeveria optimiste, Rruga e Arbrit hapet pas 6 muajsh

- **Balluku: Qeveria nuk ka detyrime të pashlyera ndaj kompanisë. Rruga do të përfundojë brenda afatit.**
- **Një vëzhgim në terren: Ja segmentet që kanë përfunduar dhe ku po punohet**

“Mes rrugëve që duhen përfunduar gjatë 2021 është Rruga e Arbrit, e cila do të përfundojë përpara afatit të parashikuar”, tha Ministrja e Infrastrukturës Belinda Balluku, gjatë një analize vjetore mbi Infrastrukturën të mbajtur më 21 tetor 2020. Si një garanci se veprat infrastrukturore do të përfundojnë në afat, ajo theksoi se “është e rëndësishme që për të gjitha këto vepra Qeveria Shqiptare nuk ka detyrime të pashlyera duke i dhënë fund një praktike të hasur jo shumë vite më parë”. Një javë më pas, më 27 tetor, gjatë një konference për shtyp, kryetari i PD-së, Lulzim Basha, tha se “qeveria shqiptare kishte paguar sot (27 tetor) 3 milion euro nga thesari për një kontratë me kosto dyfishe për PPP-në në rrugën e Arbri”.



— Faqe 2

NË BRENDËSI:

- Bijtë që nderojnë vendlindjen...
- Rrëfime nga një profesor i gjeologjisë
- Mbi aktivitetin e Sefedin Pustinës dhe Aqif Lleshit
- Përjetësisht bashkë
- Vendimi i Komisionerit: Albchrome i shkarkoi minatorët për shkak të angazhimit sindikal
- Kriza e kromit, dhjetra minatorë në Bulqizë të papaguar prej muajsh bojkotojnë punën
- Golloborda dhe Dibra, një ngulmim për të krijuar një panoramë sa më të plotë dhe sa më të qartë njohëse historike
- Kujtime për Gani Metën
- Dëshmorët e Dovolanit
- Një homazh për mësuesin dhe oficerin Rushdi Spata

Rruga e Arbërit rrugaearberit

Redaksia falenderon zotin **Muharrem Gjoka** për donacionin prej 100 Euro dhënë për botimin e gazetës!

Për më shumë informacion: Tel: 00455 68 65 08 441. Email: rrugaearberit@gmail.com | www.rrugaearberit.com +355 **68 65 08 441** +355 **69 20 68 603**

cyan magenta yelloë black 1

Rruga e Arbërit nr. 171

Gazeta “Rruga e Arbërit” është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Qeveria optimiste, Rruga e Arbrit hapet pas 6 muajsh



Pamje nga ura e re e Vashës 24 Tetor, 2020

Balluku: Qeveria nuk ka detyrime të pashlyera ndaj kompanisë. Rruga do të përfundojë brenda afatit.

Një vëzhgim në terren: Ja segmentet që kanë përfunduar dhe ku po punohet

“Mes rrugëve që duhen përfunduar gjatë 2021 është Rruga e Arbrit, e cila do të përfundojë përpara afatit të parashikuar”, tha Ministrja e Infrastrukturës Belinda Balluku, gjatë një analize vjetore mbi Infrastrukturën të mbajtur më 21 tetor 2020. Si një garanci se veprat infrastrukturore do të përfundojnë në afat, ajo theksoi se “është e rëndësishme që për të gjitha këto vepra Qeveria Shqiptare nuk ka detyrime të pashlyera duke i dhënë fund një praktike të hasur jo shumë vite më parë”.

Një javë më pas, më 27 tetor, gjatë një konference për shtyp, kryetari i PD-së, Lulzim Basha, tha se “qeveria shqiptare kishte paguar sot (27 tetor) 3 milion euro nga thesari për një kontratë me kosto dyfishe për PPP-në në rrugën e Arbri”.

“Monitor”, një revistë me fokus ekonominë, shkruan gjithashtu se edhe gjatë vitit të ardhshëm, kompania “Gjoka Konstruksion” do të marrë “pagesën më të lartë është për koncesionin e rrugës së Arbrit, që është në ndërtim e sipër, me 4.1 miliardë lekë të parashikuara”.

Kontrata për ndërtimin e Rrugës së Arbrit është miratuar nga Këshilli i Ministrave më 28 mars 2018. Afati i punimeve parashikohej të zgjaste 44 muaj dhe koncensioni parashikohej për një periudhe 13-vjeçare nga data e nisjes së punimeve.

Punimet nisën zyrtarisht në Klos më 17 qershor 2018, ku në ceremoninë e rastit, presidenti i kompanisë ndërtuese “Gjoka Konstruksion” premtoi se punimet do të mbarojnë brenda 2 vitesh, në pranverë 2021.

Këtij premtimi i ka qëndruar edhe kryeministri Rama, sa herë ka publikuar informacione mbi ecurinë e punimeve.

Në një video nga punimet e publikuara muajin e kaluar, theksohej se në rrugë janë realizuar mbi 60% e punimeve.

Gjatë punimeve ka pasur probleme me Tunelin e Murrizit, e cila është e vetmja vepër që nuk ka informacione të dukshme mbi ecurinë e saj.

Tuneli i nisur në fillim u shemb vitin e kaluar, duke e detyruar kompaninë të hapë në kantier tjetër në Bastar, punimet e të cilit thuhet se po ecin ngadalë, për shkak të terrenit të rrëshqitshëm.

Nevoja për të mbajtur premtimet e ka detyruar kompaninë në vazhdojë punën me një by-pass, 9.5 km të gjatë, e cila do të ndihmojë që rruga të hapet për trafikun në afatin e premtuar, pranverë 2021.

NJË VËZHGIM NË TERREN: SI PO ECIN PUNIME

Disa bashkëpunëtorë të gazetës kanë realizuar muajin e fundit një vëzhgim në terren për ecurinë e punimeve.

Segmenti 1, i cili fillon në dalje të Tiranes, aty ku mbaron rruga ekzistuese, dhe përfundon tek Ura e Brarit, me gjatësia 1.153 km është akoma në fazë ndërtimi.

Segmeni 2, nga Ura e Brarit deri në Zall Bastar, me gjatësi 5.46 km është hapur tërësisht si dhe në më shumë se gjysmën e segmentit është hedhur një shtresë asfalti. Kjo rrugë aktualisht është e hapur për qarkullimin e mjeteve që lidhin këto fshatra me Tiranën.

Segmenti 3, i cili fillon nga Zall Bastar deri te dalja e Urës së Vashës, me gjatësi 23.188 km është në ndërtim e sipër. Në këtë segment, 9.5 km, që përfshin By-passin është hapur dhe pothuajse është e shtruar me asfalt. Ndërsa vazhdojnë punimet nga hyrja e Tunelit në Xibër në drejtim të Urës së Fshatit Fshat. Në këtë segment është përqendruar edhe puna më e madhe aktualisht.Në një pjesë të këtij segmenti, në hyrje të Tunelit të Murrizit nga ana e Tiranës, ka pësuar muajin e fundit një rrëshqitje e dherave që ka krijuar probleme për ecurinë e punimeve. Ky segment duket se është më vonë me punimet, por një inxhinier i kompanisë, në kushtet e anonimatit, i tha gazetarit tonë se “aktualisht po punohet dhe me këtë ecuri, ky segment do të jetë i mundur për trafikun sipas afatit të premtuar”. Në këtë segment, gjithashtu, është përfunduar Ura e Vashës dhe inxhinierët e kompanisë thonë se brenda muajit janar do të bëhet e mundur edhe përfundimi i Urës së fshatit Fshat. Kjo e fundit është e vetmja vepër e rëndësishme arti e papërfunduar. Të gjithë urat dhe tunelet e vegjël në aksin e rrugës, janë përfunduar.

Në segmenti 4, nga dalja e Urës së Vashës deri në Bulqizë, me gjatësi 9.715 km, traseja është e hapur që në vitin 2013. Aty nuk ka pasur punime shtesë, por mendohet se me një përqendrim të punës në një afat të shkurtër, ajo do të jetë e gatshme për trafikun në prill 2021.

Segmenti 5, që është nga Bulqizë deri te Ura e Çerenecit, me gjatësi 20.12 km, konsiderohet i përfunduar që në vitin 2011.

Segmeni 6, që lidh Urën e Çerenecit me rrugën Maqellarë-Pika kufitare Bllatë, me gjatësi 9.1 km ka përfdunaur dhe është hedhur shtresa e asfaltit. Aktualisht ky segment, pavarësisht se rruga nuk është pajisur me sinjalistikën përkatëse, është e hapur për trafikun. Gjithashtu, është hapur edhe segmenti lidhës nga Maqellarë për në pikën doganore të Bllatës.

Qeveria shqiptare ka hapur së fundmi edhe procedurat për shpronësimet në segmentin nga Grazhdani në Peshkopi, ndërtimi i së cilës pritet të fillojë vitin e ardhshëm.

(Korresp. Rr.A.)



Pamje nga ura e Fshatit Fshat, në ndërtim. 24 Tetor, 2020

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur. Nr. 10 (171). Tetor 2020
Gazeta doli nga shtypi, 4 nëntor 2020.
Gjendet në treg gjatë gjithë muajit nëntor 2020.

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN “ë”.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Editor i faqes online: Agim Deva

Kontribuan për këtë numër:
Osman XHILI
Abdurahim ASHIKU
Avni ALCANI
Leonard VEIZI
Ballsor HOXHA
Bajram XHAFA
Arif MURRJA
Haki Përnezha
Mevlud BUCI
Nazmi KOÇI
Halil RAMA

Redaksia falenderon përzemërsisht zotin **Muharrem Gjoka** për donacionin prej 100 Eurosh dhënë për gazetën.

KËRKOHEN KORRESPONDENTË NË PESHKOPI DHE DIBËR TË MADHE

Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.
Të interesuarit të shkruajnë email
në adresën <rrugaearberit@gmail.com>
ose të telefonojnë në numrin
069 20 68 603.

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t’i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit
<rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t’i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Adresa e gazetës:
Rr. “Zenel Baboçi”,
Pall. “Ferar”, Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë
Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

VARIANTIN A: Kosto e ndërtimit - 308 milionë euro, nga të cilat 58 milionë euro për shpronësime dhe infrastrukturë. Kuota e hidrocentralit është 388 metra mbi nivelin e detit, lartësia e digës 92 metra

VARIANTIN B: Kosto e ndërtimit - 510 milionë Euro, nga të cilat 160 milionë euro për shpronësime dhe infrastrukturë. Kuota e hidrocentralit është 443 metra mbi nivelin e detit, lartësia e digës 147 metra.

Bechtel kërkon Skavicën përmes ndihmës së qeverisë shqiptare dhe asaj amerikane

Më 3 tetor në Tiranë u nënshkrua një memorandum Bashkëpunimi Ekonomik mes Shqipërisë dhe SHBA, i cili u firmos për palën shqiptare nga Ministrja e Financave dhe Ekonomisë, Anila Denaj dhe për palën amerikane nga Nënsekretari i Shtetit për Rritjen Ekonomike, Energjinë dhe Mjedisin, Z. Keith Krach.

Një nga pikat më të rëndësisshme të marrëveshjes ishte marrëveshje me kompaninë amerikan Bechtel për ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës.

"Memorandumi që nënshkruajmë sot për Bashkëpunimin Ekonomik mes Shqipërisë dhe SHBA-së faktikisht do të ndikojë ndjeshëm në hapjen e nje kapitulli të ri për investimet e drejtëpërdrejta, jo vetëm amerikane, por në tërësi të huaja në Shqipëri. Do të rrisë eksportet shqiptare, duke përmirësuar ndjeshëm bilancin tregtar dhe do të fusë në rrugën përfundimtare të realizimit një ëndërr 50 vjeçare, që është ndërtimi i HEC-it të Skavicës. Gjë që e kthen Shqipërinë nga një vend i pasur në burime hidroenergjitike, por i varur në vijimësi nga moti dhe nga importi, në një vend sovran në aspektin e prodhimit të energjisë", tha kryeministri Rama në ceremoninë e nënshkrimit të marëveshjes.

Më pas Kryeministri falenderoi nënsekretarin Krach për angazhimin e tij personal për të nxitur bizneset që të vazhdojnë në këtë proces, "ku qeveria amerikane hedh hapin e parë, duke u futur vetë përmes këtij Memorandumi dhe duke u angazhuar vetë për të mbështetur me ekspertizën e vet, me teknologjinë amerikane dhe patjetër për financimin, gjë për të cilën do të punojmë bashkërisht, – ndërtimin e Skavicës, në mënyrë që të tjerët të vazhdojnë të ndjekin këtë shembull".

Në fjalën e tij, Keith Krach, Nënsekretari i Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillimin Ekonomik, Energjinë dhe Mjedisin tha se "drita e investimeve të huaja, veçanërisht për firmat në Shtetet e Bashkuara, do të krijojnë vende puna më të mira, mundësi më të mira për të rinjtë në Shqipëri e do të ndihmojnë në krijimin e një mjedisi më të mirë biznesi".

"Jam i entuziazmuar të dëshmoj nënshkrimin e një marrëveshje mes kompanisë më të madhe të ndërtimit të Amerikës, Bechtel dhe Shqipërisë për ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës", theksoi Krach.

"Ky është një projekt ambicioz, shumë i nevojshëm, që të ofrojë siguri energjetike dhe përfitime mjedisore për Shqipërinë. Nuk mendoj që mund të kishit zgjedhur një partner më të mirë për hidrocentralin tuaj, sesa firma që ndërtoi digën më të famshme në SHBA, digën Hoover dhe projekte të tjera të famshme të ndërtimit.



Një foto pas nënshkrimit të memorandumit të bashkëpunimit.



Paje nga fshati Fushë Alie, i cili përmbytet në të dy variantet e ndërtimit të Skavicës.

Sakavica do t'i sjellë Shqipërisë energji të pastër shtesë, që do të reduktojë përmbytjet, do ta bëjë prodhimin e energjisë shqiptare më pak të varur nga reshjet vjetore të shiut.

Sakavica do t'i sjellë Shqipërisë energji të pastër shtesë, që do të reduktojë përmbytjet, do ta bëjë prodhimin e energjisë shqiptare më pak të varur nga reshjet vjetore të shiut, sikurse ndatë më herët me mua. Ky projekt historik do të jetë një pasuri kombëtare për popullin e Shqipërisë dhe një që vazhdon të ndërtohet mbi lidhjet tona tashmë të ngushta".

Po në të njëjtën ditë, Ministrja e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku dhe përfaqësuesi i kompanisë Bechtel, Justin Siberell, President i Rajonit të Europës dhe Lindjes së Mesme, në prani të kryeministrit Edi Rama dhe Nënsekretarit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillimin Ekonomik, Energjinë dhe Mjedisin, Keith Krach, nënshkruan Memorandumin e Mirëkuptimit për Bashkëpunimin në lidhje me Projektin e HEC Skavicë.

"Projekti i Qeverisë Shqiptare për ndërtimin e Hidrocentralit të Skavicës ka gjetur mbështetjen e Qeverisë Amerikane, e cila ka shprehur angazhimin e drejtpërdrejtë, për të mbështetur Shqipërinë në këtë iniciativë kaq të rëndësishme", thuhet në deklaratën për shtyp të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Sipas njoftimit të MIE, "në dokumentin e nënshkruar theksohet rëndësia e Projektit të HEC Skavica, si një projekt me interes kombëtar, i cili do të mundësojë që Shqipëria të krijojë pavarësi të plotë nga importimi i energjisë dhe do ta pozicionojë vendin tonë si si qendër energjie për rajonin".

"Memorandumi vlerëson përvojën unike dhe të zgjeruar të Bechtel në projektimin dhe zbatimin e zgjidhjeve inxhinierike novatore si dhe të financimit të nevojshëm për realizimin e këtij projekti kompleks, zgjidhje të cilat nuk janë zbatuar ende në Shqipëri".

"Përmes nënshkrimit të këtij Memorandumi Bashkëpunimi, palët angazhohen të punojnë së bashku në të gjitha fazat e këtij procesi për të gjetur zgjidhje të përshtatshme për realizmin e këtij projekti me rëndësi kombëtare. Palët kanë shpehur interes gjithashtu, që krahas bashkëpunimit të tyre në fushat e projektimit dhe zbatimit të punimeve, të trajtojnë edhe financimin e duhur të Projektit, që të jetë i pranueshëm për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë".

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe kompania Bechtel do të përgatisin dhe miratojnë bashkarisht Planin e Veprimit për zbatimin e Projektit, i cili do të përfshijë edhe statusin aktual të dokumentacionit teknik të projektit, planin e veprimtarive të projektit, modelet e propozuara të financimit, drejtuesit e veprimtarive të projektit dhe afatet për zbatimin e suksesshëm të Projektit.

Kryeministri Rama e dha lajmin në një postim në Facebook, ku shkruan se "Projekti i HEC-it të Skavicës është një ëndërr gjysëmshekullore që do ta realizojmë me miqtë amerikanë dhe përmes këtij investimi madhor me ekspertizë, financim e teknologji amerikane, do ta pavarësojmë Shqipërinë nga importi i energjisë dhe do të hyjmë në një fazë të re për Shqipërinë që Duam".

Lajmi për nënshkrimin e marërveshjes u bë publike një ditë më parë, më 2 tetor, gjatë një konference shtypi të kryeministrit të Shqipërisë Edi Rama dhe atij të Kosovës, Abdulla Hoti. Në këtë takim, përveç entuziazmit të kryeministrit shqiptar për nënshkrimin e marrëveshjes me Skavicën, bëri të ditur edhe përfshirjen e qeverisë së Kosovës në këtë projekt, kryesisht me bashkëpunimin në fushën e energjisë, pasi diversifikimi i burimeve mes dy vendeve, mbetet një treg për t'u integruar bashkërisht me shumë poetencial të madh.

Skavica duhet të ketë një projekt që mbron mjedisin në afatgjatë, e mbi të gjitha duhet të jetë një projekt model sa i përket kompensimit të pronës private, dhe rentës që duhet të përfitojnë bashkitë që preken nga kjo vepër.

KUNDËRSHTITË

Drejtuesit e shoqatës "Për Mbrojtjen e Pellgut të Drinit të Zi" e kanë kundërshtuar nënshkrimin e kësaj marrëveshje. Kryetari i saj, Nazmi Drizi, tha përmes telefonit se ne as nuk do të pranojmë dhe nuk do të njohim asnjë marrëveshje të nënshkruar nga qeveria shqiptare, mbi të cilën nuk është firma e banorëve".

Drizi tha se po organizohen për nisjen e protestave të vazhdueshme, në Dibër dhe Tiranë, madhe edhe para ambasadës amerikane, por kjo është penguar deri më tani nga policia.

"Për shkak të kushteve të vendosura në situatën e pandemisë, policia nuk na ka lejuar takimet publike, por së shpejti ne do ti nisim ato, duke shkelur në çdo fshat, në në çdo shtëpi. Përmbytja e Dibrës është e papranueshme".

Dritan Shano, një nga ekspertët e ekonomisë në vend, në një status në Facebook më 4 tetor, shkroi se "deri më tani nuk ka investitorë amerikanë në këtë projekt."

"Investitorët në Skavicë janë Shqiptarët - buxheti i shtetit; zbatuesi është amerikan - Bechtel", shkruan Shano.

"Që të bëhet Skavica nuk ka ndonjë gjë të keqe. Shqipëria derdh në det 1800 m3/s dhe akoma nuk i plotëson nevojat e veta për energji, si dhe nuk ka ujë të pishem 24 orë në rubinet. Por, mendoj se meqenëse jemi në shekullin e 21, Skavica duhet të ketë një projekt që mbron mjedisin në afatgjatë, e mbi të gjitha duhet të jetë një projekt model sa i përket kompensimit të pronës private, dhe rentës që duhet të përfitojnë bashkitë që preken nga kjo vepër", shkruan Shano mes të tjerash në statusin e tij në Facebook.

Qeveria shqiptarë bëri publikë në qershor dy variantet e ndërtimit të HEC të Skavicës.

Në variantin A, kosto e ndërtimit do të jetë 308 milionë euro, nga të cilat 250 milionë për ndërtimin dhe 58 milionë euro për shpronësime dhe infrastrukturë. Në këtë variant kuota e hidrocentralit është 388 metra mbi nivelin e detit, 92 metra lartësia e digës, 17.6 km2 sipërfaqja e rezervuarit, 326 milion metër kub ujë, me fuqi instalimi 120 MW dhe prodhim vjetor 479 GHh.

Në variantin B, kosto e ndërtimit parashikohet në 510 milionë Euro, nga të cilat 350 milionë për ndërtimin dhe 160 milionë euro për shpronësime dhe infrastrukturë. Në këtë variant kuota e hidrocentralit është 443 metra mbi nivelin e detit, 147 metra lartësia e digës, 54 km2 sipërfaqja e rezervuarit, 2319 milion metër kub ujë, me fuqi instalimi 210 MW dhe prodhim vjetor 915 GHh.

Ndërkohë që thotë se "ky projekt do të sigurojë optimizimin e Kaskadës së Drinit, eliminimin e përmbytjeve në zonën e fushë Shkodrës dhe fushë Lezhës, si dhe rritjen e sigurisë dhe efiçencës në veprat hidrike në HEC-et ekzistuese të kaskadës", ajo nuk thotë asgjë për përmbytjen e luginës së Drinit të Zi dhe humbjet që i vijnë popullatës dhe mjedisit nga kjo.

"Ne jemi të ndërgjegjshëm se alternativa më e madhe në fakt përmbyt një sipërfaqe të madhe, por sigurisht është një proces konsultimi, shpronësimi dhe bashkëpunimi mund ti japë një opurtinitet më të madh zonës", tha drejtori i KESH Benet Beci në prezantimin e projekteve pesë muaj më parë.

Pas kësaj deklarate qeveria nuk ka dhënë asnjë të dhënë për shpronësimet, shpërnguljet e banorëve, infrastrukturën e nevojshme dhe të ardhmen e banorëve që preken nga shpërngulja.

BUJAR KAROSHI

Rruga e Arbërit nr. 171

opinion



Një shtëpi në Fushë-Alie, që do të mbytet nga HEC i Skavicës.

Ku do i çosh dyzetmijë dibranë?

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

Sarkazëm
Lajmi u dha...
Jo me gojë si Rama din të llapë...
As në efir...
I shkruar...
E zezë mbi të bardhë...
Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të ndërtojnë Hidrocentralin e Skavicës...
Do të mbysin 65 kilometra katrore tokë, ara nga më pjelloret në Shqipëri, pyje e kullota.
Do të shkulinthemelesh dyzetmijë familje dibrane...
Me pleq, plaka, burra, gra, fëmijë...
Me lopë, kuaj, dele, gomarë, pula, dhi...
Me varre të parësh që ranë në beteja që Serbo-Jugosllavia të mos dalë në:
Drinin e Zi...
Qafën e Buallit...
Qafën e Murrës...
Qafën e Mërkurthit...
Për të vazhduar drejt Durrësit e Shëngjinit...
Skavicën mund ta ndërtonte Enveri...
Ta mbyste Dibrën...
Një Dibër tjetërtë ndërtonte...
Siç ndërtoi Ulzën në Mamurras, Kukësin në Fajza, Darëzezën në bregdetin e Fierit...
Nuk e ndërtoi...
Nuk e ndërtoi as italiani, as kinezi, as...
I trembeshin Dibrës...
Amerika do ta ndërtojë...
U tha me germa të zeza mbi letër të bardhë.
Amerika nuk i trembet Dibrës...
E shpërngul me të gjitha...
Shkul nga vendi dyzetmijë familje dibrane...
Me pleq, plaka, burra, gra, fëmijë...
Me lopë, kuaj, dele, gomarë, pula, dhi...
Dhe i ngul në... Amerikë...
Pak toka ka Amerika...
...në Alaskë?
Rruga është e hapur...
Mjafton lëshimi i vizave...
Dhe Alaska hap dyert e vilave...

* * *

Passhkrim: Dibranët, më shkruante më 14 shkurt 2010 Argëtim Fida - kryetar i komunës së Dibrës në Maqedoni,nga ndërtimi i liqenit artificial të Shpiles nuk panë asnjë gjë të mirë për këto 40 vjet pos humbjes të rreth 5000 hektarë të tokës më pjellore dhe që vaditej nga dy lumenj, burimi kryesor i ekzistencës të numrit më të madh të familjeve dibrane.

Sot të mirat nga prodhimi i rrymës përfitohen vetëm nga qeveria maqedone që nuk do të ja dijë nëse këto familje u detyruan të largohen në Turqi ose ShBA për të siguruar ekzistencën. (Marrë nga libri: "PO DIBRËS! JO SKAVICËS", faqe 162-163)

3 tetor 2020

Rebelohu Dibër në shekullin e ri!

Nga **SHEMSI PRENÇI ***

Prej 35 vitesh, Dibra dhe dibranët vazhdojnë të kërcënohen prej qeverive se: tokat e gjyshërve dhe baballarëve, do të mbulohen me ujin e Drinit të Zi dhe gjithë lumenjve të tjerë, që zbresin përgjatë maleve që lartësohen në lindje dhe në perëndim të luginës së Drinit..!

Kërcënimet e qeverive shqiptare, ngjasojnë tamam si kërcënimet e Sulltanëve të Turqisë, të cilët vërshonin drejt Dibrës për ta nënshtruar, por me një ndryshim se: ajo e kërcënon Dibrën dhe dibranët për ti pushtuar me ujë dhe jo me Hajredin Pashën e ushtrinë e tij...

Ditët e fundit kryeministri Rama, ka prezantuar projektin, për ta përmbytur Dibrën në dy variante, pjesërisht dhe tërsisht, por në çdo rast me një strategji për ta shuajtur Dibrën dhe historinë e Torviollit të Kastriotëve dhe gjithë Dibrës...

Po a janë shuar vërtet dibranët?

Këtë do e vërtetojë koha, ashtu si e ka vërtetuar ndër shekuj, reagimin e Dibrës dhe dibranëve për liri, pavarësi e dinjitet, në Dibër dhe në mbarë trojet Shqiptare.


Siç duket, dy Dibrat, të cilat janë kërthiza e Shqipërisë etnike, po paguajnë haraç! Kështu u veprua në vitet 1960 me Dibrën e Madhe në ish-Jugosllavi, duke ndërtuar hidrocentralin "Spile", liqeni i të cilit përmbyti zonën e Udovës, "Myzeqenë e Dibrës së Madhe".

Kjo situatë e rëndë shkaktoj migrimin dhe emigrimin masiv të dibranëve drejt Turqisë dhe vendeve të Evropës dhe SHBA.

Me gjithë kundërshtimet e popullatës, sistemi monist i ish-Jugosllavisë, ja bëri me qëllime të caktuara Dibrës, duke e gjunjëzuar me dhunë e duke futur nën ujë pjesën më të mirë të zonës dhe konkretisht Udovën, që nuk e kishin nënshtruar Turqit.

Po kështu, tani në "demokraci" filluan manovrat e qeverisë Maqedonase për të rrëmbyer lumin Radika në burim, për të furnizuar liqenin e Mavrovës e që prej andej edhe fuqizimin e prodhimit të hidrocentralit Vërtok në zonën e Gostivarit.

Dibranët dhe mbarë Shqiptarët kundërshtuan me protesta të forta në Dibër të Madhe, Peshkopi, Shkup e Tiranë dhe zbrapsën qëllimin ogurzi të ëndrrave sllavo-maqedonase për devijimin e ujërave të lumit Radika, ashtu si donin të bënin në vitet 1960-1970 me ujërat e Drinit të Zi, për ti devijuar drejt territorit Maqedonisë dhe për të mos u shfytëzuar nga Shqipëria dhe për të shkaktuar një katastrofë florës dhe faunës në luginën e Drinit të Zi në pjesën e Shqipërisë!



Siç duket, dy Dibrat, të cilat janë kërthiza e Shqipërisë etnike, po paguajnë haraç! Kështu u veprua në vitet 1960 me Dibrën e Madhe në ish-Jugosllavi, duke ndërtuar hidrocentralin "Spile", liqeni i të cilit përmbyti zonën e Udovës, "Myzeqenë e Dibrës së Madhe".

Ndaj, sot më shumë se kurrë, dibranët e dy Dibrave kudo që ndodhen, duhet të aktivizohen në protesta të fuqishme, kundër vendimeve të qeverisë Rama, për ti thënë, "JO" Skavicës dhe planit ogurzi të sllavo-maqedonasve dhe shërbëtorëve të tyre shqiptarë, të dashuruar me sllavët ndër shekuj, dhe për ti thënë një "PO" të fuqishme Dibrës dhe pasurive të saj.

Vetëm protestat masive popullore do të shmangin përmbytjen e të gjitha fshatrave të Dibrës së poshtme nga Zall-Reçi deri në fushat e Gjoricës, përfshi dhe Fushën e Torviollit, pjesë e historisë së Skënderbeut, Dibrës dhe shqiptarëve që sakrifikuan jetën për trojet shqiptare.

Të parët tanë jua kanë dalë shumë luftërave dhe kanë fituar, ndërsa ne sot nënshtrohemi edhe para tekave e qëllimeve të qeveritarëve të babëzitur, të cilët nuk e duan Dibrën, por e duan nën uji atë, ndërsa vetë bëhen aksionerë në veprat fitimprurëse edhe kur ata ndërtohen në tokat e gjyshërve tanë!

Kështu veproi edhe Enver Hoxha me tokat e Kuksit dhe qytetin e Kukësit të Vjetër, në vitet 1970-1980, kur ndërtohej Hidrocentrali i Fierzës dhe që prej asaj kohe kuksianë për plotë 40-45 vjet, trokasin dyerve të institucioneve shtetërore për kompensimin e pasurive dhe kurrë nuk i kanë marrë e kurrë nuk do i marrin dëmshpërblimin e pronave...

Kështu do të veprohet dhe me Dibrën e dibranët, por vetëm duan të na mbushin mendjen me projekte në "3D" dhe pasi të na pushtojnë me ujë, do bëjnë si të duan me pronat tona, duke na tallur...

Dibra e Madhe dikur vërtet ishte e Madhe, kurse pas përmbytjes së vitit 1960 , e kemi thirrur "Dibra e Madhe" për traditë, ndërsa në fakt ka mbetur si territor dhe populsi disa herë më e vogël se Dibra e mbetur në shtetin Shqiptar, pas procesit të delimitacionit dhe demarkacionit (ndarjes dhe caktimit kufijve) në vitin 1913.

E pra, kjo tkurrje i ndodhi që kur u përmbyt Udova dhe mori jetë hidrocentrali "Spile", ndërsa nesër po u ndërtua Skavica, Dibra e Vogël ose Dibra e Shqipërisë, do të quhet Dibra e Vockël, sepse pronarët dhe qeveritarët e sotëm do ta kenë të veten Dibrën nën uji dhe Hidrocentralin Skavica...

Nëse Dibra dhe dibranët janë shuar, le të bëjnë si të duan me Ramën e qeveritë sot e nesër, por nëse janë gjallë dhe në trupin e tyre qarkullon gjaku i të parëve, tamam gjak dibrani, e ndoshta dhe ndonjë pik nga gjaku i Kastriotëve, le të rebelohen një herë në shekullin e parë të mijëvjeçarit Ri, e ta marrin vesh kryeministri e qeveria e tij, se me Dibrën e dibranët nuk bëhet shaka e plane për ta pushtuar a përmbytur...

Unë nuk jam shuar, po Ju?!

Bashkohuni në kauzën tonë për ta mbrojtur Dibrën, pasi së shpejti do nisin takimet dhe protestat e mbarë dibranëve.

Zoti e ruajt Dibrën dhe dibranët kudo që jetojnë e punojnë!

** Autori është drejtues i degës së Tiranës të Shoqatës për Mbrojtjen e Pellgut të Drinit të Zi. Pikëpamjet e shprehura në këtë shkrim nuk përcjellin qëndrimin e redaksisë. Redaksia, ashtu si edhe në të kaluarën, mbetet e hapur për të botuar pikëpamjet e të gjitha palëve, në lidhje me këtë projekt.*

reportazh


Ky fshat ka 80 familje dhe 450 banorë, ndërsa vetë administratori i njësisë z. Shahini, pranon se bashkëfshatarët e tij nuk kanë më besim te ai, dhe njëherazi premtojnë të bojkotojnë votimet për zgjedhjet e 2021-it, për shkak të premtimeve të pambajtura të rrugës, që lidh këtë fshat me Bashkinë e Peshkopisë.

Shtegu i pashpresë i **Luginës** së **Shërimit**

Nga **EDMOND PRIFTI**

Shpesh thuhet se një rrugë e keqe, ka edhe një të mirë "që të heq gurët nga veshkat", por rruga apo më saktë shtegu që të çon drejt fshatit Rabdisht, 6 kilometra larg nga qyteti i Peshkopisë njihet "ironikisht" edhe si "Lugina e Shërimit" për shkak të qetësisë që shumë njerëz kanë gjetur nga mrekullia e ujërave termal.

Përgjatë kësaj rruge në gjendje krejt të amortizuar është edhe "fshati i gurtë", i klasifikuar nga qeveria shqiptare si një nga 100 fshatrat turistikë, por në të vërtetë, veçse "emri" i ka mbetur i tillë. Vetë Administratori i Komunës së Rabdishtit, Ramadan Shahini thotë se *"...prej 30 vitesh na premtojnë gjithë partitë për një rrugë, – pasi duke qenë pa rrugë nuk ka zhvillim, – ndonëse në fshat ka dy bujtina, e vijnë turistë, ndërsa u pëlqen fshati, si për mikpritjen por edhe pozitën gjeografike. Aktualisht, i vetmi aktivitet në fshat është mbledhja e bimëve mjekësore e turizmi. Është nisur një projekt për rrugën që thuhet që do realizohet këtë vit, a do realizohet? Ende jemi në errësirë. Gjithmonë mbetemi me shpresë, se shpresa vdes e fundit"*, është shprehur Shahini, për Portën Vendore.



Shtegu që të çon drejt fshatit Rabdisht, 6 kilometra larg nga qyteti i Peshkopisë njihet "ironikisht" edhe si "Lugina e Shërimit" për shkak të qetësisë që shumë njerëz kanë gjetur nga mrekullia e ujërave termal.



...Nuk i ka bërë shteti ynë, por një organizatë holandeze, të dyja, ujësjellësin së bashku me ndriçimin, ndërsa në pjesën e sipërme të fshatit ashtu kanë ngelur ende me tubat e kohës së Enverit"

Ky fshat ka 80 familje dhe 450 banorë, ndërsa vetë administratori i njësisë z.Shahini, pranon se bashkëfshatarët e tij nuk kanë më besim te ai, dhe njëherazi premtojnë të bojkotojnë votimet për zgjedhjet e 2021-it, për shkak të premtimeve të pambajtura të rrugës, që lidh këtë fshat me Bashkinë e Peshkopisë. Një shpresë pa një afat të përcaktuar, duket se jep edhe Specialistja e Zyrës Turistike në Bashkinë e Peshkopisë, Nevila Manga, e cila rrëfen se *"në propozimet që janë bërë për këtë fshat, – pjesë e 100 fshatrave turistikë shqiptarë, pritet të jetë edhe ajo e rregullimit të infrastrukturës rrugore deri në fshat, ndërsa janë bërë përmirësime në rrugët e brendshme të fshatit, në ndriçimin e tyre si dhe në ujësjellësin e ujit të pijshëm, 24 orë"*. Ndërsa marrim rrugën për në fshat, përmes atij shtegu plot gropa me një makinë 4×4 që nga 800 lekë fillimisht, për tre persona kërkon 1500 lekë, arrijmë në fshatin e gurtë të Rabdishtit.

Atje sapo të shohin si prurje e re në fshat, direkt të pyesin se çfarë ndodh përtej në qytet, me pandeminë, e duket se edhe takimi dorë më dorë me këta banorë zor se mund të shmanget. Tutje në krye të fshatit, midis ngrehinave të stërlashta, dëgjohet muzika e një dasme disa qindra metra sipër, ndërsa banorët na shohin me kuriozitet ne turistët e paktë, të ardhur në fshat në kohëra të liga. I shohim ata që më parë ecnin me rroba pune, tashmë të zbukuruar me këmisha, e parfumosur.

Aty pranë takojmë një nga banorët, Idriz Seferin, i cili na rrëfen se si shkojnë punët e fshatit, pasi më parë na kishte treguar ujësjellësin e ujit të pijshëm dhe ndriçimin e fshatit se, *"...nuk i ka bërë shteti ynë, por një organizatë holandeze, të dyja, ujësjellësin së bashku me ndriçimin, ndërsa në pjesën e sipërme të fshatit ashtu kanë ngelur ende me tubat e kohës së Enverit"*. Ndërsa vijon se: *"Një herë në katër vite na thonë do bëjmë rrugën...dhe erdhi 2020 dhe asnjë gur nuk kanë vënë!"*, thotë Sinan Elezi që i bashkohet befas bisedës tonë, teksa ecim përsipër fshatit përmes copëzave të kalldrëmeve të rregullta dhe të çrregullta të këtij fshati, teksa afrohemi tek shtëpia e bletërritësit Faik Nesimi, i cili është me një thes të madh të mbushur me fasule dhe nga pas i ati, Zeqiri i ngarkuar me kashtë, që na ftojnë tek shtëpia e tyre për një gotë me lëng thane dhe kafe turke.



Nga biseda "fshatçe" me ta, të ndjekur edhe nga bashkëbiseduesit tanë të mëparshëm, mësojmë se ky fshat "dikur krejt i gurtë" (nga rrasat e gurit për shtëpitë) ka pasur gjatë komunizmit edhe një teleferik për trungje drurësh e tagji për bagëtitë, nga bjeshkët sipër fshatit deri në qendër, por gjurmët e tyre, sot nuk shihem më. Sot, një pjesë e madhe e banorëve të këtij fshati, merren me mbledhjen e boronicave dhe të bimëve mjekësore, e megjithatë, sipas vetë fshatarëve të kësaj zone, e pranojnë se kultivimi pa kriter i tyre për vite me radhë duke i shkulur bashkë me rrënjët, i ka detyruar mbledhësit amatorë të vetë fshatit, të kalojnë kufirin përtej Shqipërisë, drejt bjeshkëve të Mavrovës (Maqedoni e Veriut). *"Këtu ka ngelur veçse të ngremë një flamur maqedonas dhe ti themi këtij vendi...Maqedoni. U bënë 30 vite demokraci që nuk është venë dorë, që nga rruga kryesore"*, shprehet Fitim Selimi, një nga banorët e këtij fshati turistik, teksa mendueshëm shikonte herë pas here nga pas rrugicave, teksa dielli kishte nisur të perëndonte.



Një pjesë e madhe e banorëve të këtij fshati, merren me mbledhjen e boronicave dhe të bimëve mjekësore, e megjithatë, sipas vetë fshatarëve të kësaj zone, e pranojnë se kultivimi pa kriter i tyre për vite me radhë duke i shkulur bashkë me rrënjët, i ka detyruar mbledhësit amatorë të vetë fshatit, të kalojnë kufirin përtej Shqipërisë, drejt bjeshkëve të Mavrovës...





Atë natë bujtëm në bujtinën e Sabri Shahinit, pak metra nga qendra e fshatit, i cili na rrëfeu plot histori të vjetra të kësaj zone dhe për vetë familjen e tij, dikur të madhe prej 60 personash. Menaxhimi i gjithë bujtinës së tij të ndërtuar në vitin 2018, me afro 15 shtretër, me akomodim "fshatçe" si dhe ushqime bio fshati, që përgatitet en nga ai dhe bashkëshortja e tij Festa (Festime) duke mirëpritur tashmë vizitorët, tashmë akoma më të paktë që vijnë në Rabdisht, pasi siç tregon edhe vetë Sabriu "dy djemtë janë jashtë shtetit".

Që herët në mëngjes i pari ngrihet Sabriu që merret me një brigadë ndërtimi në Peshkopi dhe po ashtu Festa, e cila të pyet për çdo nevojë që mund të kesh, e jo më atë kafen e mëngjesit "që e qan". Pas një ushqimi të shijshëm, bisedave shumëllojshme, e rakisë së kumbullës së nxjerrë nga vetë Sabriu, biem e flemë pas mesnate, ndërsa të nesërmen në mëngjes largohemi me kujtime të këndshme e me urimin se një ditë do rikthehemi sërish me premtimet e një rruge të shtruar.

GUIDË PËR RABDISHT...

Për të mbërritur në fshatin e Rabdishtës në Peshkopi, kalohet më parë në shtegun e famshëm të "Luginës së Shërimit", ku gjenden edhe ujërat termale të llixhave dhe ujit të ftohtë, dy vlera të vlefshme kurative të qytetit të Peshkopisë, që vizitohen nga mijëra vizitorë çdo vit. Largësia nga Tirana është 187 kilometra apo pothuajse 4 orë e 10 minuta. Në fshatin Rabdisht, mund të akomodohesh në Bujtinën "Goleci" apo "Sabriu", të dyja me çmime pothuajse të njëjta. E gjithë pagesa për person për mëngjesin, drekën, darkën dhe fjetjen, kushton 3500 lekë, ndërsa rruga vajtje-ardhje mund të bëhet me fugonin e linjës, i cili niset nga Peshkopia në mëngjes, me një pagesë prej 70 lekësh apo me makinë të rezervuar deri në 800 lekë. Në fshatin e Rabdishtës temperaturat gjatë verës, janë pothuajse 10-15 gradë më pak se në Tiranë, kështu që përgatituni për mëngë të gjata. Sipas "Smile Albania" fshati shtrihet në pjesën lindore të Qarkut Dibër, 10 kilometra në jug të malit të Korabit, si dhe rrëzë vargmalit të Deshatit, me një sipërfaqe prej rreth 65,5 km². Fshati karakterizohet nga një reliev tipik malor. Mbi fshat shtrihet Bjeshka e Rabdishtit, e vetë fshati është pjesë e parkut natyror Korab-Koritnik (zonë e mbrojtur e kategorisë IV). Nga pikëpamja arkitekturore, fshati Rabdisht është një fshat tipik malor me ndërtesa guri të ndërtuara me teknikat tradicionale. Numërohen mbi 70 shtëpi guri një deri në tre kate të lidhura mes tyre me rrugica me kalldrëm. Zona ku shtrihet fshati Rabdisht, mbart potenciale të mëdha të lidhura me trashëgiminë kulturore dhe natyrore.

Marrë nga portavendore.al

Rruga e Arbërit nr. 171

aktualitet

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi gjeti pas një hetimi se dy nga katër minatorët e shkarkuar nga Albchrome ishin ndëshkuar për shkak të angazhimit të tyre sindikal. Albchrome paralajmëron apelimin e vendimit.

Vendimi i Komisionerit: Albchrome i shkarkoi minatorët për shkak të **angazhimit sindikal**

Nga **Sami Curri** | BIRN | Tiranë

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi gjeti pas një hetimi se minatorët Beqir Duriçi dhe Behar Gjimi, të dy anëtarë të Këshillit Sindikal të Sindikatës së Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës, ishin shkarkuar nga puna "pikërisht për shkak të përkatësisë në sindikatë".

Në vendimin e datës 26 tetor, Komisioneri Robert Gajda rrëzoi padinë për Elton Debreshin, kryetar i SMBB-së, duke arsyetuar se nuk u provua që kompania kishte qenë në dijeni të përfshirjes së tij në sindikatë në momentin e marrjes së masës ndëshkuese, ndërsa vendimi për minatorin e katërt, Ali Gjeta u pezullua.

Komisioneri u vu në lëvizje nga SMBB, pas shkarkimit të kryetarit të saj, Elton Debreshi dhe anëtarëve të Këshillit Sindikal, Beqir Duriçi, Behar Gjimi dhe Ali Gjeta në nëntor dhe dhjetor të vitit të kaluar, pak javë pasi ishte njoftuar krijimi i sindikatës së re. SMBB e akuzoi Albchrome se i kishte ndërshkuar minatorët për shkak të organizimit të tyre në sindikatë.

I pyetur nga BIRN për vendimin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Albchrome e quajti atë të padrejtë dhe paralajmëoi apelimin në gjykatë.

"AlbChrome do të apelojë vendimin e Komisionerit pjesërisht, për pjesën që ka vlerësuar diskriminin, pasi gjykohet të jetë i pabazuar në prova dhe në ligj," reagoi kompania.

Sindikata e Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës e konsideroi vendimin e Komisionerit të vonuar, por vlerësoi njohjen e diskriminimit.

"Pas shumë muajsh vonesë, edhe për shkak të situatës së pandemisë, KMD-ja ka dalë në përfundimin se drejtuesit e SMBB-së janë diskriminuar nga kompania Albchrome, pikërisht për shkak të angazhimit sindikal," tha Sindikata, duke theksuar se kjo i hapte rrugën rikthimit të sindikalistëve në punë.



Kreu i Sindikatës së Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës, Elton Debreshi duke folur para protestuesve. Foto:Sami Curri/BIRN

Vendimi i Komisionerit vë në dukje se procedurat ngarkonin kompaninë Albchrome që të sillte prova për të kundërshtuar padinë se kishte diskriminuar minatorët për shkak të pjesëmarrjes në sindikatë.

"Shoqëria Albchrome jo vetëm që nuk dha shpjegim objektiv, të justifikueshëm dhe të besueshëm për zgjidhjen e kontratës të punë së ankuesit, por shpjegimet e dhëna prej saj janë të pabazuara në provat e administruara dhe në kundërshtim me mbrojtjen ligjore që i ofrohet punëmarrësit në marrëdhëniet e punës", thuhet në vendimin e Komisionerit Gajda.

Komisioneri arsyetoi se qoftë ndaj Duriçit, qoftë ndaj Gjimit masat e marra nga kompania përfshi ndryshim të vendit të punës pa miratim, ishin jo propocionale dhe binin ndesh me një sërë ligjesh kundër diskriminimit.

Duke arsyetuar se të dy shkarkimet kishin ndodhur pas krijimit të sindikatës dhe gjatë protestës të organizuar prej saj kundër shkarkimit të Elton Debreshit, Komisioneri vë në dukje se kompania kishte në këtë kohë dijeni të plotë për statusin e tyre si anëtarë të Këshillit Sindikal.

"Pas shumë muajsh vonesë, edhe për shkak të situatës së pandemisë, KMD-ja ka dalë në përfundimin se drejtuesit e SMBB-së janë diskriminuar nga kompania Albchrome, pikërisht për shkak të angazhimit sindikal," tha Sindikata, duke theksuar se kjo i hapte rrugën rikthimit të sindikalistëve në punë.

Në rastin e Debreshit, Komisioneri e rrëzoi padinë, pasi arsyetoi se nuk mund të provohej që Albchrome kishte qenë në dijeni se ai ishte përfshirë në aktivitet sindikal. Vendimi arsyeton në favor të Debreshit në lidhje me një masë disiplinore, por po ashtu i jepet të drejtë kompanisë në lidhje me një pjesë të mungesave të pajustifikuara.

Përplasja mes kompanisë Albchrome dhe përfaqësuesve të SMBB filloi pesë ditë pas njoftimit publik të themelimit të sindikatës. Kompania fillimisht shkarkoi Elton Debreshin dhe më pas tre anëtarë të Këshillit Sindikal, ndërsa pretendoi se shkarkimit nuk kishin lidhje me krijimin e SMBB-së. Inspektoriati i Punës, i cili bëri një hetim në lidhje me çështjen e shfajësoi kompaninë dhe arsyetoi po ashtu se shkarkimet nuk ishin për shkak të pjesëmarrjes në sindikatë.

Reporter.al

Kriza e kromit, dhjetra minatorë në Bulqizë të papaguar prej muajsh **bojkotojnë punën**

Sindikata e Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës denoncoi të martën gjendjen në galeritë e kromit në Bulqizë e Batër, ndërsa tha se dhjetra minatorë kishin bojkotuar punën pasi kishin muaj pa u paguar.

Nga Sami Curri | BIRN | Tiranë

Dhjetra punëtorë në disa kompani minerare në Bulqizë, kanë bojkotuar punën në galeri që prej ditës së hënë. Sindikata e Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës bëri me dije, pa përmendur emrat e kompanive, se minatorët e një pjesë të madhe të shfrytëzuesve të kromit në zonën D dhe në zonën e Batrës, kishin muaj që nuk paguheshin.

"Në një pjesë të madhe të minierave të Zonës D në Bulqizë, po ashtu edhe në disa miniera të Batrës, minatorët nuk paguhen prej muajsh. Pronarët justifikohen me rënien e çmimit të kromit, ndërkohë që punëtorët vazhdojnë të punojnë, kromi vazhdon të dalë prej nëntokës, të transportohet drejt Portit të Durrësit dhe të paguhen taksa për të. Të vetmit që nuk kanë marrë asgjë prej muajsh, edhe pse kanë derdhur djersë e gjak, janë minatorët!", thuhet në reagimin e SMBB-së.

Sindikata e Minatorëve të Bashkuar të Bulqizës denoncoi mos reagimin e qeverisë për situatën e krijuar.

"E vetmja gjë që kanë marrë minatorët, kanë qenë premtimet e llojit "pagat do dalin më datë 15". Kur data shkon 15, atëherë "do dalin në datën 1". Por pagat vazhdojnë të mos dalin prej muajsh në asnjërën prej datave, prandaj punëtorët sot e kanë bojkotuar sërish punën, si në çdo fillim muaji.", thuhet në reagimin SMBB.

Kriza në sektorin e kromit, siç gjeti BIRN në një shkrim të gushtit të këtij viti, e lidhur me rënien e çmimit të mineralit në bursë dhe me mbetjen e tij stok në Bulqizë. Një zyrtarë i Inspektoriatit të Punës i tha BIRN në atë kohë se rreth 30 kompani minerare kishin probleme me pagat, por problemi duket se është thelluar në vijim.

Një situatë e ngjashme është krijuar prej muajsh për naftëtarët në Ballsh. Prej 20 ditësh 10 punonjëse të rafinerisë janë në grevë urie, pasi kërkojnë paga të prapambetura dhe rifillimin e punës. Qeveria ka refuzuar të negociojë deri sa ato të lënë grevën e urisë.

Një minatorë i një prej kompanive që nuk ka paguar prej muajsh i tha BIRN duke kërkuar të ishte anonim se nuk kishin më asnjë shpresë. "Këtu që prej fillimit të vitit na është nxi jeta për me marrë lekët e punës e djersës tonë. Një herë e nisën me vonesa e pastaj nuk na i dhanë hiç. Disa të ri e lanë punën që nga qershori e korriku, një pjesë e vazhdum me idenë hëëë se do i marrim e hë se do iki kriza. Por këtu mo shok ka marrë fund", tha ai.

Ai tha se ishte pjesë e minatorëve që nuk kishin shkuar në punë që prej nëntorit. "Për ne mor shok, më keq nuk ka. Ta dish këtë gjë. Ne jemi me lista (borxhesh) deri në fyt", tha ai, ndërsa shtoi se tashmë kishin lista edhe në farmaci për ilaçe.

Minatori tha se asnjë nga institucionet shtetërore nuk ishte interesuar. "Sa për shtet, se dimë se ka ka humb", tha ai.

BIRN mësoi se një ndër kompanitë me probleme ishte "ALB-MI". Administratori i saj në një bisedë telefonike pranoi problemin, por tha se do të shlyente detyrimet ndaj minatorëve në datën 10 nëntor.

Një përfaqësues i kompanisë Neku shpk, e cila po ashtu u mësua të kishte probleme, refuzoi të fliste. Disa kompani të tjera me numër më të vogël punëtorësh nuk ishin të arritshme.

Një përfaqësues i një kompanie tjetër, për të cilën BIRN mësoi se kishte pasur probleme të ngjashme, tha se kompania i kishte paguar punëtorët dhe nuk kishte probleme. Personi që u prezantua në numrin e telefonit të vendosur në Qendrën Kombëtare të Biznesit, si Xhaferr Kunxhi, tha se kriza ishte në të gjithë sektorin. "Vetëm ne kemi 30 mijë ton krom stok", tha ai, ndërsa shtoi se shumica e kompanive kishin vetëm rojet në punë dhe se puna ishte ndaluar në shumicën e kompanive të zonës.

Në fillim të muajit shtator disa kompani me afro 100 të punësuar ndërprenë aktivitetin. Sipas Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, AKBN, gjatë vitit 2018, në galeritë e kromit punonin 3170 punonjës, ose rreth 1 në çdo 10 banorë të Bulqizës sipas censusit të vitit 2011. Kjo është pjesa dërrmuese e krahut të punës në qytet.

Minierat janë një nga vendet më të rrezikshme të punës në Shqipëri dhe çdo vit ka aksidente të rënda me humbje jete. Një javë më parë, një inxhinier dhe dy punëtorë humbën jetën në galeritë e Selishtës në Dibër.

www.reporter.al

Tre minatorë humnasin jetën në galeritë e kromit në Selishtë

Tre minatorë u gjetën të vdekur të enjten, 29 tetor 2020, në një galeri në Selishtë të Dibrës. Minatorët. "Inxhinieri Ismail Hoxha 62 vjeç dhe minatorët Fatos Cesku, 55 vjeç dhe Rruzhdi Rushiti 29 vjeç u nxorrën të pa jetë nga galeria" njofton Reporter.al.

Sipas medias, minatorët ishin raportuar të humbur një ditë më parë dhe grupet e "avari-shpëtimit" i gjetën të vdekur në brendësi të galerive.

Policia lëshoi një deklaratë ku theksohej se "dyshohej që minatorët ishin asfiksuar nga një shpërthim gazi gjatë kohës që ishin duke punuar në një galeri".

"Të afërm të tre viktimave njoftuan policinë të mërkurën rreth orës 18.00, pasi kishin humbur kontaktet me ta. Policia njoftoi në mbrëmje se kishte gjetur rrobat dhe celularët e viktimave jashtë galerisë dhe se dyshonte që ata ishin bllokuar. Operacioni i kërkim shpëtimit zgjati sipas policisë deri në orën 3 të mëngjesit, kur ata u gjetën të vdekur në galeri", shkruan reporter.al

Inxhinieri Ismail Hoxha, nga qyteti i Peshkopisë kishte një licensë për shfrytëzim galerish në zonë. Dy viktimat e tjera janë minatorë nga qyteti i Bulqizës.

Në lajmin e botuar nga reporte.al thuhet se " në zonë kishte disa karriera të hapura (nxjerrje mineralesh në sipërfaqe) dhe disa tunele që shfrytëzoheshin për nxjerrje kromi. Minierat ndodhen në zonën e "Balgjajt" rreth pesë orë nga qyteti i Peshkopisë në një lartësi 1900 metra nga niveli i detit".

Ky është një nga aksidentet më të rënda në minierat e vendit në vitet e fundit. Minierat janë një nga vendet më të rrezikshme të punës në Shqipëri dhe çdo vit ka aksidente të rënda me humbje jete. Në pesë vite duke përfshirë edhe viktimat e këtij aksidenti, 30 minatorë kanë humbur jetën dhe dhjetra të tjerë janë plagosur.

recensë

Metamorfoza e Kamber Farrukut në librin e tij “Kur shkriheshin akujt”

Nga **AHMET PRENÇI**

Shumë vite kisha pritur që të shfaqej për publikun një botim nga Kamber Farruku. Ndaj, ndjeva kënaqësi kur në dorë mora librin e sapobotuar që kishte autor pikërisht redaktorin e ish-gazetës “Ushtima e maleve”. Pata një padurim për të filluar leximin e këtij libri të ri, botimin “e vonët” të Kamberit. Në vetvete kisha besimin e palëkundur se, ai ka bluar e pjekur më së miri atë ç’ka do na dhuronte ne si lexues të hershëm të tij. Libri mban titullin interesant “ Kur po shkriheshin akujt”.

E fillova me një frymë këtë lexim dhe më shijoi jashtë mase që në faqet e para. Në vazhdim të fletëve; teksti, fabula dhe ndodhitë interesante më ngacmonin në shpirt. Më mbushi emocionalisht, duke më kthyer memorien dekada vitesh mbrapa. Në përfundim, mund të them se është një nga librat që i veçoj dhe i radhis tek librat e mi të preferuar. Tashmë e konsideroj një pasuri të çmuar të bibliotekës time.

Meqë Kamberin e kam lexuar qëkur isha nxënës, pata arsye si shumëkush që e njeh penën e tij, për ta mirëpritur një botim nga ai. Tashmë ndjeja lumturi që e kisha përpirë rrëfimin e tij të bukur; maratonë ngjarjesh e ndarë në dy pjesë, e shtrirë në dy kohët e fundshekullit të kaluar. Në dy etapa historike të vendit; në periudhën komuniste dhe rrëzimin e regjimit gjakatar, e në etapën e demokracisë dhe pluralizmit të ri, me të gjitha problematikat e përjetuara. U ndjeva i ngazëllyer me përmbajtjen, me tekstin, me thesaret shpirtërorë që mbart ky libër si monument për Dibrën dhe rrugëtimin tonë të përbashkët.

Duke i parë ngjarjet nga distanca, i barazlarguar nga personazhet dhe ndodhitë, vetvetiu përjeton një meditim të thellë dhe përpiqesh të identifikosh thelbin, domethënien, të thënat e nënkuptimet, përplasjet e ngjarjeve të shumta që rrjedhin faqe pas faqeje, rresht pas rreshti, madje edhe në mes të rreshtave. E them edhe në mes të rreshtave, pasi libri në tërësinë e tij është një odë - auditor i universitetit të Dibrës.


E përjetova bukur leximin e këtij libri, tamam si një film autobiografik i një periudhe dinamike e të vështirë. Në sekuencat e këtij filmi të shfaqet herë-herë vetja, herë e bashkëmoshatarëve, si dhe të shëmbëllehen jetët e prindërve tanë të shumëvuajtur, e më tej e paraardhësve të tyre. Është sjellë në këtë libër dhe retrospektiva e historisë, e brezave me ngjarjet e personazhet e Dibrës, që na i ndriçon me kujdes e me radhë autori në këtë vepër.

Në të vërtetë aty shfaqet dhe shikon metamorfozën e transformimit të mentalitetit, të bindjes, të formimit të një intelektuali në kapërcimin e dy kohëve: komunizmit dhe demokracisë së brishtë shqiptare. Këtë na e jep autori, duke treguar me detaje rrugëtimin e tij. Është një transformim i natyrshëm, i vështirë, është një proces që vazhdon sot e gjithë ditën.

Me vëzhgimin dhe soditjen e kujdesshme, shënimet e tij paraqesin një vlerë të çmuar për çdo lexues. Duke parë metamorfozën e Kamber Farrukut në librin “Kur shkriheshin akujt”, kemi bërë një udhëtim real në gjithë retrospektivën e rrugëtimit të brezit tonë në dy etapat e rëndësishme historike që Shqipëria përjetoi në vitet ‘90.

Ky libër nuk është një trill letrar. Është një vepër ku të gjithë personazhet janë realë, të vërtetë. Gjithsecili nga lexuesit e gjen veten në atë vorbull ngjarjesh, ku autori ka patur një rol të rëndësishëm, madje është në epiqendrën e tij. E veçanta është që ka qenë gjithmonë i vëmendshëm në kryerjen e misionin fisnik si gazetar, shkrimtar dhe politikan. Ka fiksuar dhe i sjell të freskëta ngjarjet, ndodhitë dhe fjalët e arta me meseletë apo alegoritë e shumta filozofike të Dibrës. Librin e shoqërojnë me shumë shije përshkrimet e holla letrare të vendeve dhe njerëzve, të natyrës dhe të objekteve që lidhen me kohën e momentin kur janë zhvilluar ngjarjet.

Pjesa e parë e librit na është shfaqur nga autori në formë ditari. Kjo e bën më të larmishëm fragmentimin e kohës, përshkrimin e etapave dhe të ngjarjeve që kanë lënë gjurmë në kujtesë. Si një kronikan i pjekur e me përvojë na ka skalitur atë që ne s’duhet ta harrojmë kurrë; nga kemi ardhur, nga kemi kaluar dhe ku po shkojmë. Fatmirësisht, tashmë ky libër është pronë e secilit prej nesh dhe kemi mundësinë t’u kthehemi faqeve të tij për të freskuar në çdo kohë memorien dhe vetëdijen tonë. Na e ka sjellë të vërtetën shumë



Ky libër nuk është një trill letrar. Është një vepër ku të gjithë personazhet janë realë, të vërtetë. Gjithsecili nga lexuesit e gjen veten në atë vorbull ngjarjesh, ku autori ka patur një rol të rëndësishëm, madje është në epiqendrën e tij. E veçanta është që ka qenë gjithmonë i vëmendshëm në kryerjen e misionin fisnik si gazetar, shkrimtar dhe politikan...

bukur, me gjithë hidhësinë e kohës që kaluam, të momenteve që lamë pas.

Ndërkohë që lexoja, mu kujtuan dy gjëra të rëndësishme që lidhen me mua. E para, kur botova për herë të parë poezitë e mia në gazetë dhe botuesi ishte pikërisht autori Kamber Farruku. Kur ai i botoi poezitë e mia në atë gazetë unë isha vetëm një nxënës me vështrimin imagjinar të strukur në luginën e ngushtë të Drinit në Reç, me ëndrra që i lidhja vetëm me librat që lexoja asokohe. Atëherë s’ma rrokte mendja se redaktori i poezive të mia, të thirrej nga Sekretari i Parë për të dhënë llogari për shkrimet e tij jo aq të përputhura me vijën e Partisë. Nuk kisha si t’i kuptoja atëherë këto gjëra të ndërlikuara! Gjithashtu, kujtoj veten edhe kur Kamberi ishte nënkryetar i Komitetit Pluralist dhe më ndihmoi për të marrë dosjen time nga Komiteti Ekzekutiv, për të filluar udhëtimin e karrierës time larg Dibrës. Sërish nuk kisha si ta dija atëherë, kur sapo isha diplomuar, debatet e preokupimet e tij në raport me Kryeministrin Ylli Bufin dhe zëvendësin e tij Zyhdi Pepa, ku debatin për Ligjin 7501 për tokat e kishte fituar Kamberi me dibranët dhe jo Qeveria e Stabilitetit. Këto gjëra i mësoj tani, në këtë libër, teksa përshkruhen sikletet e autorit në raport me pushtetin. Këto dy momente mua më erdhën në mendje dhe më jepet rasti ta falenderoj me mirënjohje Kamber Farrukun.

Me një gjetje mjaft të kujdesshme e me një strukturë të ujdisur si duhet, në këtë vepër gjejmë momente e episode për Haxhi Lleshin e Ramiz Alinë në diktaturë, po ashtu edhe për ngjarje e dialogje që lidhen me Sali Berishën, Azem Hajdarin etj, në demokraci.

Natyrshëm dhe me finesë ngjarjet zhvendosen në mënyrë mjaft domethënëse e të natyrshme në dialogun e jashtëzakonshëm, por real, të Imer Tanushit me Malë Gjipin. Në një frazë, në një paragraf apo dialog shprehet qartë filozofia e një epoke të tërë. Në pak rreshta hidhet në humnerë dhe denigrohet një regjim i ngritur mbi eshtra e mbi gjak. Natyrshëm, por që të rrëmben e të lë gjurmë të thella, është përshkrimi për odën e Han Likës me drapër e çekan gdhendur në tavan. “Po lëvize këmbët të pret drapri, po luajte kokën të bie çekiçi”, kështu e shpreh autori këtë simbolikë sovjetike, teksa përshkruan odën e Hanit. Kjo paraqet një dimension tjetër, atë të simbolikave që prezantonin dibranët në atë kohë e që në këtë libër i gjen në gjithë faqet e tij.

Një moment i bukur që të ngulitet thellë në mendje e që tregon integritetin dhe përparimin intelektual të inxhinierit Ramiz Kadria lidhet me refuzimin për t’u pranuar në Partinë e Punës. Është një episod real, por që flet shumë, në rrjedhën e asaj çfarë tregon rrokullisja e ngjarjeve në atë kohë të mbrapshtë, kur partia-shtet kishte filluar degradimin në sytë dhe mendjen e intelektualëve. Ngjarja makabre e ekzekutimit të Ali Likës në Luzni të trondit memorien, të rrëqeth kur ndeshesh me këto akte kriminale të komunistëve të kuq.

Këto janë pak nga momentet që po i përmend në këtë shënim. Janë këto pak episode, pasi libri është i gjithi me xhevahirë që autori i ka mbledhur me kujdes prej dekadash dhe i ka përpunuar në mendjen e tij, për t’i derdhur së fundmi aq bukur në veprën e tij “Kur shkriheshin akujt”.

Pjesa e dytë e librit i është kushtuar periudhës kur në vend u vendos pluralizmi politik. Autori, në mënyrë te detajuar, na përshkruan vështirësitë e themelimit të partisë së parë opozitare në Dibër; sulmet ndaj nismëtarëve, rrokullisja e vështirë e shoqërisë së traumatizuar e të varfëruar për disa dekada nën shtypjen komuniste, revanshi i ithtarëve të verbuar komunist dhe entuziazmi i shfrenuar i opozitarëve të rinj.

Të lë shije dhe mbresë të jashtëzakonshëm mesazhi që jep autori, kandidat i PD-së, në fushatën e parë të pluralizmit me mikun e hershëm, drejtorin e shkollës Hysni Lala, i cili ishte kryetar i PS-së. Kamberi, si kandidat i PD-së shkon në shtëpinë e tij. “Pluralizmi erdhi për të ndërtuar ura të vërteta miqësie mes njëri-tjetrit, ka ikur koha e luftës së klasave, e urrejtjes dhe përçarjes. Ky ishte qëllimi i vizitës sime, për të dhënë këtë mesazh”, shprehet autori pas vizitës. Të mbush shpirtërisht e të jep një ndjesi shumë domethënëse sjellja qytetare dhe vizita në shtëpinë e kundërshtarit politik.

Në libër zë vend dhe letrat që i kanë rënë në dorë autorit, letra nga të njohur të tij, që ishin dërguar partisë për ta groposur autorin që nuk ishte komunist. Këto letra që i bëheshin Sekretarit të Parë i gjejmë të botuara në libër dhe dhimbshëm mësojmë se bëhen shkak për largimin e Kamberit nga puna në gazetë.

Nga miq të mi nga Muhuri kisha dëgjuar shumë histori “qesharake” për Ferë Dokën, njeri pa njeri nga Sina e Epërme. Mënyra si e ka sjellë autori në libër me mjeshtërinë e hollë që ka përdorur, me mjaft elegancë e art që nga periudha e Dine Hoxhës e deri tek koha komuniste e Haxhi Lleshit më ka mbetur në mendje. Vetëm një penë e stërvitur mirë e realizon këtë kapërcim të bukur. Një personazh rruge e transformon në një “filozof “ të këndshëm.

Një tjetër moment të hidhur e të shëmtuar për kohën, autori sërish e transformon në episod për të mos u harruar. Fushata e Partisë për të mobilizuar popullin në shpërndarjen e gropave septike në arat me grurë që është përshkruar me një stil të bukur, duke na dhuruar një perlë të jashtëzakonshme. E më pas, portretizimi i Gjonit demokrati të Milotit, tregon gjithçka që ndodhi në atë ndryshim çoroditës të sistemit.

Deviza që na trasmenton autori në gjuhën dibrançe për rreth 50 vite të komunizmit ishte: “Puna e mbarë, or mund djerrë”. Një konkluzion mjaft i gjetur për periudhën komuniste, i shkrirë më së miri në gjithë rrëfimin që përputhet me këtë shprehje të vjetër të popullit.

Libri është edhe histori, edhe publicistikë, edhe letërsi. Unë e shijova si një roman, ku personazhi kryesor është Kamber Farruku, i cili në rrugëtimin dhe kujtesën e tij na shfaq personazhe realë, në kohë e vende reale, duke e shndërruar këtë vepër në thesar që duhet ta shfrytëzojë çdo lexues, e aq më shumë, çdo dibran.

Këto janë pak episode, por vepra ka të tilla në të gjitha faqet e të mban shtrënguar për të mësuar ngjarje, emra, episode... Ftoj lexuesit ta lexojnë. Unë po ju nxis, por me këto që them nuk ua shuaj kureshtjen. Ju siguroj që është një libër i bollshëm, voluminoz dhe s’ka asgjë të tepërt.

Pasthënia e librit është në vetvete një vepër arti, që përmbledh në pak rreshta të gjithë teatrin absurd që ndodh në Shqipërinë tonë të mjerë.

Urime Kamber dhe faleminderit nga zemra që na dhurove një vepër të tillë, me mjaft vlera, për gjithsecilin që e lexon. Shpresoj në botime të tjera.

Nuk është shënim i një analize letrare profesionale, por vetëm mbresat e një lexuesi, i cili pas përfundimit të librit, po i shpreh thjesht këto përjetime, me qëllim që të shërbejnë si nxitje dhe ftesë për leximin e librit “Kur shkriheshin akujt”.

“Jalla lemi Ferës”

Në xhadenë, që përshkon mespërmes fushën e Muhurrit, sidomos verës, ne fëmijët kishim parë nganjëherë një njeri të çuditshëm të veshur verës me këmishë e brekë të bardha hasi. Mbante një torbë varur në njerin krah, ecte këmbëzbathur, me fytyrën e mprehtë të gërryer dhe të skuqur nga dielli, qafën e gjatë me damarë të fryrë, flokët e rralla si kashtë. Në fillim e kishim frikë. Por ai këndonte gjatë gjithë rrugës me pluhur në pikën e vapës:”Hej Murat Kaloshi, /Hej Dine Hoxha. . . ”Kur iu afruam një rradhë, ai u ndal dhe na tha me një zë pak të hollë me ton si përkëdhelës, si tallës:

-Jalla lemi, jalla lemi!(Zoti u lashtë!Zoti u lashtë!)Jalla lemi Ferës!

Ky ishte Ferë Doka, njeri pa njeri, nga Sinja e Epërme, fshat në kufi me Muhurrin. Ferën e njihnin të gjithë të rriturit, ai i përkiste brezit të gjyshërve tanë në atë kohë. Ishte njeri që, në periudhën e mbretërisë para 44-trës, e kalonte jetën pranë agallarëve të zonës, kryesisht te Kaloshët apo Dine Hoxha. Por Fera ishte finok i madh. Aq sa u bënte qejfin Parisë, aq edhe tallej me ta. Thurte një ironi të hollë, që zor ta merrnje vesh.

Në një rast i thotë Dine Hoxha:

-Ferë, na këto napolona dhe çojua sinjaneve si sadaka për bajram. E din vetë se kujt ia jep, atyre, që janë ma në hall.

-Posiii!, -thotë Fera, - pa merak aga!

I merr paratë Fera dhe shkon te tuxhari e blen sheqer, gjalp e miell gruri dhe . . . çfar nuk blen!Gjithë katundi mbante aromën e gjalpit, që dilte nga kasollja e Ferës, i cili piqte petulla e bënte hallvë. Pas do kohësh, sërish Fera shkon te konaku i Dines, aty në fund të odës. Dinja e sheh dhe i kujtohet porosia, që i pat dhënë. Me sa duket, i kishin ardhur në vesh fjalë se Fera nuk kishte çuar gjë te fshatarët.

-Or Ferë, ato që të pata dhënë, a i shpërndave?- e pyet Dine Hoxha.

-Posiiii aga!Posaaaj, i kam çue nja m’nja!

-Por, nuk më ka thanë ndonjani “Zoti ta shtoft!” apo ndonjë faleminers. . .

-Eh, or Aga!Nuk të kanë thanë, posiii, nuk të kanë thanë!A e din pse nuk të kanë thanë?Se ky popull don edhe ma Aga, prandaj. Duan edhe ma të shkretët!Por nuk ka gjë, të them unë faleminers në vend të tyre, -tha Fera pa iu bërë vonë. Dinja nënqeshi, e mori vesh.

Kur erdhi komunizmi dhe agallarë nuk kishte më, për Ferën erdhën kohë të vështira. U bënë dhe të tjerët si Fera. Dimër e verë dilte më këmbë në Peshkopi me atë torbën në krah dhe kërkonte ushqime pranë menzave e furrave. Dhe kthehej në mbrëmje te kasollja. Një rradhë, kur po ngjitej Kubenit në rrugë malore, një vend disa kilometra larg qytetit të Peshkopisë, sheh një makinë ushtarake të ndalur. Shoferi kishte futur kokën ndën kofën dhe po prekte diçka në motorr, sepse makina ishte fikur e nuk po ndizej. Fera i afrohet një oficeri:

-Jalla lemi Ferës komandant, merreni Ferë Dokën deri në Peshkopi. Shiheni si jam, sevap!

-Ja, të pyesim këtë shoferin, -i thotë oficeri.

-Ti gjithë ditën mban në gojë armiqtë e popullit Dine Hoxha e Murat Kaloshi, nuk të marrim, -i thotë një oficer tjetër, që e njihte.

-Dine Hoxha e Murat Kaloshi kur ishin, ishin!Ju ene jeni, ene nuk jeni!Me gjithë ato nishane mbi në skep të krahit, pyetni shoferin për të marrë një Ferë Dok në maqinë!-u thotë Fera dhe vazhdon rrugën me torbën në krah.

(Marrë nga libri “Kur shkriheshin akujt”, Dita Print, 2020.)

Rruga e Arbërit nr. 171

histori

Zona jonë ka nxjerrë heronj dhe figura të shquara, personalitete të rëndësishme të kulturës dhe dijes, guximit dhe vendosmërisë, traditës dhe atdhetarisë. Kjo kolonë e gjatë dishepujsh të vlerave dhe krenarisë, i ka shërbyer vendit, por ata kanë ngelur pa u bërë të njohur, pa u përfaqësuar dhe vlerësuar sa dhe si duhet.

Golloborda dhe Dibra, një ngulmim për të krijuar një **panoramë** sa më të plotë dhe sa më të qartë **njohëse historike**

Nga **HALIL TEODORI**

Në këtë komunikim ju ftoj të përcjellim shpalosjen njohëse të një krahine, vlerësimin me rigorozitet dhe përgjegjësi të fakteve dhe orientimin drejt një përcaktimi sa më përfaqësues dhe rigoroz të asaj që merr tagër nga e vërteta.

Vite më parë botova monografinë "Sabri Caka, krahu i shqipes në flamur", në të cilin është bërë prezent jo vetëm roli, emri dhe kontributi i këtij personaliteti të rëndësishëm, por edhe gjithë komponentët e tjerë që në njëfarë mënyre plotësojnë panoramën e përfaqësimit dhe rikthimit në kujtesë dhe mirënjohje të Sabri Cakës.

Me gjithë përpjekjet që bëra, për ta plotësuar këtë kuadër, duke e konsideruar si të frytshme, njëherazi ndihmën e dhënë nga bashkëpunëtorët që m'u gjendën pranë, me gatishmërinë e tyre për të më mbështetur, me fakte dhe dëshmi për botimin e këtij libri, e kam cilësuar se e ndjej dhe e kam ende shumë gjëra të pa thëna. Megjithatë, çdo vullnet pozitiv është një përpjekje dhe çdo rrekje për të dëshmuar të shkuarën është një rreze drite që udhërrëfen rrugën e brezave.

Sot mendoj të trajtojmë një temë tjetër që është mjaft interesante dhe që kërkon prononcim nga intelektualët e Grykës së Zajeve, por edhe rivlerësim njohës të kësaj përkatësie gjeografike dhe historike, si një sipërmarrje për të promovuar një trevë, një histori, një rrjedhojë kohe, në shërbim të pasurimit të fakteve që e përafrojnë atë me gjithë krahinat e tjera, të cilat nuk janë më lavdiplotë se kjo, në emra as në histori.

Të gjithëve, por në veçanti intelektualëve u del imperativ nevoja e riparues dhe rishqyrtimit të fakteve dhe të vërtetave, të cilat i volisin krijimit të një klime besimi rreth vlerësimit të një njohjeje. Por lipset thënë se historia duhet të jetë e shkruar ashtu siç duhet dhe jo sipas pasioneve dhe orekseve të njërit apo tjetrit, të cilët nga pamjaftueshmëria e fakteve ose nga mjaftueshmëria e gjërave të përcipta, krijojnë pretendime premisash dominuese të së vërtetës për një zonë apo për një krahinë, për një emër apo për një personazh, për një vlerësim apo për një kontribut. Duhet t'u përcillet brezave nën dritën e fakteve dhe të vërtetave historike, ato elementë, ato faktorë përcaktues, të cilat janë jo vetëm bartës të së kaluarës, por edhe dëshmues të saj.

Jo vetëm për periudhën post-komuniste, por edhe atë të mëhershme, pak është shkruar për historikun e vendlindjes sonë. Zona jonë ka nxjerrë heronj dhe figura të shquara, personalitete të rëndësishme të kulturës dhe dijes, guximit dhe vendosmërisë, traditës dhe atdhetarisë. Kjo kolonë e gjatë dishepujsh të vlerave dhe krenarisë, i ka shërbyer vendit, por ata kanë ngelur pa u bërë të njohur, pa u përfaqësuar dhe vlerësuar sa dhe si duhet.

Për ne është detyrim i gjeneratave që në emër të mirënjohjes, në emrin e thirrjes së gjakut, në emër të plisit, në emër të dinjitetit të vendlindjes, t'i njohim, t'i promovojmë dhe ta çmojmë kontributin e tyre. Sepse është kjo përpjekje, është ky angazhim, është kjo detyrë, ajo e cila na nxit të jemi ne ata që do të shkruajmë ato faqe të historisë që trualli na i ka besuar ne. Sepse vetëm ne mund ta matim dhimbjen e kësaj toke, ta dëgjojmë kushtrimin e këtyre maleve, t'u bindemi këshillave të etërve flokëbardhë, ta lehtësojmë dhimbjen e kësaj plage.

E shkuara vetëm përmes gojëdhënave ka ardhur brez pas brezi deri në ditët tona. Ne duhet të pranojmë se kemi detyrën historike të nënshkrimit të kësaj kontrate për të dëshmuar, për të trashëguar, për të çuar më tej, për të mos e lënë të shuhet, të vdesë, ta nënshtrojë harrimi, një pjesë të krenarisë sonë, një domosdoshmëri që udhëton në kohë për t'ua pasuar brezave si amanet. Po, atë amanet që nuk e tret as dheu.

Arsyeja pse unë i hyra kësaj qasje, ishte se në realitet është shënuar një ndryshim shumë i kufizuar në drejtim të shkrimit ndërnacional të historisë. Çfarëdo interpretimesh që janë bërë dhe po vazhdojnë të bëhen, për atë kohë që ka shkuar, në kuptimin e atmosferës së përgjithshme të historiografisë, duhet thënë se pasqyrimi ka qenë jo i mjaftueshëm, por dhe mundësim i përvetësimit me pa të drejtë të historisë. Ky krim intelektual po vazhdon të bëhet rrugë. Dhe, është detyra jonë si intelektualë dhe individë me përgjegjësi të lartë qytetare dhe iluminuese, që ti themi ndal. Kësaj duhet t'ia arrijmë përmes ballafaqimit të dëshmive dhe fakteve, përmes atyre të vërtetave, të cilat edhe pse nuk janë thënë e demonstruar, ata janë vetë historia e kësaj krahine, e këtyre njerëzve, e kësaj përkatësie gjeografike dhe shpirtërore, kulturore dhe tradicionale.

E shkuara vetëm përmes gojëdhënave ka ardhur brez pas brezi deri në ditët tona. Ne duhet të pranojmë se kemi detyrën historike të nënshkrimit të kësaj kontrate për të dëshmuar, për të trashëguar, për të çuar më tej, për të mos e lënë të shuhet, të vdesë, ta nënshtrojë harrimi, një pjesë të krenarisë sonë, një domosdoshmëri që udhëton në kohë për t'ua pasuar brezave si amanet. Po, atë amanet që nuk e tret as dheu.



Le të cekimin Grykën e Zajave, një udhë e gjatë me shumë histori dhe shumë të panjohura, me pak dëshmime dhe shumë tjetërsime. Gryka e Zajeve, e merr emrin sipas mendimit tim, nga se përbëhet nga shumë burime natyrore dhe që gjatë vërshimeve nëpër rrëpira formojnë shtretër më ujë, që gjatë periudhës së dimrit pothuajse të gjithë këto lumenj janë të pa kalueshëm. Rrugëtimi i ashpër i këtyre lumenjve nëpër lugina shkëmbore ka bërë që erozioni, pushteti i dhunshëm i natyrës, sasitë e mëdha të vërshimit të ujit, e kanë mbushur këtë autostradë grykash në zoje.

Zanafilla e këtyre burimeve e ka burimin nga gurrat e Borovës, përgjatë gjithë lëvizjes që merr emrin e fshatit ku kalon.

Kur lumi arrin në Sebisht e merr emrin Zalli i Borovës, për të vazhduar më poshtë drejt Okshtunit, deri tek përzihen zajet me Zallin e Prodanit, Shullanit dhe Zallin e Plepes. Në Okshtun i thonë Zalli i Sebishtit. Më poshtë vazhdohet drejt dhe bashkohet me zallin e Tërnovës, ku ka një tjetër përzierje zajesh deri në Smollik, banoret e quajnë Zalli i Okshtunit. Dhe më poshtë në Lubalesh, emrohet Zalli i Smollikut, deri ku bashkohet me Lumin e Bulqizës e merr emrin Zalli i Lubaleshit.

Disa shkrues, nëpër gazetat e tyre, po punojnë në mënyrë sistematike duke e njësuar Grykën e Zajeve si territor të Gollobordës.

Kujtojmë se fshatrat që e përbejnë Grykën e Zajeve janë: Borova, Zabzuni, Sebishti, Muglica, Okshtuini i Madh, Prodani, Shullani, Plepa, Oreshnja, Ternova, Ternova e Vogël, Smolliku, Lubaleshi. Krijimi i këtyre vendbanimeve është e lashtë sa vetë historia. Njerëzia u vendosën përgjatë kësaj treve mbasi u shpërngulën nga fushat, sepse nuk e duronin shtypjen që u bëhej nga pushtuesit e huaj, të cilët nuk kanë qenë të pakët përgjatë rrjedhave të kohës. Një zhvendosje kjo që ka ndodhur jo vetëm në këtë pjesë të territorit shqiptar, por kudo, kudo ku njerëzit në pamundësi për t'u bërë vasalë të një pushtuesi të huaj, kanë braktisur gjithçka për të shpëtuar jetën dhe nderin, pasurinë shpirtërore dhe integritetin personal.

Duhet nënvizuar fakti se nga kjo trevë kanë dalë intelektualë që i kanë dhënë zonës dhe tërë shoqërisë, në nivel kombëtar dhe më gjerë.

Kohet e fundit sidomos në këto vite e ashtuquajtura të Demokracisë, kanë dalë shkrimtarë që pjesën më të madhe të këtyre fshatrave i quajnë Gollobord. Pra, sllavët duke gjetur terren të përshtatshëm në këto vite të vështira të tranzicionit demokratik, po mundohen ta shtrijnë sa më gjerë territorin e tyre. Kjo valë ekspansioni dhe dominimi, plaçkitjeje dhe tjetërsimi të historisë dhe vlerave përcaktuese të identiteti, ka qenë dhe mbetet një politikë e hershme asimilimi.

Për të vënë në ndakim këtë pretendim, duhet tu referohemi fakteve dhe të vërtetave, të cilat duhet t'i përdorim si armë mbrojtjeje të së vërtetës.

Kush është Golloborda?

1-Gollobordasit janë sllavë.

2-Gollobordësit kanë ardhur në këtë trevë, që ka marr emrin Gollobordë në shekullin e shtatë, kur vendi ishte nën perandorinë Bullgare.

3-Gollobordasit flasin vetëm gjuhën e tyre, që është gjuhë sllave.

4- Golloborda, gjuhën shqipe e flet si gjuhë letrare.

5- Golloborda nuk e flet gjuhën e Dibrës.

6- Golloborda ka ritet e veta, zakonet e veta, që janë ndryshe nga ato që ka Dibra.

7- Veshja e Gollobordës është karakteristike dhe përdoret vetëm nga kjo trevë.

Përpara se të vendosej popullsia e Gollobordës në atë trevë, zona ishte krejtësisht e pabanueshme dhe mbahej si vakëf. Popullsia e kësaj treve që përbën Gollobordën ka jetuar pothuajse gjithë kohën në kurbet.

Gollobarda dhe Gryka e Zajeve nuk kanë asnjë lidhje, veç se Okshtuni i Madh, i cili ka lidhje administrative me Ostrenin e Madh dhe vetëm kaq.

Po të përcjellësh me vëmendje ndër publikime të ndryshme, vëren se Hoxhë Hasan Muglica ishte gollobordas. Po kështu thuhet për Qemal Stafën, Sabri Cakën dhe për Mentor Muglicën. E vërteta flet krejt ndryshe.

Në kohën e pushtimit osman nga shekulli i gjashtëmbëdhjetë, administrata turke u mundua ta bënte Gollobordën një Vilajet Sllav, thotë Profesor, Kristo Frashëri te "Historia e Dibrës". E gjitha kjo në kuadër të luftës sllave për shkomtarizimin e shqiptarëve. Dibra e priti me urrejtje të madhe këtë vendim dhe nuk e përkrahu.

Po kështu edhe Zerqani (Smolliku), vendlindja ime u fut nën administrimin sllav, gjë që Zerqani as që e përfilli një vendim të tillë. Në Smallik janë pesë-gjashtë shtëpi që flasin gjuhën e Gollobordës dhe e kanë marrë këtë nga se kanë krushqi midis tyre (i kanë marrë nuset nga kjo zonë, por jo që janë gollobordas).

Sqarojmë me përgjegjësi profesionale dhe historike se Hasan Muglica nuk ishte gollobordas. Familja e tyre kishte ardhur në Muglicë si rezultat i persekutimeve të sllavëve nga Dibra e Madhe (siç shkruan E. Muglica) në librin kushtuar Hasan Muglicës.

Ndërsa, Qemal Stafa ishte me origjin nga Stafajt e Okshtunit, i cili kishte zbritur në Elbasan nga Zabzuni ku Familja Stafa kishte stanet. Me këtë dua të them se Qemal Stafa, gjithashtu nuk ishte gollobordas.

Me të njëjtën oponencë i përgjigjemi edhe për dy figura të tjera të rëndësishme të kësaj krahine, Sabri Caka e Mentor Muglica. Ata ishin dibranë dhe nuk ishin asnjë lidhje me Gollobordën, për më pak akoma, të ishin gollobordas.

Dy fjalë dua t'i them dhe për vete dhe për familjen time!

Ka mundësi që ndonjëri të më njësoj me gollobordasit. Këto përçartje nuk jam i prirur t'i konsideroj si të qëllimshme, por thjeshtë mangësi të një predispozite për të ngritur një pretendim dhe një fakt mbi hipoteza dhe supozime. Por historia dhe e vërteta njeh dhe pranon vetëm faktet.

U bëj me dije dhe e vlerësoj si obligim qytetar dhe intelektual të kumtoj se as gjyshi e as stërgjyshi nuk kanë pasur kurrfarë lidhje me Gollobordën, në traditë e zakone, doke e dëshmime, gjuhë as veshje. Ajo është krejt tjetër gjë dhe i përket një rrjedhoje të përkatësisë së saj, jashtë këtij përcaktimi.

Në shtëpinë tonë kurrë nuk është folur gjuha e Gollobordës, dhe për më pak akoma, të jetë zbatuar norma dhe kanune, doke dhe zakone të kësaj përkatësie gjeografike dhe historike, shpirtërore dhe kulturore.

Stërgjyshi im erdhi nga shehri, sot Dibra e Madhe, dy vjet para se Skënderbeu të merrte drejtimin e Arbërisë. Teodori ose (Todori, Tadori, Thedhori) gjatë gjysmës së dyte të shekullit të parë dhe gjatë gjysmës së parë të shekullit të dytë, ishin mbretëri në Iliriadë të Dardanisë. Ishte një nga mbretëritë më të zëshme, pjesë e Iliriadës së Dardanisë. Dy vëllezër ishin lënë aty që të gëzonin pasurinë e trashëguar ndër breza, ndërsa të tjerët, si të gjithë shqiptarët dardanë, kishin marrë rrugët e Europës.

Sot Teodorin e ke në Itali, Spanjë, Francë, Gjermani, Angli dhe deri në Amerikë.

Me Teodorët në Itali dhe në Amerikë kemi marrëdhënie të përbashkëta, respekti dhe mirënjohje, sidomos në rrjetet sociale.

Duke u kthyer pas në histori, më duhet ti përmbahem asaj të vërtete, sipas së cilës, Teodori siguroi, Gjergj Kastriotin –Skënderbeun, të strehohet gjatë gjithë luftës së tij kundra hordhisë turke në Tërnovë të Vogël, në vendin e quajtur KESHOJCE. Këtë siguri e bënë stërgjyshërit e mijë bashkë me banorët e pakët vendas.

Pak a shumë kjo është ajo që desha të përcillja në mënyrë të përmbledhur rreth disa saktësimeve dhe promovimeve të vërtetash, të cilat duhet të konsiderohen dhe të trajtohen si elementë të vlertë për ndërtimin e një panorame sa më të qartë të zonave të ndryshme të vendit, veçanërisht atyre, për të cilat flitet pak. Kjo përpjekje do të jetë fillimi i kërkimeve dhe trajtimeve në materiale më të zgjeruara që do të vijnë për publikun e interesuar si një faqe e re e një historie të shkruar ngutaz, por edhe të sajuar sipas orekseve dhe dashurave personale të individëve, të cilët e kanë neglizhua rëndësinë që ka e vërteta për cilëndo krahinë dhe zonë, për secilën figurë dhe personalitet.

reportazh

Hasan Leka do mbahet mend gjatë për kontributin, urtësinë dhe mençurinë e tij.

Një ditë me nxënësit e shkollës 9 vjeçare "Hasan Leka"

Nga **ZABIT LLESHI, SHAQIR SKARRA**

TAKIM I PARALAJMËRUAR

Vite më parë një grup intelektualësh dhe krijuesish nga Shumbati e kishin planifikuar të organizonin një veprimtari me nxënësit dhe mësuesit e shkollës së Shumbatit.

Vajza e vogël e Hasan Lekës, Elona, na nxiti që takimin e dikurshëm ta zhvillonim pikërisht në kuadrin e muajt të letërsisë. Në këtë nismë të bukur nuk ishin vetëm krijuesit e Shumbatit, por edhe intelektualë e biznesmenë që kanë dalë nga bankat e kësaj shkolle. Pjesë e kësaj veprimtarie u bënë anëtarët e kryesisë së shoqatës "Lidhja e Intelektualëve Dibranë", midis tyre Musa Riçku, mik dhe shok i vjetër i Hasan Lekës; Shpëtim Cami, Demir Osmani, Hajri Mandri, Shaqir Skarra si dhe bijë të shumbatit e nxënës të Hasanit si Servet Rama, Lavdrim Puci, Sali Shira, Ilmi Murati, Baftjar Kada etj.

Kështu, duke gdhirë 7 tetori, kur ora ende nuk kishte vajtur 6 e mëngjesit, u bënë bashkë të gjithë dhe u nisën tok drejt shkollës nëntëvjeçare "Hasan Leka" Shumbat.

Qielli ishte i ngarkuar me re e mjegull të hollë sa mendonim që nga çasti në çast do të shpërthenin shtrëngata të mëdha por koha gjatë gjithë ditës ishte në favor tonë. Shiu shpërtheu në fund kur u kthyem për Tiranë dhe Dibrën e lamë pas.

Mes bisedave të çiltra dhe tepër të sinqerta arritëm shpejt në qytetin e Peshkopisë, por nuk qëndruam, kishim vendosur që kafen ta pinim në Shumbat.

Shumbati, ndryshe nga shumë fshatra të tjerë, ka lokale dhe dyqane, që dallohen në të gjithë Ujemujën, disa prej tyre luksozë, që zor se i gjen në metropolin shqiptar. Lokali i madh në hyrje të fshatit me pronar Dritan Herra menaxhon edhe një market, ku banorët e fshatit nuk kanë nevojë të dalin në qytet, pasi të gjitha i gjejnë këtu. Shemsi Sulejmani përveç një marketi ka ngritur në katin e dytë një lokal për dasma, fejesa, gëzime e hidhërime, në shërbim të të gjithë banorëve të Ujemujës.

Dritani na priti me ngrohtësi e dashuri, na serviri kafen e mirëseardhjes, duke respektuar traditën e mikpritjes, të trashëguara brez pas brezi.

Shkolla nëntëvjeçare "Hasan Leka" është ndërtesë e re, e ndërtuar në vitet 1984-1985 si projekt për shkollë të mesme të bashkuar e sot ka mbetur thjeshtë shkollë nëntëvjeçare me një numër nxënësish tepër të kufizuar nga braktisja e fshatit nga vetë banorët për shkak të imigrimit brenda dhe jashtë vendit.. Godina e saj, ngritur në një kodër dominuese të fshatit ku tre mëhallat kryesore të fshatit duken si në pëllëmbë të dorës.

Dikur këtu ndodheshin"Lisat e Nurë Nelit", vend kryesor ku mblidhej fshati për vendime të rëndësishme. Sot nuk janë më, ekziston thjeshtë toponimi.

Shkolla ishte zbukuruar si për festë, kudo rregull e pastërti. Priste ish nxënësit e saj.

Kohë më parë shkolla ishte poshtë digës së liqenit, një ndërtesë e vjetër, totalisht e amortizuar nga vitet që mbarte në kurriz. Nga ajo godinë e vjetër doli një elitë intelektuale dhe krijuese nga Shumbati, ku mund të përmendim Hasan Leka, Selami Xhepa, Hajri Mandri, Shuaip Skarra, Jasim Mandri, Xhevat Fana, Xhavit Sulejmani, Besim Fejza, Rruzhdi Skarra, Gjuri Puci, Naim Mandri, Tofik Skera,Violeta Robi, Leme Visha etj.

Shkolla mban emrin e ish nxënësit të saj, drejtorit, birit të denjë të Shumbatit, intelektualit gjithëplanësh Hasan Leka.

Në kuadrin e muajt të letërsisë dhe arteve, në shkollën nëntëvjeçare "Hasan Leka", takohen



autorë, ish nxënës të kësaj shkolle. Në traditën e mirë arsimdashëse që inspiroi Hasan Leka pas çlirimit të vendit si mësues dhe drejtues i parë i kësaj shkolle. Ajo vazhdimisht ka nxjerrë dhe vazhdon të nxjerrë kuadro të aftë në fusha të ndryshme të ekonomisë.

Kolektivi mësues e nxënës na pritën ngrohtësisht, me respekt e bujari si në ditë feste, asgjë nuk mungonte për një eveniment të tillë, ku çdo gjë ishte organizuar mirë dhe bukur.

Kishin ardhur përfaqësues nga bashkia Dibër si: Denisa Basha e Diana Stojku bashkë me nëpunës të njësisë administrative Sllovë.

Në fillim drejtori i shkollës Mario Fejza pasi falenderoi dhe uroi mirëseardhjen të pranishmëve, ua dha fjalën nxënësve:

Një vajzë e re, nxënëse e klasës së nëntë nga Dipjaka, Fidaije Dika moderatore e këtij takimi nuk pati nevojë për pauza e ndërhyrje gjatë gjithë kohës por u tregua aq e aftë sa i mahniti të gjithë me përgatitjen e saj.

Me mjaft interes u dëgjuan interpretime të recituesve të shkollës Kristina Mandri, Olsi Smaçi etj..., si dhe montazhi letrar i grupit artistik të shkollës, përgatitur me pasion dhe profesionalizëm nga mësuesit e kësaj shkolle Xhezmie Kraj dhe Elona Reçi.

HASAN LEKA, ILUMINIST

Hajri Mandri bëri një panoramë historikut jo vetëm të shkollës, të jetës dhe veprës së Hasan Lekës, por edhe të udhës së tij të bukur krijuese, ndër të tjera tha:

"Hasan Leka në librin e tij me kujtime "Në rrjedhë të jetës", si një iluminist i etur gjithmonë për dituri, ndër filozofët e parë të Dibrës, ka dhënë një pasqyrë të gjallë të vetë individit që kalon në fakt nga fshati në qytet, nga varfëria tek jeta në metropol, nga prapambetja në fshatin dibran, tek rektorati e bota akademike, nga fëmijëria e tij që përbën kohën e vështirë, tek pjekuria intelektuale që përbën spiralen dhe thelbin e filozofisë pragmatiste të tij.

Midis idealistit të frymëzuar dhe njeriut të zhgënjyer qëndron Hasan Leka, protagonist i librit autobiografik, i cili për nga dendësia e aktivitetit të tij,mbetet një personalitet me vlera individuale për nga qëndrimet dhe morali që e kanë udhëhequr gjithmonë në jetë.

Hasan Leka ishte një iluminist i etur për dituri dhe këtë etje e përçonte në përpjekje konkrete për të ndriçuar mendjen dhe për të pasuruar dijen si mësues dhe edukator, duke e përcaktuar si kredon dhe rrugën e tij më të dobishme. Ai ishte një humanist i thellë në marrëdhëniet e tij me bashkëfshatarët dhe njerëzit e familjes dhe të gjakut, një model edukues për shoqërinë, pasi ai mbështetet në skrupuj moralë dhe të pandryshueshëm, duke ndihmuar brezin e ri të Shumbatit për shkollim, por edhe në veprimtari krijuese e atë të përditshme.

Brezat i janë mirënjohës për veprën e tij. Si krijues, ai shkroi tregime në një rrëfim mjeshtëror, me një leksik shqiptar të ëmbël, e fraza që rrjedhin natyrshëm, gjë që tregon për kulturën e lartë gjuhësore dhe letrare të tij.

Në fund bëri edhe një analizë të gjitha botimeve të djemve të Shumbatit që kanë botuar ndër vite, pastaj përmendi dy monografitë për Shumbatin, shkruar nga Shaqir Skarra, sidomos "Borxhin ta ktheva vendlindje", një monografi kjo e plotë për vendlindjen, për traditat historiko-kulturore të Shumbatit, vëllimet me poezi e dramat të shkruar po vetë nga Hajriu, botimin e monografisë së Venishtit shkruar nga Lavdrim Puci e Shaqir Skarra, bashkë me librat e botuar nga Dukagjin Hata, Dilbere Dika, Shega Murati, Mirela Skarra, Qazim Hata etj.

Në emër të shoqatës "Lidhja e intelektualëve dibranë" përshëndeti sekretari i saj prof. Shpëtim Cami, i cili duke e njohur nga afër Hasan Lekën foli pak mbi jetën dhe veprimtarinë e tij krijuese në periudhën që ai ishte sekretar i kësaj shoqate.

Ndër të tjera, ai shtoi: Lidhja e Intelektualëve dibranë u tregua e gatshme dhe është e nderuar të jetë në krah të Elonës, për të mbështetur organizimin e Ditës së Librit, në kuadrin e muajit të letërsisë, pikërisht në këtë shkollë e cila mban emrin e babait të saj dhe ish-kolegut tonë, Hasan Leka.

Si universitari i parë i këtij fshati, ish-nxënës, mësues dhe drejtor i kësaj shkolle, doktori i shkencave, Hasan Leka, do mbahet mend gjatë për kontributin, urtësinë dhe mençurinë e tij.

Tek Lidhja e Intelektualëve Dibranë, unë sot mbaj detyrën që mbante dikur biri juaj dhe miku jonë Hasan Leka. E kam për nder që eci në rrugën e tij, shembulli i të cilit më ka frymëzuar

Hasan Leka ishte një iluminist i etur për dituri dhe këtë etje e përçonte në përpjekje konkrete për të ndriçuar mendjen dhe për të pasuruar dijen si mësues dhe edukator, duke e përcaktuar si kredon dhe rrugën e tij më të dobishme.

dhe frymëzon çdo ditë për punë të mira ashtu siç rrezatonte ai mirësi dhe paqë.

Janë të paktë njerëzit e larguar nga fshati që shkruajnë për origjinën nga erdhën. Ndër këta të paktë është Hasan Leka, që mendonte e shkruante vazhdimisht dhe jo vetëm kaq. Në çdo bisedë me miq e shokë, me kolegë e të njohur hidhte idenë e vizitave ne vendlindje për të zgjuar tek brezi i ri dashurinë për letërsinë, artin dhe historinë.

TRADITA VAZHDON...

Shkolla e Shumbatit u hap 75 vjet më parë, më 1945. Ajo ka krijuar traditën dhe eksperiencën e saj për edukimin, veprimtaritë kulturore-artistike, edukimin me traditat patriotike etj. Kjo u pa edhe gjatë këtij momenti të bukur historik me rastin e muajit të letërsisë, të rralla në shkollat e vendit. Ne ndjemë nga afër dëshirën e madhe dhe vullnetin që kishin nxënësit për të mësuar. Për ata nxënës të mirë, të urtë e mjaft të edukuar primare ishte libri, jo telefoni dhe interneti. Të gjithë ishin të përgatitur, të gjithë recituan bukur dhe kuptuam se tradita e bukur në shkollën nëntëvjeçare "Hasan Leka" Shumbat ende vazhdon.

Skënder Kuta, ish mësues i kësaj shkolle, vlerësoi kolegët dhe nxënësit për arritjet e shkollës dhe uroi ta mbajnë me nder emrin e merituar të Hasan Lekës. Ashtu siç ka nxjerrë ndër vite intelektual të kompletuar, kjo shkollë do të mbetet një fidanishte e sigurt për të nxjerrë kuadro që do të drejtojnë sektorë të rëndësishëm të ekonomisë në vendin tonë, biznese të fuqishme në ndërtim e infrastrukturë, shembull në veprimtarinë prodhuese shoqërore dhe humane.

Moderatori i këtij aktiviteti, Dr. Hajri Mandri, i dhuroi shkollës librat poetikë "Prag Mijëvjeçari" dhe "Zjarret e ditëveres", vëllimet me studime letrare dhe ese "Refleksione estetike", "Trajtesa letrare dhe pedagogjike" botuar vitet e fundit, që pasurojnë bibliotekën e mësuesit. Pesëdhjetë libra dhuroi Shaqir Skarra.

Demir Osmani e pasuroi fondin e bibliotekës me 30 libra për sigurinë rrugore dhe edukimin e fëmijëve nëpërmjet kujdesit e kulturës për mjedisin.

Administratori i shoqërisë "Puci Sh.P.K" Lavdrim Puci, dhuroi për shkollën një kompjuter, një printer multifunksional dhe një fotokopje. Lavdrimi i premtoi drejtorit dhe përfaqësuesit të bashkisë të bëjë rrethimin e shkollës në një të ardhme të afërt.

Ilmi Murati dhuroi për nxënësit mjete mësimore, fletore e stilolapsa.

Aktivitetit po i vinte fundi por nxënësit ende nuk po largoheshin. Dikush kërkonte një autograf, dikush një libër e dikush një foto.

Vonë u larguam me mbresat e kujtimet më të bukura për shkollën, me dëshirën dhe premtimin për t'u kthyer përsëri.

Elona së bashku me bashkëshortin e saj mjekun Artur Turdiu kishin organizuar një pritje në qytetin e Peshkopisë për të ftuarit dhe një pjesë të kolektivit mësuesve që u morën me përgatitjen e këtij evenimenti. Veprimtaria vazhdoi me kujtimet për historinë e fshatit Shumbat, për njerëzit e tij punëtorë e arsimdashës, për Hasan Lekën dhe kontributin e tij në Lidhjen e Intelektualëve të Dibrës, si një model për vullnetin, humanizmin, por edhe për edukimin e fëmijëve të tij me dashurinë për njerëzit, fshatin, Dibrën dhe atdheun.

Në qytet filloi të binte mbrëmja, ne u larguam drejt Tiranës, duke marrë me vete dashurinë e banorëve, të fëmijëve të Shumbatit, duke asistuar në një veprimtari të pasur edukative dhe kulturore.





Rruga e Arbërit nr. 171

Presidenti Meta dhe dhjetëra personalitete të letrave e shkencës në promovimin e librit "MUHURRI, HISTORI DHE PERSONALITETE"

promovim

Në 60-vjetorin e ditëlindjes Halil Rama promovon librin kushtuar vendlindjes

Nga **AGRON SEJAMINI**

Promovimi i librit "Muhurri, histori dhe personalitete" të shkrimtarit dhe publicistit Halil Rama – Mjeshtër i Madh", ka bërë bashkë personalitete të njohura të jetës publike dhe politike të vendit. Në këtë veprimtari promovuese të organizuar nga "Botimet M&B", në bashkëpunim me Shoqatën "Bashkësia Dibrane" dhe Organizatën e Bashkuar të Veteranëve të LANÇ (OBVL) i pranishëm ishte edhe Presidenti i Republikës Ilir Meta, i cili në fjalën e tij përshëndetëse tha se libra të tillë na sjellin ndërmend vlerat e atdheut tonë.



"Ndër të tjera në këtë libër më bëri përshtypje titulli 'Atdheu fillon nga familja'. Pikërisht kjo duhet kuptuar drejt dhe edukimi atdhetar duhet nisur me dashurinë për familjen",-tha kreu I shtetit. Presidenti Meta, duke përshëndetur pjesëmarrësit në këtë veprimtari promovuese mbresëlënëse, ndër të tjera vlerësoi krijimtarinë e Halil Ramës, si mjaftë produktive dhe cilësore. "Ashtu si vetë autori Halil Rama, edhe personazhet që ai përshkruan në këtë libër, me mencuri kanë ditur të adaptojnë qëndrime dhe sjellje në përputhje me rrethanat e kohës, duke përzgjedhur qëndrim perspektiv e duke u bërë të dobishëm e me vlera kombëtare dhe shoqërore", tha kreu i shtetit. Në këtë kontekst ai veçoi monografinë kushtuar filozofit popullor dibran Dine Hoxha, këtij kolosi të mendimit, i njohur si këshilltari më i afërt i Mbretit Ahmet Zogu, por edhe si organizator i rezistencës popullore dibrane kundër pushtuesit serb, para një shekulli në mars - shtator 1920.

Në këtë promovim të moderuar me mjeshtri të rrallë nga Defrim Methasani, pasi ndoqën dokumentarin e ideuar dhe realizuar prej tij "HALIL RAMA – MJESHTER I MADH NE 60 VJETORIN E LINDJES", folën disa personalitete krijuese dibrane dhe kombëtare.

KAPEXHIU: PËRKUSHTIM, SERIOZITET, DINJITET, DASHURI PËR VENDLINDJEN

Kryetari i Shoqatës "Bashkësia Dibrane, Prof. Bujar Kapexhiu – Nderi i Kombit, duke përshnëdetur në emër të kësaj Shoqate, ndër të tjera ths se shkrimtarë si Halil Rama që shkruajnë për vendlindjen e tyre duhet të ketë më shume vendi ynë. Edhe në këtë libër,-tha Kapexhiu, autori shfaq përkushtim, seriozitet, dinjitet, dashuri, mall, respekt, mburrje, nostalgji, krenari, të gjitha së bashku këto ndjesi, si një gjerdan gurësh të çmuar në gjoksin e Halil Ramës, japin shkëlqimin dhe meritën e të suksesshmit që çdo muhrrak e çmon dhe e vlerëson këtë punë, që duke mbledhur germë pas germe, ashtu siç milingona punon, ka ngritur me pasion këtë kështjellë kryelartë, të pakrahasueshme të Muhurrit. Ai e vlerësoi librin "Muhurrin, histori dhe personalitete" si një privilegj për muhrrakët, se kudo, në çdo cep të botës që të jenë do të kenë pranë vetes malet, fushat, lumin, lulet, shtëpitë, komshinjtë, familjen e gjithë të njohurit e dashur e të shtrenjtë të vendlindjes, për të mos i harruar kurrë. Kjo sipas tij për faktin se në faqet e këtij libri, midis rreshtave, si në një pasqyrë, çdo muhrrak do të shohë veten dhe do të arrijë në përfundimin se



në këtë pasqyrë të krijuar nga mendja dhe dora e Halilit duket më i mirë, më trim, më punëtor, më i bukur e më i mençur.

LULJETA PRENÇI-DISHI: TESTAMENT I VYER HISTORIKO-KULTUROR

Duke ndarë me qindra pjesëmarrësit në këtë promovim, përjetimet si redaktore e librit, znj. Luljeta Prenci-Dishi (Drejtore e gjimnazit "Ibrahim Rugova" Kamëz), duke shpresuar të ketë përmbushur pritshmëritë e H.Ramëst, lidhur me cilësinë e redaktimit në përputhje me llojin e tekstit...(letërsi dokumentare) falenderoi autorin i cili i dha mundësinë ta shfrytëzojë kohën e izolimit në mënyrën më të mirë të mundshme, pikërisht duke redaktuar këtë libër të rëndësishëm që lartëson vlerat e Muhurrit dhe të muhurrakëve, vlerat e zonës nga ajo vjen dhe ku kaloi fëmijërinë dhe rininë e saj. Gjatë redaktimit të librit ajo pohoi se është njohur më nga afër me historinë e lavdishme të zonës së Muhurrit si dhe me kontributin e vyer të sa e sa personaliteteve historike apo aktualë të asaj zone, të cilët na bëjnë krenarë ne sot.

Nisur nga fakti se secili nga ne, me punën dhe përkushtimin e vet, jep një kontribut të zakonshëm ose të jashtezakonshëm gjatë jetës, e megjithatë jemi të përkohshëm në këtë botë, redaktorja Prenci-Dishi tha se: "Falë njerëzve të tillë si Halil Rama, që lartësojnë vlerat tona, kontributi ynë për zonën dhe për shoqërinë mbetet si një testament për brezat" . E në këtë kuptim, ajo e konsideroi librin e tij "Muhurri, histori dhe personalitete" një "Testament të vyer historiko-kulturor" në dorën e muhurrakeve dhe jo vetëm....

KOLONEL MYFIT GUXHOLLI: ATDHEDASHURIA, LAJTMOTIV NË KRIJIMTARINË E H.RAMËS

Kryetari i OBVL, kolonel Myfit Guxholli, në përshëndetjen në emër të kësaj organizate veçoi dy kapituj të këtij libri: "Muhurri në Nëntë Malet e Dibrës" dhe "Kontributi i muhurrakëve në Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Pikërisht nisur nga evidentimi i patriotizmit të popullit të kësaj krahine në luftart për liri e pavarësi, klonel Guxholli vlerësoi mesazhin e atdhedashurisë që përcjell autori H.Rama nëpërmjet këtij libri tek brezat e sotëm e të ardhshëm. Ndërkohë ai vlerësoi qëndrimin e Presidentit Meta për promovimin e vlerave më të mira të kombit tonë dhe veçanërisht dekorimin prej tij të heronjve e dëshmorëve të kombit.

SHPENDI TOPOLLAJ: PËR HALIL RAMËN E PARA ËSHTË SHQIPËRIA

I fokusuar në profilin krijues të Halil Ramës, shkrinmtari dhe publicisti I njohur Shpendi Topollaj, ndër të tjera tha se: "Halil Ramën, i cili në çdo vend ku ka punuar, ka mbetur po ai; i thjeshti, kokuluri, dashamirësi, i qeshuri, fjalëpaku, pajtuesi dhe përherë, i palodhuri. Kjo është dhe arsyeja përse ky gazetar e shkrimtar i pa bujë është kaq dinjitoz, dhe ka aq shumë miq e shokë, gjë që bije në sy menjëherë në veprimtaritë që organizon me shokët e tij, ku gjithmonë salla do të jetë e mbushur, me pjesëmarrës të të gjitha fushave. Nga viti 2003 që Halil Rama drejton gazetën "Veterani" organ i OBVL, çdo lexues ka gjetur në shkrimet e botuara, evokimin e ngjarjeve madhore të Kombit, përpjekjet për liri në shekuj, epopenë e lavdishme të Luftës Nacional – Çlirimtare, rolin e atyre që drejtuan formacionet partizane, kujtimin e dëshmorëve që dhanë jetën për atdhe, ndeshjen me bishën serbe të UÇK – së në bashkëpunim me Forcat e NATOS, ndikimin e SHBA në pavarësinë e Kosovës, dëmin që si kudo edhe te ne solli ideologjia komuniste, dhe kurrë nuk mund të gjesh një rresht të vetëm që të mbjellë përçarje. Për Halil Ramën e para është Shqipëria. Ai gjithmonë ka pasur për devizë thënien e poetit salaminas Euripidit "O, kurrë mos u lodh për ndihmën që i jep Atdheut!" Ndaj dhe Atdheu e shpërblen birin e tij me atë titullin e lartë "Mjeshtër i Madh", si mirënjohjeje".

SHOQATA "LABËRIA": LIBËR I SHKRUAR ME DASHURI DHE FINIKËRI PËR VENDLINDJEN

Dr. Asllan Zemani, drejtor i Muzeut te Forcave te Armatosura, duke përshëndetur në emër të kryesisë së Shoqatës Kulturore Atdhetare "Labëria" - "Nderi kombit", dega Tiranë, tha se libri i Halil Ramës ka për mision në kohën e sotme, që për të për dymbëdhjetë katundet e kësaj zone, me histori mjaft të pasur, ta ruaj atë



në shoqërinë e integruar, kur po sakrifikohen shumë e shpesh pa të drejtë nga identiteti ynë i spikatur, nga traditat, zakonet dhe njerëzit që kanë bërë histori, sepse njerëzit janë larguar nga fshatrat për të gjetur botën e Re. "Libri është shkruar me dashuri dhe fisnikëri për krahinën, për Muhurrin, vendlindjen e autorit, *zonë* e përmendur në historinë e vjetër dhe të re të Dibrës. Këtë libër, edhe ne të shoqatës "Labëria" e vlerësojmë si një pasuri të vyer, por edhe si një nevojë të fuqishme shpirtërore, për të ruajtur e transmetuar në breza vlerat dhe virtytet më të mira të të parëve tanë, por dhe të brezave tonë. Në këto kushte e me këtë synim, në praktikën e punës së shoqatës, është të mbajë lidhje e bashkëpunim vëllazëror me të gjithë fshatrat e krahinës, apo edhe me trevën e Dibrës, duke zbatuar misionin fisnik, me vullnet të lirë, para vendlindjes dhe të parëve tanë, vjen libri i Halil Ramës që brezit të ri të mos i mungojë vendlindja, historia e familjes, e fisit, të mos u mungojnë varret e të parëve, xhamitë, dasmat dhe ritet tradicionale tepër të pasura",-tha ndër të tjera Dr. Zemani.

DR.HAJRI MANDRI: DUKURI ESTETIKE TE LIBRI I HALIL RAMËS

Përjetimi estetik i jetës në mënyrë sa më intensive është synimi suprem i njeriut. Kështu, kur lexojmë këtë libër të Halil Ramës, dukuria estetike që shkakton leximi i tij, ka të bëjë me ndjenjën e të bukurës dhe kënaqësisë estetike që të krijon. Pasioni, malli, adhurimi e dashuria që autori derdh ne të e ka bazën te vlerësimi që ai ka për traditat si mikpritja bujaria, trimëria, zgjuarsia, humaniteti që evokojnë krenarinë për vendlindjen, si substancë e krenarisë kombëtare.

"Jeta politiko-shoqërore e banorëve muhurakë në mënyrë konvencionale na jepet me intelektualët e zonës duke i vendosur në kohë shëmbëllejnë si gurë kilometrikë në libër që lajmërojnë kohën, mendësinë, psikologjinë, dhe ideologjinë e kohës që përfaqësojnë dhe habitatit ku kontribuojnë.

Dashuria për vendlindjen jepet me një optimizëm të trëndafiltë. **P**ërmes figurave të përzgjedhur me kujdes krijojnë një vatër estetike si mirënjohje për punën, përkushtimin, ndershmërinë, zgjuarsinë, bujarinë, humanizmin mikpritjen komunikimin elitar, të ëmbël e të këndshëm. Në këtë libër, mbi doktrinat që na ndajnë është dashuria për kombin. Gjejmë ën të larmi imazhesh, idesh dhe personazhesh të venë në lëvizje imagjinatën dhe përfytyrimin estetik drejt vlerave morale dhe humane. Mjafton shëmbëllimi për të mbërritur intuitivisht te thelbi.

Halil Rama ka zgjedhur një procedim te dobishëm për lexuesin. Pasi vë kuotat hitoriko-kulturore autori përmes personazheve realë, lundron nga një periudhë në tjetrën duke identifikuar si xixëllonjat në fusha, personazhet realë që drejtuan dhe krijuan raporte me vlera morale e shoqërore e që kanë lënë gjurmë tek pasardhësit që duke i kujtuar krijojnë kënaqësi estetike, si ndjenjë e të bukurës që vjen nga rrëfimi.

Autori e mbyll librin me figura aktuale nga zona a tij që kontribuojnë në ndërtimin demokracinë liberale si mishërim i vlerave të shoqërisë që jetojmë.

BUJAR KAROSHI: REFERENCË E RËNDËSISHME E HISTORISË SË ZONËS

Ishte nder dhe privilegj për mua të punoja së bashku me Halilin për përgatitjen për botim të librit "Muhurri-histori dhe personalitete".

"Libri është një enciklopedi e gjithë zonës, prej hershmërisë antike deri në kohët moderne, me bëmat dhe gjëmat e saj, pa kritere përjashtuese, duke filluar prej përshkrimit gjeofizik deri tek ai etnografik e historik; mbështetur në kujtesën e shkruar dhe atë gojore. Besoj se libri do t'i ndihmojë brezat e rinj jo vetëm për të njohur paraardhësit, por edhe kushërinjtë e tyre. Në këtë kohë largësimi ky është një shërbim që meriton nderim", shkruan mes të tjerash në parathënien e librit, prof. dr. Shaban Sinani, akademik.

Duke vazhduar arsyetimin në këtë logjikë, më duhet të them se jo shumë larg, por pas një a më shumë dekadash, libri i Halil Ramës do të jetë një referencë e rëndësishme e historisë së zonës, e lidhjeve të njerëzve të kësaj krahine me të afërmit dhe me Muhurrin.

Në zhvillimet e reja që po ndodhin në vend, këto ditë po flitet shumë për ndërtimin e Hidrocentralit të Skavicës, një variant i të cilit i mbulon ato troje krejtësisht me ujë.

Unë nuk jam në gjendje të them këtu nëse kjo është e mirë apo e keqe, por dua të theksoj se ato troje nuk mund dhe nuk duhet të mbulohen nga uji, për sa kohë njerëzit e atyre anëve, ata që banojnë atje dhe ata që janë në këtë sallë, nuk bien dakord.

Në ditët e sotme epidemia na kanë kujtuar se nuk është e rëndësishme të jesh i pasur apo të ndërtosh jetën tënde në një vend të zhvilluar e me liri ekonomike e demokratike, por është më e rëndësishme të jesh pranë njerëzve të tu të gjakut, miqve e vendlindjes, të jesh më afër vendit tënd e tokës tënde.

Në këtë kuptim, personazhet dhe personalitetet e gjallë të përshkruar në këtë libër, duhet të udhëheqin një proces dëgjimi e konsultimi në mënyrë që asnjë hap të mos ecet më tej nëse ata që e kanë ndërtuar jetën atje e po punojnë në ato toka e ato troje, të mos braktisen, të mos nënvleftësohen, e aq më keq të sakrifikohen.

Ndryshe pas 3 a 5 dekadash, në këtë sallë si kjo e më të bukura se kjo, do të mblidhen pasardhësit tanë dhe do ta analizojnë fshatrat atë që ka humbur në ujëra, dhe që në librin e Halilit janë të lexueshme qartë që në faqen e parë përmes një harte topografike!

Të lumtë Ramadan Biba me vëllezër e cilitdo që nderon trojet, lartësojnë vlerat, që gjallojnë jetën, bijtë që dritësojnë vendlindjen!

Bijtë që nderojnë vendlindjen...

Nga **MEVLUD BUCI**

Pak kohë me parë, kur me ftuan lurianët e nderuar mësuam një fakt sesi gurë-lurasit ndonëse disa banojnë që kanë rregulluar shtëpitë dhe nuk e harrojnë vendin e tyre të shtrenjtë. E thjeshtë, por e bukur, krenarë dhe e madhërishme, emocionuese, por edhe njerëzore që sadopak cilido të bëjë si bijtë e Gurë-Lurës. Puna dhe dashuria, nderimi dhe lartësimi i vlerave, uniteti e vëllazërimi, pasqyrimi i figurave të ndritura e plot të tjera e dritësojnë atë, vendlindja është e mbetet e shtrenjtë si jeta, si familja, si drita e ajri: Vendlindja.



Kulla e Fadil Hasan Perhatit (Restauruar, ringritur nga inxhinier Arben Fadil Perhatit, i biri)



Vendi i shenjte i Katundit te Vjeter (Murre), Teqja e Kros Shehit dhe varri i tij, te ringritura



Kulla e Kros Shehut

NDERIMI PËR GJYSHIN...

Krahas punës e dijes Dritan Brunga ndjen peshën e krenarisë e të mallit, obligimin, për atdhetarin, besimtarinë e pajtimtarin e nderuar, Hoxhë Brunga. Ky burrë i urtë ku për 24 vite qëndroi në Stamboll (nga këto 20 vite për inxhinier dhe 4 vite për Hoxhë), shërbeu për 50 vite imam në Gurë-Lurë qysh prej vitit 1928 kur erdhi në Shqipëri. Sulejman Abaz Brunga (Hoxhë Brunga) e deshi shumë vendlindjen, u priu pleqësisë e kuvendeve, ndihmoi për vëllazërimin, unitetin për të lartësuar traditat, kararet. Me të drejtë këngëtari Gëzim Ahmeti me krenari na tha se do t'i këndonte këtij burri të nderuar. Gjurmët e Hoxhë Brungës burojnë në vendlindje në Gurë-Lurë. Ai dha prova urtësie, prova pune ku ndihmoi për ngritjen e sharrave të ujit në Lurë, Kukës, Pukë etj. Vendlindja është "regjistër" i madh, ku nuk i harron kurrë gjurmët e bëmat e bijve të vet: Atij që deshi vendlindjen dhe la rezultatin e provave të mençurisë, të besimit, të punës e të pajtimit s'ke sesi nuk i gdhend vargje shpirti, vargje që ngjajnë si blerime e fllade, vendlindje.

... Çaj Hoxhë Brunga biri i gurit / Besimtar e burri i burrit / Nëpër mote me za betimi / Në krye t'pleqve me drit' pajtimi / E ndërton Lura mot pas moti / Imam bese – nip Kastrioti / Nipi i Hoxhës çaj Dritani / Mendjendritur e gen luriani / Gjyshin e tij si shqipet n'shkrep /E nderon vendlindja e vet...

Mall dhe krenari, nderim për vlerat, prova dritësimi kanë bijtë e Gurë-Lurës për fshatin e tyre, të cilin nuk e harrojnë, por ndërtojnë e zbukurojnë shtëpitë, lartësojnë gjurmët e atdhetarisë. Bijtë e Kalisë, të Hotit, të Nezhës etj., biri i Brungës: Dritani nuk harrojnë vlerat e vendlindjes. Me të drejtë nipi krenohet me gjyshin. Nderim paç Dritan Brunga i Gurë-Lurës!

MURRA E VJETËR RINGRE KULLAT...

Sapo ngjit Kepin e Gjevetit në sfond të shfaqet Katundi i Vjetër (Murra). Gjelbërimi dhe shumica e kullave në këmbë e ata që po ngrihen tregojnë se këtu ka jetë, kurrë nuk harrojnë bijtë e vet. Ja, këtu Sulë Elez Miha që banon në Durrës, po ngre shtëpinë e re, - më thotë ish nxënësi im Haxhi Pasha, i cili ka ardhur tek kulla (u largua, familjarisht nga Instituti erdhi në trojet e vjetra). Diku tej punohet për një rrugë të re në lagjen përtej shkollës për tek kullat e Bibës e të Dukës. Fëmijët e ciklit fillor që luajnë këtë mëngjes, ende pa filluar mësimi me përshëndetjet dhe zërat e tyre më emocionojnë, më çojnë këtu e mbi 50 vite përpara, kur për herë të parë në shkollën e Qafëmurrës nisa profesionin e nderuar të mësuesisë. Në ciklin e Katundit të Vjetër, tashmë me klasa kolektive, jep mësim mësuesi i palodhur e veprimtar Hysen Ibrahim Topalli, kurdoherë, i kudondodhur pranë fëmijëve e prindërve, dikur ish nxënësi ynë shembullor, ku me përkushtim ngjiti udhët e dijes. Mes zërave të ëmbël të fëmijëve largohemi drejt rrugës së re. Ramadan Biba me disa punëtorë po punonte për urën e shtrimin e rrugës së makinës, të cilën e ka çuar deri tek kulla e tij që po rindërton dhe deri tek kulla e Dukës mbi çatinë e të cilës valëvitet flamuri kombëtar në çdo stinë. Pasi vizitojnë kullën e Dukës, ku valëvitet flamuri, drejtohemi tek kulla e Ymer Bibës (ndjesë pastë), ku punojnë disa ustallarë. Dan Biba, që mban emrin e gjyshit nacionalist Ramadan Biba, ka mbi 6 muaj që punon për rindërtimin e kullës, e cila i ngjan një kështjellë qëndrese. Ka punësuar gati 10 punëtorë. Kanë vilat në Laprakë secili vëlla, por po ndërtojnë kullën – kala.



Ramadan Ymer Biba, përpara oxhakut të kullës me tre poda në Katund të Vjetër (Murre) e ringritur.

Tek ngjitim shkallët e kullës për të parë ndërtimet në kate takohemi me mjeshtra, të thjeshtë e punëtorë.

- Jo, ky është nga Hoteshi, nipi i Llan Destanit, është i fisit Skuka, - na thotë Ramadani. A keni dëgjuar për Mehmet Skukën? – e pyes unë.

- Unë jam Mehmet Skuka i ri, mbaj emrin e gjyshit – më tha mbaj emrin e gjyshit – më tha. Ndërkohë m'u kujtuan fjalët e tim eti gati këtu e 60 vite më parë që më pati folur (ndjesë pastë) për Mehmet Skukën e vjetër, për Murrët, Ali Likën, Manukët, Uket e Meret e Luznisë. Ato që më tregonte im atë, pas shumë vitesh, i gjeta dhe te libri i të nderuarës Emrie Skuka (Mera) "Sinoret e Luznisë" (f. 157 etj.). Në katet e kullës së Bibës m'u kujtua historia e qëndresës, bujaria e Ramadan Hysen e Zenel Bibës, brezat e hijeve që nderojnë trojet në fshati Murrë (Katund të vjetër)...

BIJ "MAGNET" PËR VENDIN KU KANË LE...

Vërtet ata që nderojnë vendlindjen, apo qoftë edhe të jetojnë me krenarinë a vlerat e saj, duke mos e harruar kudo që të ndodhen ngjajnë me magnetin. Këta bij të thjeshtë apo intelektualë, zyrtarë, të varfër a pasanikë, qofshin vetëm blerojnë, vetëm dritësojnë. Në katundin e vjetër (Murrë) fshati më i lashtë i Katër-Grykëve e më gjerë është vendlindja e Hoxhë Kamberit (Prrejit), prijsit popullor Halil Haxhi Daçi, i trimit të mbajtjes së tre bajraqeve Ismail Nika, kapiten Ahmet Perhatit, shkencëtarit Ramadan Perhati, i atdhetarëve të shquar Salë e Maliq Manreka, i intelektualëve të provave të zotësisë si Ramadan Manreka (Dan Sala) Ibrahim Manreka, Fadil Perhati, Osman Miha, Hazis Biba, Halit Miha, Ferit Manreka, Rufat Nika, Qamil Perhati, Dervish Biba, Ahmet Shehu, Ahmet Llan Miha, Luan Manreka, Halil e Dervish Miha, Petrit Perhati, inxhinierit e drejtuesit vyrtuoz të Dibrës, Sefer Manreka, inxhinier Arben Perhatit, heroit të hidrocantreleve Haxhi Manreka e të tjerë.

Murra e vjetër është vendlindja e biznesmenëve human Ramazan Zenel Biba, Rustem Ymer Biba, Latif Hidër Miha, Ferit Shaban Biba, Nderit të qytetit të Bulqizës Osman Miha. Pasi pimë ujë të ftohtë të shkrepit përballë kullave, shikojmë kullën e re të gurtë të restauruar nga inxhinieri Arben Perhati, në sfond janë kullat e Xhemal Perhatit, të Rrahman Nikës, Bajram e Rrahman Nikës, të cilët ndonëse nuk jetojnë, kanë bijtë që u japin jetë e hijeshi kullave. Ky peizazh më ngjan si Akropolisi, vend shkencor me sira kullash dy-tre katëshe, vend plot madhështi e bujari. Vend i bukur e i bekuar, fshat në unitet e vëllazërim, fshati Murrë, i kullave të bardha e plot histori, fshat plot jetë me bijtë "magnet" për vendin ku kanë le...

Ç'M'U KUJTUA BUDI...!

Duke ecur si nëpër shkallë përmes kullave të Murrës së Vjetër m'u kujtua vargu i ndritur i Budit të Madh:

"Ku janë ata pleq bujarë...?!"

Si në ekran m'u kujtuan të urtët Stafë e Xhemal, Perhati, Kros Shehi, Elmaz Prrejsi, Hidër e Hysen Miha, Salë e Maliq Bajrami (Manreka), Elez Duka i parë, Rrahman e Bajram Nika. Këta e plot të tjerë që ua dëgjova zërin e fjalën, që ua mësova urtitë nuk jetojnë më. Në kullat e tyre janë bijtë, nipat e mbesat, edhe ata që të paktë nga ky fshat që janë larguar nuk e harrojnë vendlindjen. Te kulla e Bajram Nikës, burrit të mjeshtrisë së alegorive, gjej moshatarin e ish kolegun tim të nderuar (tashmë mbi 70 vjeç) Rufat Bajram Nikën. Ai siç duket i ka vënë "shpatullat" kullës sikurse Tahir Nika, Ramazan Perhati e Ferit Nika, Qemal Duka etj., në kullat e tyre. S'ke si nuk emocionohesh përpara bijve të këtyre kullave, bij që dritësojnë gjurmët e brezave. Në sfond më shfaqet një kullë-kala gjysmë e shembur. Është kulla përballë vendit të shenjtërisë, kulla e Rrahman Veli Shehit (Kros Shehit), ku sikurse Hysen e Zilë Meta të Selishtës më 1943 i thanë komandantit të lirisë: - Or Llesh Dibra digje kullën! Ky qe Kros Shehi. Sot kjo kullë pret, s'duhet rrënuar ajo mban histori, besë e bujari.

Zbresim nga Katundi i Vjetër me lot në sy, me krenari e dhimbje në sfond shtëpitë e reja të Rustem Bibës, Arben Perhatit, Sulë Elez Mihës më japin shpresë, pak kulla gati të rrënuara më ngjallin dhimbje.

Vendlindja pret, vendlindja thërret. Sytë më shkuan edhe tek flamuri mbi kulla si kulla e Dukës, e Bibës etj. Të lumtë Ramadan Biba me vëllezër e cilitdo që nderon trojet, lartësojnë vlerat, që gjallojnë jetën, bijtë që dritësojnë vendlindjen!




Kulla e shembur e Veli Rrahman Shehut, Muhurr



Kulla e qendreses e Rrahman Veli Shehit



Kulla me tre poda e Ymer Bibes ne ringritje



SHITET

1 200 m² katror sipërfaqe e përdorshme për biznes dhe banim.
300 m² lokal, bar kafe dhe restorant, i përshtatshëm për dasma, 100 m² kuzhina.
4 apartamente, me dy dhoma të mëdha gjumi dhe 2 të tjera me një dhomë.
Restoranti ka katër banjo moderne dhe një dhomë ndërrimi.
Lokali në katin e parë është 200 m² + magazinë, qilari është 30 m².
Bari - 30 m² brenda dhe 140 m² ambienti i jashtëm.

Për një vizitë në pronë, kontakto: ***068 65 08 441*** ***ramizgjini@yahoo.com***



www.rrugaearberit.com

Na ndiqni *online*, falë ndihmës së z. Agim Deva, të cilin e falenderojmë për ndihmën dhe përkushtimin.

Informacioni për faqen online: **info@rrugaearberit.com**

Informacioni për versionin e printuar: **rrugaearberit@gmail.com**

Përdor KONTAKT PAGE për pyetje dhe sygjerime.

Shtyp butonin **"NDIHMO EDHE TI"** që gjendet në faqen e parë në versionin online për tu abonuar dhe kontribuar në botimin e gazetës, ose kontakto me redaksinë. Çdo kontribut bëhet publik.

Çdo lloje kontributi shkon në masën 100% në llogarinë e gazetës në Tiranë/Shqiperi në mënyrë të sigurtë përmes PayPal.

Ëebsite është një kontribut në shërbim të botimit të gazetës "Rruga e Arbërit", lobimit për ndërtimin e rrugës me të njëjtin emër, që do lidhë Tiranën me pjesën tjetër të Ballkanit në Lindje të Shqipërisë, si dhe zhvillimin e Dibrës dhe krahinave përreth.

Mund të na ndiqni edhe në Facebook duke kërkuar me emrin "Rruga e Arbërit" ose përmes lidhjes:

https://tinyurl.com/lcc3e2f

REKLAMO BIZNESIN TËND

Një faqe e plotë me ngjyra kushton 15000 lekë

Me **1000** lekë mund të rezervosh një reklamë gjatë gjithë vitit në format kartvizite (8x5cm)

NE jemi gazetë e lirë dhe e pavarur nga ndikimi politik. Pavarësia dhe liria jonë garantohet vetëm nga mbështetja e lexuesve...
BËJ PAJTIMIN TËND!

Një pajtim vjetor kushton: **600 lekë.**
Në Europë: **10 Euro.**
Në SHBA dhe vende të tjera: **15 USD**.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Botimi i gazetës është punë vullnetare, ndaj çdo pajtim vjetor ose dhurim, është i mirëpritur. Dhurimet pranohen vetëm përmes llogarisë bankare që gjendet më poshtë dhe për çdo rast ai do të bëhet publik.
Raiffeisen Bank, Rr. Kavajës, Tiranë. Sëift code: SGSBALTX.
IBAN(ALL): AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Bigmarket
PESHKOPI

DI ÇFARË ZGJEDH!

GJITHMONË ME OFERTA...

cyan magenta yelloë black

veprimtari

Gazetari sportiv DEFRIM METHASANI, rikthehet në shkollën e mesme "Nazmi Rushiti" në Peshkopi, tashmë me një tjetër mision të tij të ri.

Aty ku e nisi...!

Kupa, medalje, dhurata, aktivitete dhe mesazhe paqe dhe shprese me yjet dhe modelet e sportit dibranë dhe shqiptar, Shulku, Demollari, Toska, Cibaku, etj.





Aty ku e nisi...! Një tjetër gjetje e gazetarit të mirënjohur sportiv në vend, Defrim Methasani, një djalë dibran, që jo rastësisht është nderuar me titullin e lartë "Qytetar Nderi" në Dibër. Ai shkoi sërish në vendlindjen e tij, edhe pse atje shkon shpesh, por tashmë me një tjetër mision, që u mirëprit me entuziazëm, ashtu si një vit më parë në fshatin e lindjes së tij, në Sohodoll. Këtë herë ai vajti në shkollën e mesme "Nazmi Rushti" në Peshkopi, aty ku ai nisi të luajë me "Korabin", aty ku ai nisi të shkruajë në gazetën lokale të kohës "Ushtima e Maleve", aty ku nisi të shkruajë në gazetën "Sporti" dhe të bashkëpunojë me Radio Tiranën dhe televizionin shqiptar, ku tashmë militon prej 30 vitesh. Ndaj, në shenjë mirënjohje, ai kthehet aty pas 36 vitesh kur ka mbaruar shkollën dhe kërkon të bëjë diçka mes nxënësit e shkollës dhe stafin e saj.

Tashmë, kuptohet që nuk janë ata mësues kur ai studionte aty, por misioni i tij dhe modelet që zgjodhi të merrte me vete flasin shumë. Defrimi mori në grupin e tij edhe Ilir Shulkun, një djalë dibran, që iku prej Peshkopie kur ishte 10 vjeç, por që zanafillën e tij me lojën e futbollit e ka aty. Tashmë Shulku drejton federatën shqiptare të futbollit si sekretar i përgjithshëm i saj dhe ishte dikur futbollisti i Partizanit, ekipit kombëtar dhe arriti të luajë edhe me formacionin më të mirë të botës, në një ndeshje miqësore përballë Brazilit.

Bashkë me të ai mori edhe një emër legjendë të futbollit tek ne, Sulejman Demollarin, Mjeshtër i Madh, ish futbollist i Dinamos dhe kombëtares, por njëherësh i shpallur edhe si futbollisti i huaj më i



miri në Rumani. Dy kupat që Methasani i kish pikasur për futbollin, kishin pikërisht emrat e tyre. Por ndërkaq jashtë vëmendjes ai nuk la as Bashkim Lalën, trajnerin e famshëm të volejbollit, që e nderoi pas vdekjes me kupën në volejboll për vajza dhe Ismet Bellovën, legjendën e mikrofonit sportiv në Shqipëri, të cilin e nderoi me kupën e basketbollit për vajza.

Me Defrimin ishin edhe mjaft kolegë gazetarë sportivë të ardhur nga Tirana dhe rrethet, por edhe dy emra të spikatur dhe simbole të sportit dibran, Shpëtim Toska, ylli i futbollit dhe Xhelil Cibaku, një medalist i njohur i tapetit dhe kampion absolut në sportin e mundjes.

Drejtoresha e shkollës Alma Selami, e cila kishte bërë një orga-



nizim mjaft të mirë së bashku me stafin e saj dhe veçmas dy mësuesit e edukimit fizik Erblin Laçi dhe Mirela Hoxha, ka ditur t'i presë miqtë e pazakontë të kësaj shkolle. Fillimisht ajo dhe stafi i saj kanë ka pritur personazhet interesantë të një dite të tillë në ambientet e shkollës dhe më pas një bashkëbisedim i ngrohtë ka nisur që aty, duke falënderuar ish nxënësin e kësaj shkolle, sot një model në gazetarinë sportive, Defrim Methasani, për idenë e bukur të tij që të bëjë diçka për atë fole dijeje ku ai mbaroi studimet e shkollës së mesme. Më pas vizitat në klasa dhe laboratorë ia kanë lënë vendin ceremonisë së kësaj veprimtarie, e cila përveç fjalëve dhe dhuratave e mirënjohjeve përkatëse, ka pasur mjaft detaje të tjera.

Me pas kjo ceremoni e bukur ka vijuar edhe me dhurimin e 50 uniformave sportive, 20 topave, rrjetave të volejbollit dhe futbollit, kostumeve sportive për mësuesit e fizkulturës dhe mjaft dhurata e dedikime të tjera.

Selami ka shprehur mirënjohjen e saj, ndërsa kjo është zyrtarizuar edhe për realizuesin e këtij aktiviteti kaq të bukur, ku bashkë me certifikatën falënderuese i kanë dhuruar edhe karakteristikat e katër viteve të shkollës, një gjest ky që e ka emocionuar shumë tashmë jo Defrimin nxënës, por Defrimin gazetar.

Më pas janë nderuar edhe Ilir Shulku e Sulejman Demollari, por edhe miqtë biznesmenë që kanë ndihmuar si zakonisht evente të artit dhe të sportit, konkretisht Muharrem Gjoka, Musa Riçku dhe Faik Bruçi, këto dy të fundit edhe "Qytetar Nderi" në Qarkun dhe Bashkinë e Dibrës. Certifikata mirënjohje ka pasur edhe për dy prej ish nxënësve të shkollës, Shkëlqime Hasani, ish volejbolliste e talentuar dhe Nuri Balla, njëri prej atyre që ndihmoi në bazë materiale.

Më pas kanë vijuar edhe ndeshjet përkatëse, ku janë karakterizuar nga një emocion i rrallë në ndeshjet mes ekipeve të shkollës "Nazmi



Rushiti". Në mbyllje sërish është realizuar një tjetër ceremoni emocionuese, por tashmë ajo e dorëzimit të trofeve dhe medaljeve përkatëse për nxënësit fitues, që në fakt të dukej se fitues ishin të gjithë....

Protagonistët e ditës, Shulku, Demollari, Toska, Cibaku, por edhe të tjerë, kanë dorëzuar kupat dhe medaljet përkatëse, ndërsa më shumë se një kujtim, ata djem dhe vajza morën me vete një mesazh të madh në ëndrrën e tyre për t'u bërë dikush në të ardhmen.

Methasani dhe protagonistët e mëdhenj të një dite festive treguan përmes pyetje – përgjigjeve për nxënësit, por dhe përmes këtij aktivitet tejet domethënës se rinia e sotme ka shumë nevojë për





Kjo festë e bukur ka mbetur në kujtesën e atyre djemve dhe vajzave, por edhe në arkivën e asaj shkolle, ashtu si notat dhe ajo karakteristika e mirë e Defrimit, që si duket, e motivoi atë të rikthehej aty ku e nisi dhe pasi e ka mbyllur me sukses, tashmë t'i jap një tjetër energji për të bërë një tjetër stacion të rëndësishëm në jetën e tij...

ditë të tilla dhe detaje që bëjnë diferencën në shoqërinë e sotme, për të shërbyer këtij brezi si energji dhe guxim që ata vetë nesër të bëhen të tillë. Mbi të gjitha gjesti që Defrimi bëri në ish shkollën e tij, tregoi se secili nga ne duhet të kthejë kokën pas për të bërë gjëra të vogla por me dashuri të madhe, siç ka thënë edhe nënë Tereza.

Kjo festë e bukur ka mbetur në kujtesën e atyre djemve dhe vajzave, por edhe në arkivën e asaj shkolle, ashtu si notat dhe ajo karakteristika e mirë e Defrimit, që si duket, e motivoi atë të rikthehej aty ku e nisi dhe pasi e ka mbyllur me sukses, tashmë t'i jap një tjetër energji për të bërë një tjetër stacion të rëndësishëm në jetën e tij dhe atyre që do të kenë fatin të prekin një ditë një ëndërr të tillë të bukur...

B.Karoshi



cyan magenta yelloë black

Rruga e Arbërit nr. 171

Dibra, "Itaka" poetike e gazetarit dhe shkrimtarit Shaqir Skarra

profil

Pesëdhjetë vjet me penë, me pasion dhe përkushtim të epërm…

Nga **DUKAGJIN HATA**

Për rreth pesëdhjetë vjet ka ndjekur rrugëtimin e të tjerëve, ëndrrat, kauzat, përballjet e tyre, duke i hedhur ato në letër si kujtesë për kohët dhe brezat. Vëzhgime, mbresa, emocione njerëzore kanë gëluar në penën e tij, duke marrë trajta reportazhesh, portretesh, analizash e reflektimesh rreth të ndodhurave. Një realitet i mbetur përgjithmonë në letër, në shkrime interesante, ku dallohen qartë përvijimet e të ndodhurave nga më të çuditshmet, konturet e një përditshmërie të ngarkuar me zhurmënajë e sherrnajë epokale, gjurmët e kohës dhe të bashkëkohësve.

Tani është radha e tij, të hedhim diçka në letër për këtë njeri pasionant të shkrimit, të publicistikës dhe letrave në përgjithësi, që me modesti shembullore e përkushtim jo më pak shembullor na sjell realitete të prekshme të përditshmërisë dhe historisë.

Quhet Shaqir Skarra, një penë e njohur jo vetëm për lexuesit e gazetës "Rruga e Arbërit", jo vetëm në qarqet krijuese dibrane, por dhe më gjerë. Një jetë e tërë në ndjekje të personaliteteve njerëzore, të atyre modeleve jetësore që na ofrojnë një qasje drejt një jete më të motivuar, më të kuptimtë dhe më kurajoze. Janë qindra portrete njerëzish të thjeshtë e intelektualësh të fushave e profileve të ndryshme, bujq, blegtorë, specialistë të dalluar, njerëz me pasione të mëdha, problematika e qasje nga më të larmishmet, ku më shumë se me penën pasionante, duket se këto histori janë shkruar me lëkurën e tij.

Ishin vitet '70-80 të shekullit të kaluar, kur shoqëria shqiptare, e zhytur në depresionin kolektiv të vetmisë dhe iluzioneve të humbura, kërkonte shtigje sado të vogla për te liria. Një minishteg, që na qasej si një ishull vezullues, gjithë dritëhije dhe farfuritje, ishte dhe libri, një thesar që na joshte me një fuqi të papërballueshme. Shkoja në shtëpinë e Shaqirit, në Shumbat, kur ai kthehej nga 'kurbeti" brenda vendit dhe merrja ndonjë libër, pasi ai kishte një bibliotekë të pasur, të cilën e furnizonte kohë pas kohe me libra të rinj. Pasioni i Shaqirit për librin ishte një histori e përfolur në atë fshat ku vëmendjes kolektive nuk i shpëtonte asgjë e ku nga shumica konsiderohej një "bjerrje kohe", nga pakica, ku mendoj se bëja pjesë dhe unë, si një shenjë sqime intelektuale dhe vlerësimi për shijet, kulturën dhe botën shpirtërore në përgjithësi. Shtëpia e tij në fshat qe kthyer në një sallë biblioteke për intelektualët e fshatit.

Mbaj mend shkrimet e tij të herëpashershme në gazetën "Ushtima e maleve" dhe organe të ndryshme të shtypit qendror, shkrime të shkruara me stil të veçantë dhe sharm gjuhësor. Nxirrte në pah njerëzit e thjeshtë, botën e tyre shpirtërore, dashurinë për punën, idealitetin e kërkimit të vlerave më të qenësishme njerëzore, që të çojnë drejt të vështruarit të gjërave përtej hundës tënde dhe interesit të ngushtë vetjak. Ishte bashkëpunëtor aktiv dhe pasionant i gazetës "Puna", "Bashkimi", "Zëri i rinisë", revistës "Ylli", "Hosteni si dhe I të gjitha gazetave lokale në rrethet ku i rastisi të punonte në ndërmarrjen "Rruga Ura".


Kjo veprimtari e ngjeshur shkrimore nuk mund të mos tërhiqte vëmendjen e lexuesit dhe të qarqeve vlerësuese të kohës, që vëzhgonin imtësisht gjithçka dhe në rastin e tij shikonin një gazetar të pjekur, që dinte se çfarë shkruante dhe shkruante me një stil që ishte krejt i tij. Në vitin 1986, mori çmim të parë për shkrimin "Udhët e atdheut na thërrasin", i cili u vlerësua si reportazhi më i mirë dhe u transmetua në "Radio Tirana" për emisionin "Shqiptarët jashtë atdheut" plot një javë rrjesht. Gjithashtu është dekoruar nga Presidiumi i Kuvendit të Shqipërisë me Medaljen e Punës si dhe Medaljen "Naim Frashëri".

Shumbati ishte dhe mbeti "Itaka" e tij, kopështi i Edenit, vendlindja e paharruar, të



Shumbati ishte dhe mbeti "Itaka" e tij, kopështi i Edenit, vendlindja e paharruar, të cilën e mbarti dhe e mbart si një Gur Sizifian, kudo që shkon, në çdo cep të dheut shqiptar. Këtij fshati me histori të veçantë dhe sharm të epërm etnopsikik i ka kushtuar qindra shkrime, reportazhe, mbresa, histori të ndodhura e gojëdhëna të përcjella ndër shekuj, gojë më gojë e brez pas brezi.

cilën e mbarti dhe e mbart si një Gur Sizifian, kudo që shkon, në çdo cep të dheut shqiptar. Këtij fshati me histori të veçantë dhe sharm të epërm etnopsikik i ka kushtuar qindra shkrime, reportazhe, mbresa, histori të ndodhura e gojëdhëna të përcjella ndër shekuj, gojë më gojë e brez pas brezi. Dy librat e tij të mrekullueshëm për Shumbatin, me një material të pasur faktik dhe analizë të imët të



Disa nga librat e autorit

gjithçkaje që e karakterizon këtë fshat, janë pjesë e një trashëgimie vlerash njohje dhe reflektimi, jo vetëm për shumbatasit, kudo që ndodhen, brenda e jashtë kufijve tanë administrativë, por dhe më gjerë.

Gjinia më e lëvruar nga Shaqiri është reportazhi, por jo më pak të preferuara kanë qenë dhe janë portretet, skicat, vëzhgimet e tij të imëta për dukuri të historisë dhe përditshmërisë.

Hapja e shoqërisë shqiptare, pas viteve '90, me gjithë devijimet e këtij tranzicioni të vështirë, i dha mundësi të reja penës së Shaqirit, publicistikës dhe letërsisë së shkruar prej tij.

"Rruga e Arbërit", gazeta më serioze e hapësirave mbarëdibrane ishte dhe vazhdon që të mbetet një nga prioritetet e tij, të cilën me një grup bashkëpunëtorësh e nisën nga hiçi dhe e çuan në majat e informimit, ku vazhdon të kontribuojë me zërin e saj origjinal.

Rrjedhat e reja të një kohe tjetër i dhanë impulse të reja Shaqirit, i cili duke qëndruar gjithmonë mes njerëzve, mes halleve dhe gëzimeve të tyre të përditshme, mori shtysa dhe motivime të forta për vazhdimin ende më me pasion dhe përkushtim të rrugës së shkrimtarisë.

Konturet e tjera, të një shoqërie më agresive dhe më pak të ndjeshme ndaj dhimbjes së tjetrit, etja e shfrenuar për para, që zëvendësoi kursin normal të konkurrencës së vlerave, nën stigmën e meritokracisë, nuk e dëshpëruan Shaqirin, i cili vazhdoi si dhe më parë të qëmtonte ngjarje dhe dukuri, të ndiqte rrugë dhe projeksione ëndrrash e realitetesh të thyera, të nxirrte në pah personazhe, që mbartnin vlera dhe që ai i përcillte si modele që duheshin ndjekur nga të gjithë.

Vazhdoi të shkruajë me të njëjtin ritëm, me përkujdesje e pasion, në zhanre të ndryshme publicistike e letrare, duke dhënë një kontribut të çmuar dhe lehtësisht të verifikueshëm në faqet e gazetës "Rruga e Arbërit", që me kohë do të bëhej tribunë e mendimit dibran, mjaft e kërkuar nga intelektualë të fushave e profileve të ndryshme, por dhe nga njerëzit e thjeshtë.

Një nga një morën rrugë librat e tij: monografi letrare e publicitike, copëza tradite dhe historie, gjurmë të etnosit dhe pasurive të tjera të thellësive kolektive dibrane, fshatra e krahina në fokus, figura historike e të përditshmërisë.

Deri më tani ka shkruajtur dhe botuar 17 libra, ku vlen të veçojmë librin e tij të parë "Zalldardha", për të vijuar më tej me titujt "Shumbati histori dhe tradita","Shtator i përgjakur","Dine Hoxha, arkitekti i fjalës së mençur dibrane","Haki Hysa","Malet e Dibrës","Gurrat e Korabit","Gjorica, fshati midis ujërave","Trokitje në portat e Dibrës","Klerikët e Limnjanjit","Xhafer Merdini, një emër i njohur në sofrën e arsimit shqiptar","Musai, portreti i njeriut fisnik", "Dritëhijet e një poeti", monografi kushtuar poetit të njohur dibran Naim Plaku, "Borxhin ta ktheva vendlindje", monografi e zgjeruar për Shumbatin. Në këtë monografi, më tepër ndoshta se kurrë më parë, spikat pena e tij zhbiruese, pasioni kërkimtar për të na dhënë një histori të plotë dhe impresionuese të një fshati me gjurmë të thella në histori, me kontribute në veçanta në kohëhapësirën dibrane dhe më gjerë.

Shaqiri ka në dorëshkrim, në proces redaktimi e botimi librat "Lirikat e mia", -poezi, "Vdekja e engjëllit"-tregime, "Trokitje në portat e Dibrës" vëllimi II, "Malet e Dibrës", vëllimi II, "Sofra e legjendave"-legjenda, "Loti i dhimbjes dhe dashurisë", kujtime.

Në trevën e Dibrës, odave dibrane, kafeneve dhe ndenjeve me burra të mençur, Shaqiri ka gjetur "lëndën e parë" të librave të tij, materialin bazë, episodet ardhur gojë më gojë deri në ditët tona, alegoritë, folklorin, fjalët me rrotulla, parabolat, shëmbëlltyrat dhe shumë e shumë njësi të tjera të ligjërimit të kodifikuar, që janë veçori e kësaj treve kaq të pasur në njësi frazeologjike dhe stilema të koduara.

Falë njohjeve të shumta në Dibër dhe në Tiranë, kryesisht mes dibranëve, pena e Shaqirit vazhdon të rrëshqasë lirshëm mbi letër, duke shkruar me frymëzim e pasion shkrime që sjellin aromën e jetës dibrane, kultin e punës dhe djersës, thellësinë e fjalës së gjetur në oda e ndenje burrash të fjalës e besës, të traditës e zakonit, të diturisë dhe përgjegjësisë për gjithçka që thonë dhe bëjnë në jetën e tyre.

Në këtë krijimtari të gjerë e të begatë spikat një talent përtej të zakonshmes, një talent që kërkon në histori dhe në përditshmëri, për të gjetur ato fije lidhëse midis kohëve dhe epokave, midis brezave dhe entive, që të mund të përcjell mesazhe të freskëta e kuptimplote për çdo brez e për çdo kohë.

Në këto krijime duket një dora e një krijuesi të përkushtuar, që jetën dhe pasionin e tij e ka të lidhur me letrat, ku me një stil të thjeshtë, komunikues dhe të rrokshëm për të gjitha nivelet kulturologjike të lexuesit, për të gjitha moshat; sjell një lëndë shkrimore të përpunuar hollë dhe me shije, pa lajle lule të kota, pa retorikë dhe proliksitet.

Publicisti dhe shkrimtari Shaqir Skarra është një kërkues realist në psikologjinë dhe shpirtin dibran, ku me një stil të ngjeshur e konciz, por njëherësh të ngrohtë e plot ngjyra, ngërthen rrëfimin dhe depërtimin psikologjik e psikoanalitik, me një gjuhë të zhdërvjellët dhe elegante, duke na sjellë në shkrimet dhe librat e tij më shumë se një shqetësim për fatin historik të një treve sharmante, të një populli qëndrestar, siç është populli dibranë.

Ajo që e bën të dallueshme krijimtarinë e Shaqirit është rrugëtimi i tij i natyrshëm drejt personazheve, drejt ngjarjeve, drejt vetvetes autentike, vetvetes poetike, duke konfiguruar një peizazh të thyer të shpirtit njerëzor, me anë të tablove në lëvizje, si vetë jeta jonë dinamike, në kërkim të gjërave të bukura, për të cilat ia vlen të jetosh.

Krijimtaria e Shaqirit dallohet për stilin e ngjeshur, poetikën e rrëfimit, fuqinë e përshkrimit dhe gjallërinë e mjediseve të përshkruara.

Pesëdhjetë vjet me penë nuk janë pak, por një jetë e tërë dhe udhëtimi në shkrimtarinë e Shaqir Skarrës është një udhëtim mbresëlënës, ku gjallëria e narracionit, përzgjedhja e fjalës, pasuria e stilit dhe thellësia e depërtimit në analet e të ndodhurës, mbetet një shpalim konstant, pavarësisht kurbave herë -herë marramendëse ku ngrihet "lavjerësi" i tij narrativ dhe estetik.

Në artin e tij shkrimor, ngërthehen kohë dhe stinë, protagonistë dhe histori, situata intime dhe universale, gjendje dhe fakte jetësore, të transfiguruara në akte estetike, ikje dhe kthime, modele jete dhe ëndrre, kërkimi në shpirtin universal të së bukurës, të urtësisë dhe mençurisë njerëzore.

etnokulturë

Martesa si një ngjarje madhore në jetën e njeriu, përbën një akt demonstrues përbashkimi mes dy njerëzve, konvencionalisht dhe tradicionalisht mes një djali dhe një vajze.

Dasma si një hapësirë publike

Nga **ALBAN TUFA**



Dasmë dibrane (fragment) - Pikturë nga Zaim Elezi.

Martesa si një ngjarje madhore nëjetën e njeriu, përbën një akt demonstrues përbashkimi mes dy njerëzve, konvencionalisht dhe tradicionalisht mes një djali dhe një vajze. Ky demonstrim rreh të jetë sa privat, intim, i përmbrendëshm, aq edhe publik, i jashtëm, dhe për të tjerët. Kjo antinomi që përmbush të tërën e martesës vjen nga dasma. Në vete dasma, sidomos ajo dibrane, përbëhet nga disa dimensione. Le ti trajtojmë shkurt secilin prej tyre.

DIMENSIONI TRADICIONAL

Me dimension tradicional mund t'i referohemi dasmës si akt i veçuar nga martesa. Teksa martesa është akti, forma apo teknika e përbashkimit, dasma është gëzimi, përmbajtja që rrjedh nga ky bashkim (i realizuar ose i pritshëm). Gëzimi qyshkur demonstrohej me festë me këngë, hare dhe muzikë. Rrjedhimisht, festa nëpërmjet një rituali të praktikuar që në kohët pagane. Në këtëkuptim, me aspekt tradicional do t'i referohemi ritualit që kryhet lokalisht, në popullin shqiptar, provincialisht në zonë e Dibrës.

Fillimisht dasma është traditë. Dhe e si e tillë na është përcjellënëpërmjet letërsisë, filmit, duke qenë objekt i tyre. Nga ana tjetër ajo është trajtuar antropologjikisht, semiologjikisht, entografikisht, etj. Duke dashur t'ju shmangemi përsëritjeve, do të analizojmë shkurtimisht elementët pikant që i japin dasmës një ceremonial të vë çantë nga gëzimet e tjera.

Muzika dhe kënga, janë elementi i parë mbizotërues tradicional në njëdasmë, botërisht. Kënga është shënjues i festës dhe i lumturisë. Pra njeriu nuk kërcen dhe as nuk këndon gjithmonë, por veçatëherë kur është i lumtur, atëherë kur ka një gëzim në shpirt. Kësisoj, dasma është së pari gëzim. Kulmi i gëzimit dhe haresëështë çasti kur nusja vjen në shpinë e saj të re. Ajo pritet të sjellë ndryshim në shpinë e burrit. Ky gëzim do jetë rezultat i elementëve që do përmenden më tej.

Kur nusja zbret nga kali (BMV-ja) i laget rruga me raki. Në shtëpitë dibrane rakia përveçse pihet, ajo përdoret edhe për të dezinfektuar vendin, për të larë xhamat dhe për të bërë një sërë punësh të tjera që lidhen me pastërtinë. Pra, rakia lidhet kuptimisht me pastërtinë. Nusja që po vjen pritet që të mbajtur pastërti, të ndihmojë në punët e shtëpisë, ta mbajtur atë pastër. Edhe pse një gëzim me prirje materiale, mbetet gjithsesi gëzim.

Pasi nusja i është afruar derës së shtëpisë, nënjë ceremonial të përpiktë e pret vjehrra e saj me një kupë **mjalti n**ë **dor**ë. Nusja përballë spektatorëve-dasmorë ngjyen gishta me mjaltë dhe lyen portën. Në disa raste varësisht nënkulturave,nusja dhe dhëndri i japin njëri-tjetrit mjaltë. Dy elementë befasues në këtë skenë janë vjehrra dhe mjalti. Gjithë aspektin mitologjik të përballjes mes nuses dhe vjehrrës, një marrëdhënie e paramenduar për tëqenë negative, kjo e fundit mundohet ta zbusë me mjaltë. Sigurisht simbolikisht. Pra, me anë të mjaltit, nusja me gjasë pritet të sjellëëmbëlsinë në familje, ose edhe ta gjejë aty.

Pasi kapërcyem disa pasazhe të ditës së dasmës, vjen darka, dhe çifti mbyllet në dhomë. Tradita e lyp që në dhomën e çiftit mbi krevat të gjendet shtrirë një djalë, mundësisht i vogël, mundësisht sa mëfoshnje. Detyra dihet, nusja duhet të lind, dëshirueshëm nga të gjithë, një djalë. Sa e arritshme është kjo, është shumë e diskutueshme. Gjithsesi gëzimi që sjell ardhja e nuses lidhet edhe me përçimin e trashëgimisë me anë të një djali që ajo duhetta *sjell*ënë atë shtëpi.

Para se dhëndri të kryej detyrën finale, duhet të bëjë edhe aktin e fundit. Ai me njëqetësi të admirueshme duhet të kap macen e cila kasten i është futur në dhomë dhe t'ia këpusë asaj kokën mu përpara nuses. Mundësisht ajo ta këqyrë mirë aktin. Macja si përfaqësuese e dy sjelljeve tëpadëshiruara: dinakërisë dhe tradhtisë. Burri me kokën e këputur në dorë i dëften tash nuses fatin dhe përfundimin e saj nëse tenton ta tradhtoj atë (burrin). Kjo përfundon me fjalën "dikur"

DIMENSIONI RELIGJIOZ

Martesa si akt është thellësisht religjioz. Të gjitha fetë monoteiste, e paraqesin atë si një ndër detyrimet kryesore të njeriut. Në Islam, jetesa më një femër pa *nikah*, konsiderohet *zina*. Për ve ç procedurave ligjore, çifti në Islam duke të marrëfillimishtpëlqimin e njëri-tjetrit. Në këtë kuptim, martesa edhe pse është detyrim, personi që përzgjedh për tëjetuar, bëhet me vullnet të lirë. Që martesa të jetë e mbarë, lipset pëlqimi i prindërve nga të dyja palët. Dhe së fundmi lipset me detyrim deklarimi. Pra, shpallja te të tjerët (të afërm ose jo) që filani dhe filania janë tashmë të martuar (ose fejuar). Kjo traditë fetare, është gërshetuar më atë dibrane dhe nëse tenton ta ndash,është thuajse e pamundur.

Veç aspektit të martesës si akt shpalljeje dhe deklarimi, roli i saj dytësor është riprodhimi. Riprodhimi si akt biologjik, me qëllim shtimin e racës njerëzorë, dhe po ashtu përhapja e fesë, e llojit tënjëjtë, përplotësimi i fizikës, e më tej i krejt dimensionit shpirtëror të njeriut. Nëvazhdën e riprodhimit dhe të tejçimit të brezat, si mesazhin hyjnorashtu edhe identitetin personal, grupor apo kombëtar, martesa dhe gjithëçka buron prej saj, shërben edhe si dëshmi, para botës dhe Zotit, për të përmbushur vullnetin dhe detyrimin social.

DIMENSIONI SOCIAL

Që në nisjen e historisë sënjerizimit, njeriu u shoqërua nga një i dytë. Në tekstet hyjnore, Zoti i solli Adamit/Ademit, Evën ose Havanë, madje ajo doli nga brinja e tij. Letërsia na ka dhënë plot shembuj (RobinsonKruzo) ku njeriu edhe mund të jetojë i vetëm. Por ketë jetë në vetmi ai e kalon duke menduar dhe shpresuar që të takojë njerëz të tjerë. Edhe te "Rrëfim i njëanije humburi" të Gabriel Garcia Marquezit, personazhi (i vetëm) ia del të jetoj në një varkë (trap) në mes të detit, por gjithë me shpresën të dalë në breg dhe të takojë njerëz.

Në shkencat e komunikimit aksioma e parë mbi njeriun është: njeriu nuk mund të komunikojë. Edhe vendoset në një ambient pa njerëz, pa folur, çdo pozicion që ai merr, komunikon, në të kundër komunikon me veten. Por e bën gjithsesi. Pra njeriu ka nevojë për njeri, madje tëngjashëm, ose më të bukur se ai. Njeriu ka nevojë të lidhë marrëdhënie sociale, për t'i rinovuar ato, për të krijuar grupime, për të njohur njerëz të rinj. Për të arritur gjithë sa thamë shërben më së miri, dasma (martesa), si akt ose si proces i gjithnjëshëm.

Dasma shtron një shtrat për të lidhur marrëdhënie të reja. Pas çiftit lindin njohje farefisnore të shumta, duke krijuar kështu një rrjet njohjesh në nivele dhe në angazhime të ndryshme brenda një grupimi shoqëror.

Dasma është një akt publik, madje pastërtisht publik. Publikja e dasmave mund të shpjegohet shumë thjeshtë: në fshat dikush hap dasmën, bashke më të hap ahengun (madje me të madhe), fjalën e ka hapur muaj më parë, kështu hap derën e madhe, hap edhe konak te një komshi, dhe praktikisht hapësira tashmëështë krejtësisht e hapur. Në aheng mund të shkojë kushdo, pa përjashtim. Edhe në konak mund të shkojë kushdo, pa përjashtim, madje me të drejtë të plotë fjale, por me kompetencë, duhet me i dalë zot asaj çka thotë. Gjatë bisedave komentohen çështje të ndryshme, duke nisur nga shqetësimet e fshatit, e duke mbaruar të çështjet politike. Nga ana tjetër, nëdasmë shpallet statusi social i familjeve tëdhëndrit dhe nuses, i dajave dhe xhaxhallarëve, shkurt i të gjithëatyre që janë të ftuar.

DASMA SI KONVENCION

Dasma mbi të gjitha është marrëveshje sociale. Që në nisje është marrëveshje mes dy personave që martohen. Mandej është marrëveshje mes familjeve që po e bëjnëdasmën. Fakti që caktohet një datë, orë dhe vend, bëhet vetëm për qëllim marrëveshjeje. Ka nga ata që e bëjnë se kanë bërë të tjerët, për t'u kthyer "reston", ose qokën. Kjo është marrëveshje. Ka nga ata që e bëjnë për të shmangur e gjykimet dhe paragjykimet, pra për të themeluar një marrëveshje të re në shoqëri: kjo është nusja e filanit (kujdes). Vetë unaza mbart në njëkontekstsemiotik simbolikën e lidhjes. Forma e saj rrethore, sikur domethënë që po futesh në një rreth. Materiali i saj prej ari, na përball me vlerën dhe shtrenjtësinë e martesës.

Po ashtu edhe djegia e shamisë na përball me një kod të ve çantë dhe shumë interesant. Nëbeqari, d.m.th. në kohët kur komunikimi nuk ishte elektronik, vajzat dhe djemtë mes veti, komunikonin jo me chat, por me kode më të veçanta. Një ndër to ishte edhe shamia. Komunikimi në kushte të tilla, nga kodra në kodër, nga shtëpia në shtëpi, nga avllia në avlli, komunikimi ose ftesa për komunikim bëhet me anë të shamisë, duke e nxjerrë atë në një vend të dukshëm. Ky kodzbërthehej nga të dyja palët, gjë për të cilën kishin rënë dakord (marrë vesh), sigurisht më herët.

MBIVENDOSJET E REJA

Globalizimi e ka për ballë si çdo gjë, ose më shumti martesën me ndryshime të reja dhe thuajse rrënjësore. Që nga mënyra si zhvillohen ngjarjet, si lidhet fejesa, si vazhdon ajo, dhe si zhvillohet dasma, kemi parë ndryshime themeltare.

Sot nuk këndohet më, ose rrallë. Pra nga kënga me dajre apo me def, kemi kaluar në këngët digjitale (HighDefinition) mp3 që burojnë nga playlista në youtube. Në çdo dasmë mbizotërojnë këngët tallava, së fundmi edhe këngë house, apo hip – hop. Gjatë këtyre këngëve dhe kërcimeve zhvillohet një ankand, ose sfidë, kush të hedhë më shumë para, mbi ballin e njeri-tjetrit (demonstrimi i statusit). Këtu njerëzit ekzaltohen, në mos janë dehur, dhe shndërrohen së fundmi në turmë, pa arsye, pa qëllim, dhe më e keqja pa vetëdije.

Vulën gjithë kësaj gjurulldie, ia vë kënga e cila lyp një rend më të strukturuar: vallja e pinguinit. Tash njerëzit vihen në rresht, kapen pas të pasmeve të njëri-tjetrit dhe tunden si dema, para – prapa. Pavarësisht se kjo valle kërcehet njëlloj në Hong-Kong, në Rio De Zhanero, në Peru, apo në Madagaskar, ajo kërcehet vendçe në çdo dasmë në Dibër, ani pse nuk kërcehet një valle, qoftë e vetme, e vetme, dibrane.

Botimi i kësaj gazete është punë vullnetare,
ndaj çdo pajtim vjetor ose dhurim, është i mirëpritur.
Dhurimet pranohen vetëm përmes llogarisë bankare që
gjendet më poshtë dhe për çdo rast ai do të bëhet publik.
Raiffeisen Bank, Rr. Kavajës, Tiranë. Swift code: SGSBALTX.
IBAN(ALL): AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Shqipëria jonë ka plot ujra të mira e të bekuara, vende të cilat e meritojnë emërtesën "Ujëmirë", por Kovashica duhet pagëzohet me emrin "TRIGJURRAT". Ky emër duhet t'i këndohet e t'i kumtohet në vesh, ashtu si fëmijës së posalindur në Ditën e Emrit.

Kujtime për Gani Metën

Nga **BAJRAM XHAFA**

(vijon nga numri i kaluar)

Këtu duhet të ketë ardhur Mjeda kur shkroi poemën "*Andrra e jetës*":

S'ushton mali prej bagtijet,
S'fryn murlani me duhi;
Paq i kthjelltë prej Perëndijet,
Paq prej nierit e qetí.
Gurra e lugut veç ushtonte
Si lahutë me kangë kreshnike;
E ndër pemë bylbyli këndonte
Valle darsmet e fisnike.[1]

Ku ka një të dytë lug të ngjashëm si Lenishtet, dhe ku tjetër përveçëse aty ushton aq am(b)ël gurra e lugut. Këtu duhet të ketë qenë Mjeda. Këtë ta them unë. Ta jap me "be". Nuk ka si të jetë ndryshe.

Edhe Naimi këtu ka qenë. Këtu janë "Brixhet (brigjet) e Tòme", mu sipër vendit ku gurra "thehet" te Lenishtet dhe bën atë shushurimën gjumëndjellëse. Po "bregoret bukuroshe e ju gurrat e kulluara", për të cilat këndon Naimi, a nuk janë këtu? Thuaj atëhere se ai nuk ka qenë tek "Tri Gjurrat" në Kovashicë. "Çuka kodra, brinja gërxha dhe pyje të gjelbëruar!". Të gjitha këtu i ke, të grumbulluara e të ndara, një më një, me inventar; në mëhallën e Tome e n'mëhallë të Epër, te Xhafet e te Tomet e Poshtëm, n'Kodër t'Livadhit e te Farrajcat, te Toçet e te Kullarët (Përroi i Madh), në Shpata t'Toçe e te Pinjollat, tek Arnitë e Pule e te Gjurra e Teme, në Malin e Tem e në Shullâ, te Sharra e Zenele e n'Sharrë të Lurithit. Gjithkund ujë gurrash ngjyrë argjend e krojesh, veshur me bungë buta e me gjelbrim parajse, me shkozë e me krekëza. Kudo të gatshme për çdo llojë peme. Prandaj them se edhe Naimi këtu ka qenë kur shkroi "Bagëti e Bujqësinë". Këtu e shkroi "...Parajsë e vërtetë vetë / Është mëmëdheu në jetë...". A nuk është kështu?

Pastaj rrjedha e gurrës kthen përsëri drejt veriut, futet në një gjiriz të madh si ndonja 30-40 metra të gjatë (një llagëm nëntokësor, vepër arti ndërtuar nga njeriu, nuk dihet se kur, kush dhe pse). Sapo del zhurmshëm nga gjirizi, rrjedha merr përsëri nga lindja për t'u bashkuar me Gjurrën e Zogje në fund të Zajave të Toçe e për t'i grahur teposhtë luginës.

Që nga burimi, nga ana tjetër e Lenishtes, një vijë uji e hapur nga banorët, "Vija e Katundit", nis rrugëtimin poshtë Udhës së Katundit dhe paralel me të. Duke i ardhur okolle Lenishtes nga ana veriore ajo qarkon thuajse krejt fshatin përfundi mëhallës së Epër, mëhallës së Toçe dhe mëhallës së Xhafe duke e përshkuar dhe freskuar atë tej e tej me ujë të ftohtë. Gurra i kishte futur në "danë" Lenishtet - një luginë e vogël në formë govate me ara të ndara në parcela, plus-minus dy dynymëshe me Lenishtet e Tome, Lenishtet e Hasmete dhe Lenishtet e Toçe, të mbjella me misër e më pak me kopshtije, punuar mjeshtërisht. Ajo vijë uji (kanal) përdorej gjatë verës për ujitjen e arave, për larje dhe për të pirë duke përshkuar nga sipër Lenishtet, Zajat e Toçe dhe Ogradnitë e Xhafe. Pjesën tjetër të vitit, uji për të pirë më së shumti mbushej në krye (krajë) të gjurrës, por edhe në rrjedhën e saj të zakonshme, siç bënin Toçet.

Tek Gjurra e Tòme mbushnin ujë gratë e mëhallës së Epërme dhe të mëhallës së Tòme (fisi Tòmja dhe Shtrezi). Këto të fundit mbushin ujë pak më poshtë burimit të saj. Përjashtim bënte Dava e cila mbushte ujë vetëm tek Buçaku i Zi, në krye të gjurrës. Gratë e mëhallës së Xhafe (ku bënin pjesë fisi Xhafa, fisi shumicë, dhe fisi Leka – fis i mbështetun, mbushnin ujë tek ***Gjurra e Zogje***, në skajin verior të fshatit. I ka mbetur kjo emërtesë "apokrife" (vjersha, apo shhkrime me autenticitet të dyshuar) mbase nga që buronte rrëzë Sharrës së Zogje, por që faktikisht në atë vend ku delnin burimet e saj, qoftë si largësi, qoftë si përdorim, apo si pronësi, është në territorin e Kovashicës. Për shkak të largësisë, Zogjet (banorët e saj) nuk mbushin ujë aty. Aty pranë saj ata kanë në pronësi vetëm një mulli bloje ("Mullini i Hamit Jakimit"). Gratë e Zogje mbushnin ujë nga burimi që delte lart, tek Fangu i Zogje.

Për ambicjet e mtimet e Zogjeve ka edhe një gojëdhanë me ngjyrim komik që shpreh lakmitë e tepruara të ndonjerit prej tyre. Një i zogje kishte pretendime se ishin të tijat tokat që vareshin poshtë Manave të Zogje (tek Livadhet) në drejtim të Kovashicës. Si e provon se janë të tuat, e pyeti i kovashicasi. Pretenduesi kishte sajuar një histori të pa qenë për "pronën" e tij, për të cilën thoshte se jam gati të baj be (betim) në Allahun dhe në Kurani Qerim. Kjo qe e papritun, madje befasuese për kovashicasin. Me ba bé me Kuranin në dorë?! Po bane be, të qofshin i tha kovashicasi në ngutje e sipër. Caktuan ditën dhe vendin ku do të bahej pleqnia.

I zogjesi mbushi opingat me dheun nga oborri i tij, (opinga lope si kupa), i shtërngoj fort ato me gjalma dhe u paraqit në vendin e caktuar. Me Kuranin në dorë dhe "sigurinë" në mendjen e tij filloi bénë (betimin): "Për Këtë (Kuranin) e të Perenisë unë eci mbi dheun tim"!, thoshte gjithë siguri dhe ecte me hapa të shtrirë i zogjesi. Si bani ndonja 20-30 hapa, i kovashicasi filloi të tronditet nga humbja e pamerituar. Ndërsa i zogjesi nuk po ndalej në vrullin e tij, kovashicasin e kapi alarmi. Pash Allahun ndalu e mos vazhdo ma përtej se je tuj më qit fare prej katundit. Ndoshta kështu mund të jetë edhe historia e emërtesës së Gjurrës së Zogje.

Kur ra sistemi kolektiv dhe kooperativat bujqësore u prishën, na doli edhe çështja e "pronësisë" së Gjurrës, por zhvillimet e shpejta të emigracionit e fshinë edhe atë punën e gjurrës. Ajo vazhdon të mbajë emrin "Gjurra e Zogje". Ndonjë fanatik emrash e emërtesash mund të "ngushëllohet" me forcën e ligjit të gravitacionit: shyqyr që uji nuk ecën përpjetë se emri i saj nuk prish punë. Janë emërtesat me burim sllav të fshatrave të Dibrës dhe të gjithë Shqipërisë (toponimet-emërvendet) që prishin punë dhe për të cilat duhet të shqetësohen banorët autoktonë të Dibrës dhe gjithë Shqipërisë. Ato me të vërtetë sabotojnë palcën kombëtare shqiptare për të cilën shqiptarët nuk e çajnë kokën. Sepse u zë frymën, u mbulon sytë dhe u shtupon veshët psikoza e integrimit evropian.

Fshati ka edhe një gurrë të tretë, ***Gjurra e Te(j)me***, në skajin jugor të tij, përtej Qafës së Kovashicës, gurrë që buron në këmbën e faqes jugore të Sharrës së Kovashicës, burimet e së cilës, thotë gjeologu Bashkim Lleshi kanë lidhje me Tre Çezmat në Sofraçan. Aty marrin ujë vetëm dy tre familje të Xhafe (të Gjurrës së Tejme, tani ka mbetur vetëm një) dhe një familje me mbiemrin Leka, Hekurani, së cilës vija e ujit i vjen tek dera e shtëpisë dhe shërben për të vënë në lëvizje mullirin, ("***Mullini i Ali Lekës***") që ndodhet prapa shtëpisë, ngritur mbi ca mure të vjetra e të ulta siç kanë ardhur nga koha e Turqisë.

Tri Gjurrat e Kovashicës janë pothuajse në vijë të drejtë nga jugu drejt veriut dhe pothuajse në një nivel hipsometrik. Ato janë një dhuratë jo e zakonshme Zotit të Madh e Fuqiplotë dhe zor se do të ketë një të dytë të ngjashëm në gjithë rruzullin e kësaj toke. Më e drejtë është të thuhet, janë një bekim i Allahur.

Në kohën e Austro-Hungarisë (1916-1918) u ndërmor nisma për ndryshimin e emrave të fshatrave, qyteteve e vendeve me emërtesa sllave në shqiptare. Edhe Kovashica, një toponim me burim sllav u zevendësua me emërtesën shqip "Ujëmirë" a "Gurramirë". Por pushtimi austriak qe i shkurtër, vetëm 3 vjet, prandaj nuk pati kohën e mjaftueshme të ngjizej emri i ri.

Për ndryshimin e toponimeve me origjinë në huaj me seriozitet të madh iu vu punës Ahmet Zogu. Në mars 1923, në postin e ministrit të Brendshëm, me anën e një qarkoreje udhëzonte prefekturat të ngrinin komisione për të zevendësuar emrat e fshatrave nga gjuhë e huaj në shqip, sepse, ministria e quante atë vepër patriotike e politike, që do t'i shërbente rritjes së ndjenjës kombëtare.Komisione e nënkomisione nëpër prefektura punuan për një kohë të gjatë dhe përgatitën listat e emrave të shqiptarizuar. Por kjo punë u ndërpre. Më 1928 çështja rifilloi sërish kur u formua një komision i posaçëm.

Pas shumë përpjekjeve, Parlamenti votoi më 22 prill 1937 ligjin që ndryshonte të gjitha emërtesat që kishin origjinë të huaj. Më 6 korrik 1938, Këshilli i Ministrave, pasi ishte studiuar dosja me emërtesat e reja, vendosi miratimin e listës që përmbante ndryshimin e emërtesave me origjinë të huaj[2]. Kovashica mori emrin "**Gurramirë"**.

Ndryshimet nuk patën fatin e mirë të zbatoheshin sepse më 7 prill 1939 ndodhi pushtimi italian i Shqipërisë dhe me një dekret të 9 shtatorit 1939 regjimi i ri e shfuqizoi atë ligj.

Regjimi komunist që e zevendësoi atë fashist ishte regjim sllavokomunist, antikombëtar. Pranë çarat e shkambinjëve të shumtë gëlqerorë përfund Sharrës. Rrjedha e përherëshme e ujit i kishte qëruar e zbardhur gëlqerorët e sharrës tek burimi dhe i kishte bërë ata me të mbetë sytë në ta prej kënaqësisë që të jepte bardhësia dhe mërmërima e tyre.

Në fillimet e "demokracisë", Musli Xhafa, Musliu i Ramazanit, si gjithë të rinjtë e fshatit iu derdhën kurbetit, kush në Greqi e kush në Itali, por edhe më larg. Shumë prej tyre për punë sezonale. Punoja si bari delesh tek një pronar grek në Greqinë Veriore, thotë Musliu. Një ditë aty erdhi një burrë i vjetër shumë, 95 vjeç. Ishte veteran lufte dhe mbahej. Kurioz për të ditur gjithçka, greku i luftës kërkonte muhabet. Mbase donte të dinte greku i luftës dhe i politikës se si po shkojnë punët e Shqipnisë. Kjo kthesë që po bënte Shqipëria do të merrte për mbarë apo do të ecte siç kishin ecur deri më tash, por me valle ndryshe.

Më pyeti nga ç'vend isha. Dhe shpejt bani edhe një pyetje tjetër për të provuar veten. Mos je nga Elbasani, apo nga Librazhdi? Kishte një siguri në të folur. Siç duket kishte parë e luajtur shumë. Jo i them unë, jam nga Dibra. U befasua pak dhe bani sikur nuk e besonte. Kur i bana një përshkrim të shpejtë të katundeve tona, ai u gjallërua fort. Qenke nga vendi i Presidentit, tha, duke më dhënë afinitet. U kuptua se ishte fjala për Haxhi Lleshin, për të cilin tregonte simpati. Po i thashë, e kemi afër katundit tonë.

Siç tregoi më pas, në kohën e Luftës Italo-Greke dhe Italo-Jugosllave kishte kaluar bashkë me reparte të tjera të ushtrisë greke në tërheqje nëpërmjet Maqedonisë duke kaluar nga Dibra e Madhe, Maqellara, Ura e Topojanit, në Zogje, Kovashicë, tek Tre Çezmat e "Zerqanit"; pastaj në zonën e Gollobordës, Librazhd, Korçë, për t'u hedhur përtej në viset e Maqedonisë e Greqisë. E dinte vendin tonë në pëllambë të dorës, thotë Musliu. Duhet të ketë qenë fillimi i prillit 1941 kur forcat dibrane të prira nga Haxhi e Aqif Lleshi i zbrapsën forcat italiane deri në afërsi të Zerqanit. Mbase edhe për t'iu hapur një rrugë-kalimi forcave greke në tërheqje pas sulmit të ushtrisë gjermane kundër Greqisë dhe Jugosllavisë. Shkonte me planet e Britanisë së madhe për të përgatitur aleancën e ardhshme "antifashiste" Ballkanike greko-jugosllave, pjesë e së cilës do të ishte edhe inkorporimi i Lëvizjes Çlirimtare "Antifashiste" Shqiptare.

Ky që shihni këtu, vazhdoi greku i "lashtë", asht nga nji vend ku unë nuk kam pa me sytë e mi një mal ma të madh e ma të naltë. Ndihma që u erdhi në luftë kundër një armiku të përbashkët, siç kishin qenë ushtria italiane e gjermane, ia kishin ba grekut vendin ma të amël. Edhe mali i ishte dukur ma i madh e ma i plotë, siç ishin Mali i Tem dhe Mali kreshtëmurrmë i Bllacës. Por përshtypjen më të madhe veteranit grek i kishte ba vendi ku kishte kalue gjurrën e parë, pastaj gjurrën e dytë dhe pastaj, të tretën. Të trija në një fshat, njena pas tjetrës. Për secilën prej tyne bani nga nji përshkrim që mua vendaliut më la me gojë hapët. Nuk ka dyshim se ishte fjala për Tri Gjurrat e Kovashicës. Ishte një vend i bukur ku ujrat e bollshme gurgullonin në të katër anët, plot me kodra të buta gjithë gjelbërim e kullota të pasura, lugina e qafa të kalueshme që lidhin krahinat me njena tjetrën. Ishte një vend të cilin nuk e kisha ndërrue me asnji tjetër, e mbylli fjalën greku i vemendshëm por edhe lakmitar.

* * *

Intermexo

Hoxha me Davën shkonin një jetë të paqtë. Jetonin në mëhallën e Tòme. Nuk kishin fëmijë. Hyrje daljet i kishin shumë të rralla. Përjashtuar rastet kur ndonjë hallexhi vinte për t'i këndu ndonjë lutje, me l'shu nji hatme për të vdekun, me bâ nji duà apo me shkrue ndonjë nuskë. E shoqja, Dava mbante shtëpinë. E mbante atë pastër, pastër fortë. Kujdesi i saj për pastërtinë shkonte larg, deri në fiksim.

Shëmbëlltyrën e jetës idilike të Hoxhës së Vogël me Davën më bukur dhe më me realizëm e japin vargjet e Mjedës: "Paq i kthjelltë prej Perëndijet, / Paq prej nierit e qetí". Kështu është formatuar ky vend i bekuar qysh herët, sëpaku qysh në fillim të shek. XVI, në kohën e Evlia Çelebiut (1611-1684), kohë kur shqiptarët patën **Rilindjen** e vërtetë të Racës së tyre. Pragu ku nisi njohja "zyrtare" e Zgjimit Kombëtar (Rilindjes), realisht shënon fillimin e rënies, copëtimit dhe shkatërimit të kombit e të popullit shqiptar. Bilancin mund ta bëjë çdokush duke krahasuar shtrirjen në hartë dhe uljen drastike të numrit të popullsië tek shqiptarët, krahasuar me fqinjët, si territore dhe si popullsi.

Na ftoi njëherë për darkë bashkë me kunatën, më tregonte nana ime. Mori shkas nga një lidhje e largët, demek se edhe unë kam njerëz, pres e përcjell, kam hyrje e dalje, si gjithë dynjaja. Ftesën na e bani me gjithë shpirt. Shkuam për darkë të bujmë një natë tek shpija e tyne. Kur na pa tek dera, thashë se fluturoi nga gëzimi. Bamë sevap fort, i thashë kunatës. Njeriu kërkon njerëz, kërkon dashuri. Bujrum, bujrum e mirëse na erdhët, mirëse u ka pru Zoti. U qesh shtëpia. Nuk kishte ku të na vinte. Si me dashtë me na vu në maje të kresë.

Çfarë të shihje, ajo odë të pastër e ai temizllëk ku çdo gja ishte në vendin e vet. Ato shtroje e mbulesa dhe ato enë që shndrrisnin nga pastërtia, ai qibarllëk në të gatueme e ajo amëlsi në të folme. Kur u shtru sofra nuk pushonte tuj na thanë: merrni, merrni, hani se buka nuk ka marre. Nuk e zinte vendi për të na shërbye. Mos u harroftë ajo natë. Ju shkruejtt për atë dynjá!

Kur erdhi koha për me fjetë, na shtroi petkat, dyshekë e jorgana, çarçafët bardh si bora, që, siç thotë Mustafa Kruja për një shprehje që e përdorkan në Krujë, me marrë miza mjaltë në ta.

1 Ndre Mjeda "Juvenilja dhe vjersha të tjera" Sh. Botuese "Dituria", 1999, f. 37.

2 Kastriot Dervishi, "Historia e Shtetit Shqiptar 1912-2005", Sh. B. 55, Tiranë, 2006, f. 397.

vijon numrin e ardhshëm

kujtesë

Shumë pak njerëz e dinë se para një shekulli,në fshatin e Dovolanit u krye një masakër nga pushtuesit serbë, ashtu si në shumë fshatra të tjerë të Dibrës.

Dëshmorët e Dovolanit

Nga **OSMAN XHILI**



Shumë pak njerëz e dinë se para një shekulli,në fshatin e Dovolanit u krye një masakër nga pushtuesit serbë, ashtu si në shumë fshatra të tjerë të Dibrës. Tregimet e më të moshuarve, të ardhura gojë më gojë deri në ditët tona, zbardhin sadopak këtë ngjarje. Pak kohë pas humbjeve të mëdha të serbit në qafën e Kolesjanit, do të vinte një valë e re hakmarrje që nuk do të kursente, asgjë, as shtëpitë, as kafshët, as gratë e fëmijët.Në Dovolan ndoshta ishte dhe një arsye tjetër për të shtuar dozën e hakmarrjes. Në fshat kishin banuar për gjatë kohë, krahas popullsisë muslimane dhe banorë të fesë ortodokse. Ata ishin larguar nuk dihet në çfarë rrethanash. Sot e kësaj dite, disa toka mbi përroin e Dovolanit quhen " Bahçet e kaurit" dhe mund të ketë pemë të vjetra që nga ajo kohë.

Nuk ishte vështirë për një ushtri të armatosur të sulmonte një fshat me diku te 50 shtëpi. Nuk kishte vend për negociata e bisedime. Çdo gjë do bëhej sipas një skenari të menduar mirë që më parë. Në fillim u bastisën shtëpitë, u muar ajo plaçkë që konsiderohej me vlerë, pushkë e para,nëse kishte të tilla. Më vonë shumë shtëpi u dogjën e u shkrumbuan. Pastaj ishte rradha e burrave të fshatit, për ti lidhur e për ti çuar te vendi i ekzekutimit.

Sadulla Pilafi, një nga banorët e fshatit, tregon se dhe gjyshi i tij ishte një nga burrat, që u kapën e u pushkatuan. Gjyshi i tij kishte po këtë emër, Sadulla Pilafi. Thuhet se ka qenë kryeplak i fshatit në ata kohë. Kishte punuar gjatë kohë në Turqi e pati vënë pak mall e pasuri. Në një moment të vetëm ikën të gjitha, malli, pasuria e pak më vonë dhe jeta e tij. La pas një djalë të vogël, Aqifin vetëm dhjetë vjeç e që në atë moment e për shumë vite më vonë, familja Pilafi provoi një varfëri ekstreme.

Agim Isaku, një tjetër banor i këti fshati tregon një episod interesant për gjyshin e tij, që fatmirësisht i shpëtoi ekzekutimit. Ai ishte lidhur njësoj si burrat e tjerë. Në një moment pak para pushkatimit, oficeri serb pyet nëse dikush kishte para apo pushkë dhe i dorëzonte, atij do ti falej jeta. Gjyshi i Agimit, Qazimi, dinte dhe gjuhën e tyre, pasi kishte punuar gjatë kohë në rrjetin hekurudhor të tyre.

-Unë kam, thotë ai dhe jam gati t'jua jap. Oficeri serb mbetet pak kohë në mëdyshje. E sheh nga koka te këmbët dhe e lejon të shkojë, natyrisht jo vetëm. Dy ushtarë serb e shoqërojnë der te shtëpia. Njëri prej tyre qëndron poshtë dhe tjetri ngjitet lart, në katin e dytë, ku ishin fshehur pushka dhe paratë. Qazimi afrohet tek një arkë e madhe druri, që e quanin çekmexhe dhe mbyllej me një çelës. Ushtari afrohet pranë tij me pushkën gati në duar. Në moment Qazimi e qëllon me bërryl në kokë dhe ushtari bie pa ndjenja. Ai vetëkërcen nga dritarja dhe largohet nëpër rrugicat e ngushta, drejt fshatit të vogël të Gradecit. Ushtari që ishte poshte e sheh dhe qëllon nga pas, por pa mundur ta dëmtojë. Qazimi u fsheh në një shpellë që quhet " Guri i qenit", bashkë me familjen. Për gati gjashtë javë fshatarët i dërgonin ushqim fshehurazi, gjoja se bënin një krah shkarpa te kodrina. Serbët e kërkuan, por pa mundur ta gjejnë, derisa u larguan nga fshati. Shtëpia e tyre u dogj që ditën e parë pas kësaj ngjarje, bashkë me shumë shtëpi të tjera të fshatit, duke lënë hijen e një varreze të frikshme.

Shumë pak njerëz e dinë se para një shekulli,në fshatin e Dovolanit u krye një masakër nga pushtuesit serbë, ashtu si në shumë fshatra të tjerë të Dibrës. Tregimet e më të moshuarve, të ardhura gojë më gojë deri në ditët tona, zbardhin sadopak këtë ngjarje.

Bastisja, grabitja e djegja e shtëpive nuk e kënaqnin si duhet oreksin e ushtarëve serbë. Ata donin më shumë, ishin të etur për gjak. Në hyrje të fshatit, aty ku është sot xhamia filluan të grumbullojnë burrat e lidhur. Përpjekjen e parë e kanë bërë me hoxhën e fshatit, Haxhi Hoxha, gjyshin e Sinan Hoxhës. Thuhet se hoxha kishte studiuar në Turqi dhe ishte njeri shumë i ditur. Jo vetëm i ditur, por dhe patriot, duket se hoxha i ka kritikuar veprimet e serbëve, me siguri duke u kujtuar ushtarëve se një ditë do të jepnin llogari para Zotit. Atëherë ushtarët serbë e kanë vrarë hoxhën, bashkë me një fshatar tjetër e më pas kanë vazhduar me të tjerët.

Nga tëdhënat e shumicës së banorëve të fshatit thuhet se janë kapur e lidhur 24 persona. Nuk dihet përse nuk i kanë vrarë aty në qendër. Ndoshta sepse e kanë pasur më të vështirë për ti varrosur, apo ndoshtaca grimca humanizmi kanë mjaftuar për të mos i vrarë në sytë e fëmijëve. Burrat e lidhur dhe ushtarët serbë me pushkët e ngrehura kanë bërë më pak se një kilometër drejt vendit të quajtur Shavare. Aty kolona e vogël u ndal. Burrat e lidhur e kuptuan se vetëm pas pak minutash aty do të ishte varri i tyre. Nuk kishte më shpresë, nuk kishte më gjëra për tu thënë. Burrat kaluan dhe njëherë me sy ato vende rrotull aq të njohura, aq të dashura, përshëndetën majën e Cuculit, hodhën sytë nga kodrat e malet, sikur të linin amanetin e fundit. U dëgjuan breshëritë e para dhe u këputën disa trupa burrash. Të tjera e të tjera breshëri derisa asnjë prej tyre nuk qëndronte më në këmbë. Vendi ku u vranë është një luginë e vogël dhe një rrëke uji u bashkua me rrëkenë e gjakut, duke vazhduar rrugën poshtë për te lumi i Drinit.

Serbët nuk u mjaftuan me aq. Ndoshta ndonjeri prej burrave kishte marrë plagë të lehtë e mund të mbijetonte! I goditën dhe njëherë me bajonetat e armëve, si për ta çuar deri në fund aktin barbar. Atëherë i tërhoqën zvarrë trupat e tyre, në fund të një rrëpire dhe derdhën mbi ta dheun e shkrifët. Ishte vjeshtë dhe gjethet e pemëve të kuqe e të verdha u bashkuan me dheun e ranë sipër trupave të 24 burrave të vrarë.

Por në fakt, nuk ishin vrarë 24, por 23. Njëri prej tyre, Sefulla Qosja, kishte qenë fatlum. Plumbat kishin depërtuar gjithandej, gërvishtur lëkurën e shqyer rrobat, kurse bajoneta e kishte kapur në zgrip. Por gjithsesi, plagë kishte dhe gjaku nuk ndalej. Ai nuk kish bërë oh, as kur bajoneta i kishte prekur gjoksin. Vetëm kur ushtarët serbë u bindën se aty nuk merrte frymë njeri u larguan për aksionin e rradhës. Më vonë kur dy tre nga banorët e fshatit shkuan vjedhurazi për të parë atë që kishte ndodhur, dëgjuan ca rënkime. U afruan dhe pak dhe panë një njeri ku gjaku, dheu e gjethet qenë ngjitur e bërë një. Nuk e njohën, aq shumë ishte transformuar i plagosuri. Vetëm kur ai pëshpëriti emrin e tij, kuptuan se kush ishte. E morën, dhe e strehuan jashtë fshatit, në Popinarë. Mjeku popullor i fisit Turshilla përgatiste melheme e pomada të mrekullueshme, që freskonin e shëronin plagët e shumta, derisa pak nga pak i mori forcat dhe u kthye në botën e të gjallëve.

Ka kaluar një shekull që atëherë dhe gjërat po zbehen nga errozioni i kohës. Mishi i tyre është tretur, por dhe eshtrat e tyre, po ashtu. Dikur kishte një lapidar në nderim të kujtimit të tyre, ku ishin shkruar emrat e tyre. Sot nuk ka asnjë të tillë dhe bashkë me trupat e tyre po treten dhe emrat. Nuk flitet më për to as në familjet, as në shkollë, as në lëndën e historisë, as kur flitet për vendlindjen. Pluhuri i harresës po mbulon gjithçka.

Të paktën, le ta bëjmë një shkrim në kujtim e në respekt të tyre. Të bëjmë një pllakë me emrat e tyre e ta vendosim te vendi ku u vranë e u varrosën dëshmorët e Dovolanit. Një pllakë tjetër mund të vihet në qendër të fshatit, e pse jo një e tretë të vihet te shkolla e cila mendoj të quhet "Dëshmorët e Dovolanit".

KËRKOHET GAZETAR

Kërkohen një gazetar me kohë të pjesshme. Detyra kryesore është të shkruajë dhe raportojë për ngjarje që ndodhin në qarkun e Dibrës.

Të interesuarit duhet të kenë pasion gazetarinë.

Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.

Të interesuarit të komunikojnë me redaksinë.

Tel. **069 20 68 603**
E-mail. **rrugaearberit@gmail.com**

printime dixhitale
me ngjyra dhe bardh e zi
shpejtësi | cilësi | çmime të favorshme
libra | broshura | revista | fletëpalosje
katalogë | kalendarë | postera | ftesa etj.
duke filluar nga 1 kopje e vetme
për informacion: mbbotime@gmail.com / Cel. 069 20 68 603

Rruga e Arbërit nr. 171

shënime

Rreth librit "Shënime në çadër"
të Vesel Hoxhës

Rrëfime nga një profesor i gjeologjisë

Nga **BARDHYL SELIMI***



Ai ka dalë tani në pension, por mua më duket ende ai nxënësi i pjekur i ish Teknikumit të Minierave dhe Gjeologjisë në Prrenjas në vitin 1968, ku unë nisa karrierën time si mësues i matematikës por që i shoqëroja nxënësit bashkë me inxhinier Luanin nëpër marshuta në zonat minerale të Pishkashit, Bushtricës, Katjelit, Gurit të Kuq, Çervenakës etj. Mandej student në Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave ku unë gjithashtu dhashë mësime matematike disa vjet. Pastaj Veselin e takoja më rrallë, për shkak se atë e "rrëmbeu" puna në terren, në ekspedita gjeologjike në zonën e Dibrës. Kur më takonte, ai më tregonte për punën në kërkimet gjeologjike, për martesën, për të atin, për shokët e tjerë. Sigurisht një student dhe inxhinier i talentuar do "përthithej" nga Universiteti Politeknik më vonë, sidomos pas vitit 1990. Aty Veseli u ktheu studentëve përvojën e tij të pasur praktike, i shoqëroi edhe ata në ekspedita dhe ekskursione mësimore nëpër Shqipëri.

Lumturohesha kur i shihja fotot e tij me studentët, që tani ishin shumica vajza, ndryshe nga përpara 1990.

Mësimdhënien ai e vijoi edhe kur nisi punën në Institutin e Gjeoshkencës. Pikë kulmore e karrierës ishte marrja e titullit "Profesor", që më krenoi edhe mua! Lum ai mësues që nxënësi ia kalon!

Një muaj më pare, profesor Veseli më dhuroi librin-ditar "Shënime në çadër", me rreth 560 faqe, që do pasohet nga vëllime të tjera, sikurse më tha.

Një titull i gjetur mjeshtërisht, sepse përmbledh gjithçka shkruhet aty: punën e gjeologut hulumtues, mjedisin shoqëror, natyrën, meditimin për problemet madhore të zhvillimit të vendit etj.

Libri është ndërtuar mbi një material shumë të bollshëm shënimesh në kohë, faktesh të regjistruara në ditarin vetiak, letërsinë historike, politike dhe artistike të shfletuar në vite, padyshim edhe në pasurinë gojore popullore. Kjo pasqyrohet kudo në libër.

Edhe fotot cilësore me ngjyra, të bëra ndër vite, e plotësojnë dhe e sqarojnë tekstin dhe faktet e treguara.

Dua të nënvizoj disa veçori që përmban i tërë rrëfimi në libër.

Së pari, janë tregimet plot dashuri dhe mirënjohje të merituar për kolegët dhe profesorët, si edhe për bashkëpunëtorët e tjerë më të thjeshtë (punëtorë, kuzhinierë, kafsharë, fshatarë mikpritës etj.) Rrëfimet e sinqerta dhe plot ngjyra për ta, na nxisin ti nderojmë më shumë këta "heronj të heshtur" të shkencës sonë.

Së dyti, janë përshkrimet e hollësishme të zonave minerale e minerare të Dibrës e më gjerë, që ngjallin edhe ato, krenari të ligjshme për atdheun tonë. Krahas tyre, lexuesi njihet edhe me fakte historike ku më i madhi është vendlindja e heroit tonë kombëtar, e shtruar si tezë nga historian Kristo Frashëri.

Së treti, të bie në sy qasja e autorit ndaj problemeve zhvillimore që lidhen jo vetëm me industrinë minerare, por edhe me Rrugën e Arbrit dhe ngritjen e hidrocentraleve të vegjël që shfrytëzojnë pasurinë e madhe hidroenergjetike të zonës. Madje, profesor Veseli merr pjesë me argumente të besueshme edhe në debat me një kundërshtar të këtyre hec-eve.Por, si pjesë e inteligjencës inxhinierike, ai ngre, sikurse ka bërë edhe më parë përmes shtypit, edhe çështje të organizimit shkencor në fushën e gjeoshkencës, duke tërhequr vëmendjen e institucioneve vendimmarrëse për këtë qëllim.

Libri në tërësi i shkruar në një shqipe të rrjedhshme dhe në stil të këndshëm, mund të lexohet edhe pjesë - pjesë, pasi është plot rrëfime tërheqëse, jo vetëm nga ata që kanë punuar me Veselin.

DISA FRAGMENTE NGA LIBRI

Destani

Destan Visha, që e takova në fshatin Ceren, ishte me profesion mësues. Kishte një komunikim njerëzor dhe me shumë humor. Ishte tepër kurajoz dhe shumë praktik. Fliste pak. Nuk fliste për gjera që nuk i realizonte. Thoshte të vërtetën, por harronte se, në disa raste, duhej të thoshte atë që donte e mendonte nëna Parti dhe jo atë që, me të drejtë thoshte dhe mendonte kryetar Destani ose disident Destani.

Ndërsa në mendje bluaja problematikën e vajtjes në Bjeshkën e Shehut për të filluar punën, pasi po ikte edhe qershori, më tërhoqën vëmendjen daljet e fuqishme të gjipseve në anën e majtë të rrjedhjes së Përroit të Veleshicës. Një pamje madhështore dhe me mozaikët e panumurt të shkaktuar nga erozioni kimik e fizik i tyre.)f. 28-29)

- Terreni, puna fushore të jep krahë, të jep mundësinë të ballafaqohesh me lloj-lloj dukurish nga më të ndryshmet, në një farë mënyre të teston dijet e të ndihmon t'i shumosh ato hap pas hapi, sidomos kur nuk je vetëm dhe në rastin më të mirë kur shokun e ke më të ditur se vetja- vazhdova bisedën unë (me inxhinier Alaudin Kodrën, sot një ndër profesorët e shquar të gjeologjisë së Shqipërisë e më gjerë) (f. 63)

Ndjeva një gëzim të madh në zemër, pse jo, edhe një vlerësim, që dekani së bashku me një pjesë të profesorëve të mij të fakultetit, po më bënin një "vizitë" tek ekipi ku punoja dhe drejtoja unë. E konsiderova këtë një nder dhe nxitje për punët që më prisnin. Profesor Puma një njeri i qetë dhe autoritar ishte marrë kryesisht me kërkim-zbulimin e mineraleve të hekur-nikelit, kësisoj ishte i interesuar për kërkimet e hekurit në zonën e Korabit. Kryegjeologu Bushi kishte udhëhequr itinerarin e udhëtimit.(f.73)

Një mik nga Bullgaria, që kam pasur fatin ta shoqëroj nga fshati Sllatinë në malin e Korabit e më gjerë, kur i kam shqiptuar emrin e vendit "Sllatinë", me humor më tha: - E dini kuptimin e kësaj fjale? Ndonëse e kisha mësuar nga shkrimtari dhe poeti i talentuar dibran Agron Tufa, atij iu përgjigja se nuk e di dhe pse me të komunikoja në gjuhë sllave.

-Ëmbëlsirë- e ka kuptimin në shqip- u përgjigj kolegu bullgar.(f. 93)

Elektriçisti Isuf Lela

Punonte nga mëngjesi deri pasditen vonë. Punonte shumë e nuk bënte zhurmë, e as nuk e rrihte ndonjëherë gjoksin. Shefave nuk u thosh asnjëherë "jo". Provova një herë të thoja "jo" dhe e di ç'më gjeti, thosh me shaka. Ku nuk e gjeje Isuf Lelën. Nga fshati Ploshtan ku fillonte linja jonë e tensionit të lartë e gjerë tek kabina në majat e Sorokolit (Gurët e Kodrës, etj) me largësi rreth 3.3 km, gjithçka ishte vepër e tij. Po ashtu, nga kabina e ekipit e deri te sondat, galeria apo stacioni i argjilës, gjithçka mbante vulën e Isufit.(f. 105)

Më afrohet aty pranë, zotni Misim Daku, një tjetër punëtor veteran i gjeologjisë, i cili më thotë një fjalë të urtë popullore, duke e lidhur me faktin e kohës së mirë që na mbajti. "Moti ndihmon atë që punon!" Drejt e ke zotni Misim, Zoti ndihmon atë që punon. Misimi për momentin nuk e kuptoi përgjigjen time, pasi fjalën "mot" unë ia zëvëndësova me fjalën "Zot". Për ta mbyllur bisedën unë shtova: - Nuk kanë thënë kot Misim se "trëndafili ka aromën, njeriu ka fjalën e urtë". (f. 124)

Ditët e pushimit kaluan shpejt dhe dita për tu nisur erdhi. Me ato mundësi që kishte nëna më bëri gati. Me bënte gati me dashuri, sa herë që më përcillte, se dashuria e nënës nuk plakët. Nuk kishim shumë rroba në atë kohë, se ishim shumë të varfër falë dhe faktit se ishte verë. (f. 158)

Në odën e Sabriut

Për të më respektuar mua, byrazerin, i ati i Sabriut kishte ftuar për darkë njerëz të afërt të fisit, sikurse është traditë në Dibër. Në bisedë e sipër, i drejtohem njërit prej tyre (plakut nga fisi Hoti të Borie Lurës) me urimin "U bëfsh 100 vjeç!" (për një ngjarje të bukur që na tregoi me një thënie nga filozofia popullore). Thelbi i tregimit ishte se "errësirën e dëbon drita, drita e besimit..dhe urrejtjen e dëbon dashuria..mes vëllezërve, mes fisit, mes fshatit, mes krahinës, mes kombit e më gjerë. Babai i Sabriut, Aliu (rreth 77 vjeç në atë kohë) më tha me shaka "100 vjeç u bëfsh ti, për këtë e di Zoti"! Ai i ka kaluar të njëqindëtat".(f. 163)

Pëllumb Belishova

Në çadër kishim ing. Pëllumb Belishova dhe teknikun Kol Lleshi. Pëllumbi ishte vëllai i Liri Belishovës (ish anëtare e Byrosë Politike të PPSH, e dënuar me burg dhe internim). Ai ishte i kujdesshëm në biseda me të tjerët. Ishte specializuar për petrografi në universitetin Lomonosov në Moskë. Kishte një kulturë profesionale dhe të përgjithshme për t'u patur zili. Prej tij mësuam shumë. (f. 173)

Me profesor Alaudinin në Kosovë

Në fund-shtatorin 2009 bashkë me profesor Alaudinin u nisëm për në Kosovë. Atje na ndihmoi kolegu kosovar Dukagjin Shala. Do hulumtonim brezin kufitar për të rakorduar hartat gjeologjike në shkallë 1:50 000. As në ëndërr nuk e kisha menduar se do bëhej Rruga e Kombit me përmasa të tilla, standarde të larta, njësoj si në vendet e tjera. Në Kosovë përjetova shumë emocione, si nacionalist i pandreqshëm që jam...Frymëzimi është vëllai i punës- ka thënë Sharl Bodler. Dhe puna është çelësi i thesarit me emrin dituri- ka thënë P. Buast. Thuhet se edhe Zoti punën e ka çmim me anë e të cilit ai Ai shet të mirat e Tij.

Kemi përjetuar lumturi tek punonim nga mëngjesi deri në mbrëmjen e vonë bjeshkëve të Sharrit, në Restelicë, në Brod, në Krushevo, në Zli Potok, në Glloboçicë, në Crni Kamen, në Kësulën e Priftit, në Majën e Abdavit, në malin e Sharrit, në malin e Rosnikut, etj., etj., duke ndjerë e materializuar thënien e Leonardo da Vinçit se lumturinë e përjeton ai që punon, të cilës do t'i shtoja se lumturinë e përjeton dyfish ai që punon për llogari të vëllait të tij, i cili sapo ka dalë nga zgjedha shekullore. (f. 189)

Fshati i lindjes

Fshati im i Blliçes ka një pozicion të lakmueshëm dhe strategjik. Ai shtrihet në kurrizoren e kodrës që ndan Fushën e Kastriotit (Fushën e Thatë ose Hasin e Thatë, siç e thërrisnin rëndom të vjetrit e krahinës), me atë të fshatrave Laçes dhe Fushë Alie duke u zgjatur e duke lagur këmbët e gjata në Lumin e Drinit të Zi.

Jo vetëm kaq por, fshati im i lindjes, Blliçja, edhe nga ana gjeologjike (kësaj shkence që i kushtova jetën dhe me të cilën rrita fëmijët e mi të dashur), është e vendosur mbi formacione gjeologjike të sigurta, ku, e thënë në gjuhën popullore, mbi themele të forta (shtresat e tokës ku vendosen shtëpitë e banimit janë të ngjeshura, edhe në gjendjen e tyre natyrale) dhe shtresat e





Dy foto të vendeve ku mendohet të ndërtohet diga në afërsi të Tejdrines apo ajo në afërsi të Skavicës.

ngjeshura nuk janë shumë thellë sipërfaqes së tokës. (f. 215-216)

Pse fshatarët interesoheshin për ne

Aty ku gjeologjia kishte rezultate, mundësitë e zhvillimit ishin më të mëdha dhe garantonin perspektiva punësimi, tërhiqnin vëmendjen e shtetit për infrastrukturën në atë zonë, duke ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e gjendjes ekonomike të popullatës, pasi të ardhurat në kooperativë, sidomos në zonat malore, ishin qesharake. (f. 256)

Ku mund të ndërtohen hidrocentrale të vegjël

Përroi i Mallës së Lurës, përroi i Setës, përroi i Murrës, përroi i Veleshicës, përroi i Pëshkut në Selishtë, përroi i Gramës, përroi i Llixhave, liqeni artificial i Gramës, ujësjellësi i Preshit, Gjura e Hoteshit, Gjura e Kovashicës, Zalli i Bulqizës, Zalli i Okshtunit, rezervuari i Bllacës etj., janë disa nga vendet ku mund të fillojë studimi, projektimi dhe ndërtimi i tyre. (f. 288)

Profesor Selami

.....Asokohe drejtoja ekspeditën gjeologjike të Peshkopisë, por profesori nuk me kishte telefonuar thjesht për pozicionin e detyrës, ndonëse nuk mungonte të shprehej për rastet kur specialist të mirë drejtonin punët (nuk i bihet me shkop kalit kur i ke vënë para gomarin – shpesh i pëlqente ta përdorte këtë shprehje, duke e shoqëruar me një qeshje të lehtë dhe mjaftë karakteristike), atij pothuaj nuk i interesonin fare këto lloje gradash, ai shqetësohej për grada të tjera, për grada që të jepte puna fushore e gjeologut, puna e specializuar, puna shkencore në hartografime, në kërkime e zbulime minerali, në saktësime petrografike, mineralogjike e moshore që qartësojnë stratigrafinë dhe orientojnë punët në gjeologji etj.(f. 293)

Skavica ose Tejdrinja

Këtu unë bie ndesh me shume personalitete që kanë marrë mundimin të shkruajnë për këtë vepër, që në mendjen time nuk bëhet fjalë për një digë, por për disa të tilla. Shkurt, unë nuk mendoj që mbi lumin në fjalë, Drinin e Zi, të ndërtohet vetëm e ashtuquajtura Skavica, vetëm me një digë të madhe dhe me këtë të mbyllet ky problem. Kjo do të ishte vërtet një fatkeqësi e madhe dhe jashtë logjikës rekomanduese të studimeve komplekse, që janë në pajtueshmëri me mjedisin ose i shkaktojnë atij, dëmin më të vogël të mundshëm. (f. 334)

...Njerëzit shkruajnë në shtyp me mendimin e mirë se do të kontribuojnë sadopak në lidhje me problematikën që marrin përsipër të trajtojnë, pa lënduar njeri dhe pa i bërë karshillëk askujt.


Në demokraci njeriu është i lirë të shkruaj pa paragjykime, për një problem që mendon se e njeh sadopak, por, pasi të jetë përpjekur të kuptojë shkrimet e të tjerëve, edhe pse ato mund të bien ndesh me mendimet e tij. Dhe këtu qëndron bukuria.(f. 342-343)

Rreth reformave në instituteve

Kur gjërat bëhen hapur duke respektuar liritë akademike, askush nuk duhet të kundërshtojë. Varësia në Universitetin Politeknik të Tiranës e Institutit të Gjeoshkencave, Energjisë Ujit dhe Mjedisit, ka vërtetuar e po vërteton dita ditës se ky i fundit, nuk i ka mundësitë të financojë punime fushore, në veçanti ato të gjeologjisë në shërbim të thellimit të punimeve shkencore (ndoshta nuk duhet t'i takojë një përgjegjësi e tillë dhe, këtu mendoj se flen lepuri, pra kjo gjë ia vlen të diskutohet thellë dhe me shpejtësi të madhe duhet të korrigjohet), as të financojë ngritjen e laboratorëve më të domosdoshëm, ashtu siç i kanë të tjerët ku duam të integrohemi, qoftë dhe në nivelin e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar ku ishim, në të mirë të hapjes së perspektivës së mineraleve të dobishme të vendit tonë, për të cilat ka nevojë ekonomia jonë, për të cilat ka nevojë populli për t'u punësuar.(f. 355)

Dikush mund t'i kundërshtojë këto që parashtrova por, një rishikim i ecurisë së deritanishme të reformës nga specialistë të përgatitur të stafeve akademike, këtu kam parasysh edhe plejadën e papërsëritshme të profesorëve të Fakultetit të Gjeologjisë dhe të Minierave dhe të ish Institutit të Kërkimeve e Studimeve Gjeologjike, e thënë ndryshe të themeltarëve të gjeologjisë shqiptare, tashmë në pension, që e njohin thellësinë e problemit dhe që shiu i ftohtë i lartësive, jo rrallë herë u ka pikuar në tasin e përsheshëve në çadrën e

Botohet libri “Një jetë maleve, Kujtime 3”
me autor BASHKIM LLESHI



Tregimet janë plot dashuri dhe mirënjohje të meritуar për kolegët dhe profesorët, si edhe për bashkëpunëtorët e tjerë më të thjeshtë (punëtorë, kuzhinierë, kafsharë, fshatarë mikpritës etj.) Rrëfimet e sinqerta dhe plot ngjyra për ta, na nxisin ti nderojmë më shumë këta “heronj të heshtur” të shkencës sonë.

tyre të ngritur mes maleve e pllajave në kërkim të mineraleve të dobishme etj., do të përbënte një garanci e premisë, dhe një ogur të mirë për të ecur në drejtimin e duhur. Punët e mira bëhen me njerëz të ditur që përfundimi të jetë i ndritur. Nëse nuk ndodh kështu do kemi pasoja shumë të kushtueshme për ekonominë e vendit.(f. 360)

Nuk janë të rastit që në shumë vende të trevës së Dibrës gjenden me shumicë emërtime si Kroi i Mbretit etj. Mendoj se kjo lidhet me cilësinë e ujërave, në rastin konkret me ato të formimeve paleozoike të Malit të Sorokolit, të cilat i konkurrojnë nga cilësia edhe burimet ujore që lidhen me shkëmbinjtë karbonatikë, kryesisht ato të pjesës lindore, të Malësisë së Korabit, edhe pse këto formacione janë të metamorfizuara (gëlqerorë të mermerizuar deri në mermere).(f. 375)

Le t’shpresojmë se do të vijë ajo ditë
Kur dhe ne do bëjmë zgjedhje të lira,
Që n’kry të kemi të diturit, të drejtët
Që këtë vend t’nxjerrin nga errësira (f. 392)

11 shtator 2020.

Dy fjalë për autorin prof. Bardhyl Selimi (Mezini)

Ulind në 25.08.1945 në Ferizaj, Kosovë, qytetar i Shqipërisë dhe i Kosovës. Ka mbaruar studimet në Universitetin e Tiranës, 1963-1967, dega Matematikë, me diplomë “shkëlqyeshëm”; Ka shërbyer si mësues matematike, Teknikumi i Minierave dhe Gjeologjisë në Përrenjas 1967-1968; pedagog- në katedrën e filozofisë dhe matematikës, në vitet 1968-1972, dhe i jashtëm 1972-1976; redaktor për shkencën, tek gazeta “Zëri i Popullit” (1973-1975) etj.

Shkruan e flet rrjedhshëm gjuhët Ruse dhe angleze me dëshmi universitare, marrë në vitin 1972 nga Fakulteti i Gjuhëve të huaja, Esperanto me dëshmi nga komisioni provues i ILEI-it (Lidhja Ndërkombëtare e Mësuesve Esperantiste) - Zagreb, me dëshmi , 1996.

Ka botuar disa libra për matematikën zbavitëse, bashkëpunëtor në tekstin e matematikës viti III, gjimnaz, kumtesa për lidhjen matematikë-filozofi, për Esperanton, përkthime në shqip të librit «Fashizmi-Shteti Totalitar” të z. Zheliu Zhelev, të monografisë «Probleme të zgjedhura të linguistikës» të z. Valter Zhelazny, dhe anasjellas, romanet e letërsisë bashkëkohore shqipe (Kadare, Kongoli, Aliçka etj.), artikuj në shtypin vendas dhe të huaj, biseda në Radio e TV, referate shkencore jashtë vendit (Trieste 1998 dhe 2001, Bydgoszcz 1998, 2007, Timishoara dhe Firence 2006, Roterdam 2008, Strasburg 2011), bashkëpunëtor i rregullt i revistës MONATO (Belgjikë) dhe i revistës LA GAZETO (Francë) etj.

Nuk është I angazhuar me parti politike, kryedelegat i Organizatës Botërore të Esperantos (UEA) për Shqipërinë, drejtues i Seksionit Shqiptar të Mësuesve të Esperantos, sekretar i Shoqatës Kombëtare Shqiptare të Esperantos, anëtar i Akademisë Ndërkombëtare të Shkencave, San Marino AIS, anëtar i OSIEK-organizata ndërkombëtare e konferencave shkencore në Esperanto, pedagog i jashtëm i Shkollës së Lartë për Turizëm e Kulturë Ndërkombëtare në Bydgoszcz (Poloni) dhe i Universitetit Privat të Karlovo-s (Bullgari).

BASHKIM LLESHI: Një jetë maleve

Në tetor 2020 Botimet M&B botuan librin “Një jetë maleve - Kujtime 3” me autor Bashkim Lleshi, ku përshkruhen kujtimet e viteve të punës në Institutin e Studimeve dhe Projektimeve të Gjeologjisë dhe Minierave më 1978-1984.

Vitet e punës 1978-1984, në Institutin e Gjeologjisë dhe Minierave ishin vitet e përpjekjeve të mëdha për ta vendosur Institutin në rolin që i takonte, për të udhëhequr në shkallë kombëtare të gjithë punën kërkimore shkencore, studiuese e projektuese në fushën e gjeologjisë, të minierave dhe pasurimit të mineraleve të dobishme.

Në këto vite Instituti kreu detyra të rëndësishme kërkimore shkencore në fushën e gjeologjisë si përpilimin e HGJSH në shkallë 1:200 000, studime të tektonikës, metalogjenisë, studime stratigrafike, studime të rëndësishme të prognozës së mineraleve të dobishme të kromit, bakrit, hekurit pa nikel, mineraleve të çmuar, qymyrgurit, fosforiteve, boksiteve, etj., mbi bazën e rilevimeve komplekse gjeologo-gjeofizike në shkallë 1:25 000, në zonat e pa shkelura, të Alpeve, Korabit, Mirditës, Krasta-Cukalit, Krujës e Jonike nga veriu në jug të Shqipërisë, në bashkëpunim me të gjitha NGJ, N Gjeofizike dhe ING Fier. Janë kryer Studime të metodikës dhe kondicioneve të mineraleve të qymyrgurit, boksiteve, bakrit, kromit etj., studime e projektime në fushën e minierave, hapjen e minierave të reja për shfrytëzimin e mineraleve të dobishme metalore e jo metalore, si dhe dy vitet e para, studime për ngritjen e fabrikave të reja të pasurimit të mineraleve të dobishme.

Me fuqizimin në këtë Institut të Sektorëve teknologjik të pasurimit, kimisë, studimit e projektimit të minierave, brenda 5 viteve të para u ngritën, Instituti i Studimit dhe Projektimit të Teknologjisë Minerale të Pasurimit (ISPTMP), Instituti i Studimit dhe Projektimit të Minierave (ISPM) dhe Instituti i Kimisë (IK), duke u fuqizuar si Institute më vehte, si dhe u fuqizua më tej Instituti i Studimit dhe Projektimit të Gjeologjisë (ISPGJ) me Sektorin Shkencor të Gjeologjisë së Shqipërisë (SSHGJSH), Sektorin e Gjeologjisë së Mineraleve të Dobishme (SGJMD), Sektorin e Shpimit (SSH), Sektorin Analitik (SA), Kabinetin e Dokumentacionit dhe Informacionit (KDI), Administrata (A) dhe Repartet Ndihmëse e Ofiçina (RNO) në ndihmë të këtyre sektorëve.

Në pesë vitet e para u krye një punë e madhe për sistemimin e ambienteve të Institutit, duke filluar nga ndërtimi i godinës së re të Repartit të përpunimit të provave, ndërtimi i Ofiçinës dhe kapanone më vehte për çdo makinë, ndarja dhe shtesat e zyrave në godinën 5 katëshe, ndërtimi i depos së kampionaturës, bibliotekës, repartit të marangozit, sharrës së prerjes së kampioneve, ambiente për strehimin e kuadrove të ardhur nga rrethet që nuk kanë marrë akoma shtëpi, ambiente të riparimit të aparaturave, magazina e re për paisjet fushore të grupeve të gjeologjisë, godina tre katëshe e muzeut, zyrave për grupin e mineraleve të çmuar, petrografët, paleontologët e stratigrafët dhe salla e madhe e konferencave. Të gjitha këto investime janë kryer me minimumin e shpenzimeve me ndihmën e madhe të kolektivit të Institutit, ku secili duhet të jepte kontributin e tij për ambientin e tij të punës. Për t’u krijuar kushte sa më të mira pune kuadrove të ardhura nga rrethet që do të punonin në terren u shtuan përpjekjet me organet e pushtetit për strehimin e tyre brenda kohës 6 muaj deri një vit.

Vitet 1978-1984 ishin vitet e një pune shumë të madhe e të përkushtuar. U plotësuan pothuajse të gjitha kushtet e punës, u forcua disiplina në punë me plane e programe pune të çdo individi, grupi, sektori e në shkallë Instituti, të kontrollueshme, me kërkesë e dhënie llogarie në linjë shtetërore, partie e bashkimesh profesionale. Gjatë muajve të verës, administrata e Institutit forcoi kërkesën e llogarisë dhe ndihmën e grupeve në terren duke marrë pjesë në bashkërendimin e punës në terren me ndërmarrjet, duke i ndihmuar me mjete e bazë materiale fushore, duke marrë në dorëzim me grupe pune punimet në fund të sezonit, etj. Gjatë këtyre viteve u bë një punë



e madhe për kualifikimin e punonjësve. Nga asnjë punonjës me gradë shkencore në vitin 1978, më 1984 arritën në 12, vetëm për vitin 1983 në KSH janë miratuar 5 disertacione dhe janë të regjistruar 35 kuadro të tjerë në kualifikimin pas universitar. Pothuajse çdo vit janë organizuar konsulta e sesione shkencore për arritjet e Institutit në fushën e gjeologjisë, minierave, pasurimit e kimisë, janë organizuar kurse një e dy mujore për gjeologët rilevues, për kimistët, petrografët, mineralogët, etj.

Për t’u njohur me punën e kryer në Institut dhe për të kërkuar ndihmë për problemet që hasnim gjatë rrugës, vazhdimisht informohej Ministria dhe Organet e Partisë e të Pushtetit në Rreth e në Qendër, sidomos për vënien në jetë të studimeve të kryera. Por dy vitet e fundit u hasën shumë vështirësi, në kuptimin jo të drejtë të kërkesave të Instituit nga ana e Ministrisë e cila organizoi dhe një grup kontrolli, konkluzionet e të cilit përfunduan me një përplasje të madhe në prill të vitit 1984, me një drejtues të lartë Partie që ishte dhe ministër i Industrisë dhe Minierave, si rezultat i së cilës pas 6 muajsh, më nëntor të vitit 1984 Bashkim Lleshi transferohet, inxhinier gjeolog në NGJ Tiranë.

Pas 5 vite pune në Ekipin gjeologjik të Krastës së Martaneshit, një nga ekipet më të vështira të NGJ Tiranë, kolektivi i kësaj ndërmarrje, më mars 1990 nuk pranoi kandidaturën e paraqitur nga Ministria për drejtor ndërmarrje, por propozoi Bashkim Lleshin. Kur propozimi i kolektivit u dërgua për miratim në BP së Rrethit Tiranë, sekretari i parë Gaqo Nesho pyeti: -“Kush e njeh Bashkim Lleshin që kolektivi i gjeologjisë e ka propozuar për drejtor të NGJ ?”. Sekretari i I-rë i KPR 2 Isak Shehu u ngrit dhe tha: “Atë që nuk e bëri Partia për Bashkim Lleshin kur ishte në Institutin e Gjeologjisë e bëri kolektivi i Gjeologjisë së Tiranës që e zgjodhi drejtor të Ndërmarrjes.”

* * *

Drejtoria Gjeologjike e Ministrisë me aksion mbledh shkresa kundër ISPGJ

(Pjesë e shkëputur nga libri)

Pas botimit të artikullit të gazetës “Zëri i Popullit” të datës 24 mars, DGJ e MIM, ngriti një grup kontrolli për Institutin dhe u hodh në aksion për të mbledhur shkresa që i përgatisnin vetë dhe u mernin firmat disa drejtuesve servilë të ndonjë ndërmarjeje gjeologjike ku ankoheshin për bashkëpunimin jo të mirë me Institutin. Një shkresë e tillë e përgatitur nga drejtori i Drejtorisë Gjeologjike H. Caslli dhe specialistët e Ministrisë A. Kodra e L. Goci, është firmosur nga k/gjeologu NGJ Burrel S. Bello, në emër të drejtorit të kësaj ndërmarje B. Duva, ku ankoheshin për bashkëpunim jo të mirë dhe moskryerje të detyrimeve të Institutit karshi kësaj ndërmarje. Menjëherë pas firmosjes së kësaj shkrese, S. Bello u shpërblye nga DGJ duke e transferuar në NGJ Korçë.

Me shkresën nr. 376 datë 29. 3. 1984 me lëndë: “Për studimin e shpimeve të prognozës” drejtuar ISPGJ e për dijeni DGJ të MIM ato shkruajnë:

“Siç jeni në dijeni ndërmarrja jonë ka përfunduar disa shpime me karakter prognozimi në përputhje më projektet e miratuara, gjithashtu disa shpime të tjera janë duke u kryer. Jemi të mendimit që të dërgoni specialistët tuaj në mënyrë që të bëhet marrja e nevojshme sipas instruksioneve e kampionaturës për studime: petrografike, petrokimike, mineralogjike etj. gjë që deri sot nuk është bërë. Gjithashtu të dërgoni specialistët tuaj të sektorit të shpimit për të parë në vend mundësitë e çuarjes në projekt të disa shpimeve po me karakter prognozimi që kanë komplikacione gjeologo-teknike, që deri më sot nuk kemi mundur t’i kapërcejmë si psh në zonën e Lusës (prerja B-B) etj. Në rast se studime të tilla nuk do të bëhen në kohën e duhur, ne nuk do të lejojmë kryerjen e shpimeve të tjera me karakter prognozimi, qofshin këto edhe të miratuara, as në masivin e Bulqizës, as në atë të Lurës.

Ju lutemi që këtë problem ta vlerësoni me përparësi në mënyrë që studimet e nevojshme për shpimet prognozë të kryera, të përfundojnë sa më parë, që në këtë drejtim puna të mos pengohet e të eci normalisht. ”

Drejtori Bashkim Duva
Firma është e kryegjeologut Spiro Bello

Shkresa e nisur nga Burreli më 29. 3. 1984 erdhi dhe u protokollua në Institut më 31. 3. 1984. Porsa e mora këtë shkresë thirra në drejtori specialistin e shpimit K. Karabina i cili nuk kishte as dy ditë që ishte kthyer nga Burreli dhe më rraportoi se puna e shpimeve prognozë po ecën normalisht dhe nuk kemi asnjë shqetësim në këtë drejtim. Kur u paraqit Kiçua në zyrën time i thashë: -*“Para dy ditësh më raportove se në Gjeologjinë e Burrelit ecuria e shpimeve është normale dhe nuk kemi asnjë shqetësim, por kjo shkresë e ardhur nga Burreli flet ndryshe nga ato që më keni raportuar mua në drejtori. Prandaj do të marrësh këtë shkresë e do të shkosh në Burrel, të takosh drejtorin B. Duva dhe ta sqarosh këtë problem. Lidhur me sa shkruhet në këtë shkresë për problemin e shpimit duhet të më raportosh me shkrim pasi të kthehesh nga Burreli”*

Sipas porosisë që i dhashë inxh. K. Karabina shkoi në NGJ Burrel me shkresën e ardhur dhe mori kontakt me drejtorin B.Duva. Pasi i tregon shkresën që kishte nisur ai për në Tiranë, ai i thotë se: *“Këtë shkresë nuk e kam firmosur unë por pa dijeninë time e ka firmosur kryegjeologu Spiro Bello, duke mos shkruajtur emrin e tij sepse ka të drejtë firme, por duke shkruajtur emrin tim dhe duke firmosur për mua. Bile kjo shkresë është përgatitur në klubin e Burrelit nga Haki Caslli, Alaudin Kodra e Lulzim Goci dhe është firmosur po në klub nga Spiro Bello. Pasi kanë marrë këtë firmë janë nisur për në Tiranë pa ardhur fare në ndërmarje. Pas një jave si shpërblim për firmën e dhënë Spiro Bello, me urdhët të Ministrisë u transferua në Gjeologjinë e Korçës” (Bashkim Duva, Burrel, prill 1984)*

Pas këtij informacioni K. Karabina u kthye në Institut dhe më informoi me shkrim se çfarë i kishte thënë drejtori i NGJ Burrel. Pas një jave unë nisem me shërbim në Bulqizë dhe u ndalova në NGJ Burrel ku u takova vetë me drejtorin Duva. Kur e pyeta se pse ishte bërë një veprim i tillë nga k/gjelogu Bello, ai më shpjegoi edhe një herë ato që i kishte thënë specialistit të shpimit të Institutit K. Karabina. Unë i thashë se për këto që i ke thënë K. Karabinës të cilat m’i përsëriti edhe mua, mund të lindë nevoja e ndonjë ballafaqimi se unë nuk do ta le me kaq. U ndamë me drejtorin Duva se do të ishte i gatshëm të ballafaqohej për këto që kishte thënë, kurdo dhe kudo që unë ta kërkoja dhe sipas tij do të thoshte të njëjtat fjalë. Po atë ditë grupi i MIM me në krye drejtorin Caslli niset nga Burreli dhe nuk erdhi në Tiranë por shkoi në NGJ Shkodër dhe mori një shkresë kundër Institutit nga k/gjeologu E. Delaj.

Shumë vite më vonë në bisedë e sipër inxhinieri e shpimit Astrit Hafizi që punonte në EGJ Batër tregon: *“Nga mesi i muajit mars 1983 vijnë me shërbim në Batër drejtori i DGJ të MIM Haki Caslli me specialistët A. Kodra e L. Goci dhe në darkën me gjeologët e Ekspeditës në Batër u bëjnë presion gjeologëve F. Çollaku e Q, Lena të shkruajnë një letër e t’a dërgojnë në MIM kundër Institutit, por ato nuk pranuan...”*. Me qënë se me gjeologët e vjetër të Burrelit nuk ia arritën qëllimit këtë detyrë e plotësuan me k/gjeologun S. Bello të cilin e shpërblyen, duke e transferuar në NGJ Korçë.

Rruga e Arbërit nr. 171

Sefedin Pustina – kryetari i Qeverisë Provizore të Dibrës, e formuar më 23 shtator 1913 dhe Aqif Lleshi - kryetari i parë i qytetit të Dibrës, të zgjedhur menjëherë në nëntor të 1945, dy personazhe që kanë lënë gjurmë në historinë e qytetit të Dibrës e më gjerë në gjysmën e parë të shekullit të XX.

Mbi aktivitetin e Sefedin Pustinës dhe Aqif Lleshit

Prof. dr. **NEBI DERVISHI** *

Më 23 shtator 2020 në qytetin e Dibrës inagurohen dhe përurohen dy shtatoret (bustet) e derdhura në bronx kushtuar Sefedin Pustinës dhe Aqif Lleshit, i pari kryetar i Qeverisë së Përkohëshme-provizore të Dibrës e dalur më 23 shtator 1913, pas Kryengritjes së Shtatorit në Dibër dhe figurës së dytë, kryetarit të Komitetit Ekzekutiv të Dibrës së Madhe më nëntor 1945-shtator 1950 dhe deputet në Kuvendin Republikan të Maqedonisë e në Kuvendin Federativ të Jugosllavisë. Këto dy figura, Sefedin Pustina dhe Aqif Lleshi janë dy figura dibranësh që vepruan në gjysmën e parë të shekullit XX-të dhe kanë lënë gjurmë në historinë dibrane e më gjërë.

Sefedin Pustina lindi në Dibër në një familje me tradita atdhetare, pronar i një kulle dhe çifligu në fshatin Livadhi të Strugës, i cili mori pjesë aktive si udhëheqës popullor në Kryengritjen e Shtatorit 1913, e cila ishte kryengritja e parë antiserbe me përmasa të gjëra, që popullsia shqiptare e trevave lindore dhe verilindore (Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare) të aneksuar nga Serbia e Mali i Zi, ndërmori për t'u bashkuar me shtetin e pavarur shqiptar.

Kryengritja e Shtatorit 1913 apo e Dibrës u shkaktua nga pasojat politike dhe ekonomike të coptimit të Shqipërisë nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër në vitin 1913, si dhe nga politika e dhunës, shfarosjes dhe shpërnguljes së popullsisë shqiptare, që Serbia dhe Mali i Zi zbatuan në teritoret e aneksuara të Kosovës dhe në viset lindore dhe veri lindore të Shqipërisë. Ajo u organizua dhe drejtua nga udhëheqësit kosovarë që ndodheshin në shtetin shqiptar, në Vlorë si: Hasan Prishtina, Bajram Curri, Isa Boletini si dhe Elez Isufi, S.Hoxha, etj.

Kryengritja filloi me sulmin në një front të gjërë nga Dibra e Ohri deri në Prizren e Gjakovë. Më 20 shtator u hodhën në kryengritje forcat e armatosura të popullsisë së Dibrës së Poshtme (Peshkopisë), midis të cilëve kishte dhe mjaft dibranë e kosovarë të shpërngulur të drejtuar nga Elez Isufi, që më 22 shtator 1913 çliruan Peshkopinë.

Më 23 shtator 3000 kryengritës, së bashku me popullsinë e qytetit çliruan Dibrën e Madhe. Në udhëheqje të kryengritjes në krahinën e Dibrës përveç Elez Isufit u vunë atdhetarët si: Shqair Jegeni, Sadullah Strazimiri, Riza Gjakova, Shyqyri Jegeni, Qamil Daci, Sefedin Pustina, etj.

Pas çlirimit të Dibrës forcat kryengritëse i vazhduan veprimet e tyre luftarake kryesisht në tri drejtime. Numri i kryengritësve në këto momente arrinte në rreth 12 mijë vetë që u ndanë: në drejtim të Mavrovës dhe më tej drejt Gostivarit; në drejtim të Kërçovës dhe në atë të Strugës dhe të bashkoheshin me forcat kryengritëse të cilat drejtonin nga Qafa e Thanës për të çliruar Strugën e Ohrin.

Kryengritësit, pasi çliruan qytetin e Dibrës së Madhe, më 23 shtator 1913 pa humbur kohë formuan Qeverinë e Përkohëshme Provizore prej gjashtë vetësh, kryesuar nga Sefedin Pustina, e cila në këto momente dramatike u mor me organizimin dhe koordinimin e veprimeve luftarake.

Kryengritja e Shtatorit 1913 ishte fitore politike, ushtarake dhe morale. Si e tillë u shoqërua me ndryshime të tjera cilësore. Kjo krijoi kushtet për shkatërrimin e administratës së ngritur nga serbët dhe ngritjen e administratës së re, me cilësi e obligime të reja. Siç del edhe nga korespondenca e parë e saj me Prefekturën e Elbasanit dhe me kryetarin Aqif Pashë Biçaku, ajo njihet me emrin "Qeveria Provizore e Dibrës". Ndërkaq Ismail Strazimiri, pak vite më vonë të njëjtën "qeveri" e quan "komision administrativ", emërtim ky më i pranueshëm.



Në Dibër të Madhe përurohen bustet e **Sefedin Pustinës** dhe **Aqif Lleshit**

Më 23 shtator 2020 Komuna e qytetit të Dibrës së Madhe organizoi një ceremoni për inagurimin e busteve të dy prej figurave patriotike, ish kryetar të pushtetit vendor në Dibrën e Madhe, Sefedin Pustinës dhe Aqif Lleshit. Jo rastësisht ishte zgjedhur kjo ditë, mbasi është datë e shënuar nga më të rëndësishmet në historinë e Dibrës.

Më 23 shtator 2013 kryengritja e popullit të Dibrës triumfoi mbi ushtrinë serbe që kishte pushtuar Dibrën duke hyrë në histori si dita e çlirimit të Dibrës nga pushtuesit serbë.

Qyteti i Dibrës kish veshur petkun e festës. Kudo ndjehej një atmosferë gjallëruese e gëzuar dhe optimiste. Kryefjala e bisedave ishte lufta heroike e dibranëve kundër serbëve, italianëve e gjermanëve, guximi dhe trimëria e Sefedin Pustinës dhe Aqif Lleshit, roli dhe kontributi i tyre në luftën për çlirim dhe për forcimin e pushteti të popullit të ëndërruar prej shekujsh.

Në sheshin para Komunës së qytetit të Dibrës në ora 1200 erdhën qindra qytetarë të Dibrës së Madhe, të fshatrave rreth saj, të ftuar nga Tirana, Peshkopia, Bulqiza, pjesëtarë të familjeve Pustina e Lleshi, etj. Ishin të pranishëm dhe kryetari i Këshillit Komunal të Kërçovës z. Aqif Mediu, kryetari i KK të Gostivarit z. Besim Memeti, kryetari i KK të Strugës z. Resul Kaba, kryetari i KK të Tetovës z. Bekim Memeti, kryetari i Kuvendit të Zhelinës z. Liridon Seini, kryetari i qytetit të Shkupit z. Zahir Bekteshi, kryetari i Këshillave të Dibrës i katërzuar z. Adil Adili, kryetari i Qendrës së Skënderbeut Zhupë z. Femi Skënderi, kryetari i këshillit të Bashkisë Peshkopi z. Sokol Sava, veteranë e pjesëtarë të familjeve të dëshmorëve, të luftës, pasardhës të familjeve të Sefedin Pustinës dhe Aqif Lleshit, kryetarë të këshillave të fshatrave të Dibrës, etj.

Ishte e pranishme dhe deputetja e Kuvendit të Shqipërisë znj.Almira Xhembulla.

Akademinë e hapi inisiatori i këtij evenimenti, kryetari i Këshillit të Komunës së qytetit të Dibrës z. Bashkim Mashkulli, i cili përshëndeti të gjithë pjesëmarrësit e kësaj ceremonie. Të pranishmit i përshëndeti dhe kryetari i Komunës së qytetit të Dibrës z. Hekuran Duka.

Ligjëratën për veprimtarinë patriotike, luftarake dhe qeverisjes së Sefedin Pustinës dhe Aqif Lleshit në Dibrën e Madhe respektivisht në vitet 1913 dhe 1945-1950 e mbajti Prof. Dr. Nebi Dervishi historian dhe pedagog në Universitetin e Tetovës.

Në emër të familjeve të Sefedin Pustinës dhe Aqif Lleshit përshëndetën Agim Pustina dhe Gëzim Lleshi. Ata falënderuan kryetarin e Këshillit të Komunës, kryetarin e Komunës dhe gjithë qytetarët e Dibrës së Madhe për vlerësimin e madh e të merituar që u bënë këtyre dy figurave të rëndësishme historike të Dibrës. Drejtuesit e Komunës bashkë me përfaqësuesit e familjeve zbuluan busttet prej bronxi të përgatitur nga skulptori dibran Fitim Sula dhe derdhur në bronx nga Xhelil Rufati.

Me një ndjenjë krenarie, me vlerësime shumë pozitive që bën Këshilli dhe Komuna e Dibrës së Madhe për të gjithë patriotët që kanë shkrirë energjitë dhe forccat e tyre mendore e fizike në dobi të çështjes kombëtare. Pjesëmarrësit u larguan duke marrë me vehte mbresat më të mira e urimet për sa më shumë veprimtari tjera të kësaj natyre. Komuna dhe kryetari i saj z.Hekuran Duka shtruan një pritje për nder të mysafirëve dhe familjeve të Sefedin Pustinës dhe Aqif Lleshit. Në drekën e shtruar u dhanë kujtime dhe u shkëmbyen eksperienca për t'i çuar më përpara këto veprimtari në respekt të luftëtarëve dhe të rënëve për liri e pavarësi. Kështu ruajmë e forcojmë identitetin tonë kombëtar, edukojmë rininë me ndjenjat patriotike e atdhetare. Pritja kaloi në një atmosferë të ngrohtë e miqësore.

(Korres. Rr.A)

Qeveria e Përkohëshme e Dibrës ndonëse jetoi pak, afro 10 ditë, në kushte tepër të vështira, kreu një aktivitet të admirueshëm. Një sërë letrash, korespondencash e telegramesh dëshmojnë angazhimin e saj në drejtim të kurorëzimit me sukses të kryengritjes, për ngritjen e përsosjen e pushtetit të lidhur me Vlorën, për sigurimin e rendit e të qetësisë publike, për problemet social-ekonomike dhe ç'ka është më e rëndësishmja, për të kundërshtuar vendimet e padrejta të Fuqive të Mëdha lidhur me kufijtë. Një sërë dokumente hedhin dritë në faktin se "Qeveria e Dibrës" ose e Sefedin Mehmet Sulejman Pustinës, u lidh me Qeverinë e Përkohëshme të Vlorës në mënyrë indirekte, nëpërmjet Prefekturës së Elbasanit dhe të Aqif Pash Biçakut-prefekt i saj. Nëpërmjet saj ajo i bënte prezent sukseset e kryengritësve shqiptarë dhe shqetësimet e mëdha, të cilat, në më të shumtën e rasteve, shpreheshin në nevojën për armë dhe minicion. Krahas kësaj me ngritjen e administratës së re, ajo insistonte në nevojën që ka për njerëz të zotë, që të dijnë të punojnë, pasi siç theksohej në një telegram, punët më me vështirësi e me rrezik paraqiteshin tani e tutje.

Ndonëse me mundësi tepër të kufizuara, kryesisht për nevoja urgjente pune, u morën masa për rregulimin e rrjetit ndërlidhës me Strugën. Përpjekje u bënë për organizimin e xhandarmërisë dhe të shërbimit shëndetësor, duke kërkuar 2-3 mjek, etj. Duhet pranuar se Qeveria Provizore e Dibrës jetoi afër dhjetë ditë dhe punoi në kushte tejet të vështira. Madje ishin këto arsyet që nuk u mundësuan lidhjet me zonat e tjera të Dibrës dhe me fshatrat që gravitonin në qytet. Vetëm nga një korespondencë e Sefedin Pustinës, kryetar i Qeverisë Provizore (të Përkohëshme) të Dibrës me prefektin e Elbasanit, Aqif Pashën, mësojmë se në Dibër të Poshtëme vepronte një komision i thjeshtë administrativ, por edhe ky siç u theksua më sipër u ngrit si rezultat i përpjekjeve të prefekturës së Elbasanit. Telegrami në fjalë shkruan për nisjen e Elez Isufit me dibranët në Gostivar, në ndjekje të forcave serbe.

Më 1 tetor 1913 në fillimin e kundër ofensivës serbe ndaj Dibrës, veprimtaria e Qeverisë së Përkohëshme të kryesuar nga Sefedin Pustina u bë e pa mundur. Në këtë situatë nga ana e Vlorës u ndërmor një hap taktik, duke porositur Haxhi Vehbi Agollin që të pranonte pushtetin ushtarak serb me qëllim që të mbante në dorë administratën serbe.

Kryengritësit, numri i të cilëve shumë shpejt arriti në 12 mijë veta, vunë nën trysni dhe para dorëzimit garnizonet serbe në Tetovë, Kërçovë e Resnje, si dhe u shtrinë në trevat lindore shqiptare deri në afërsi të Shkupit. Kryengritja e Shtatorit përfshin gjthashtu rrethin e Lumës, ku kryngritësit të drejtuar nga Ramadan Zaskoku e Qazim Lika, çliruan këtë krahinë dhe në harkun kohor 30 shtator deri 4 tetor u hodhën në sulm drejt Gjakovës e në zonën e Prizrenit, ku veprimet luftarake udhëhiqeshin nga Bajram Curri, Hysni Curri, Isa Boletini, Bajram Daklani e të tjerë. Gjatë këtyre luftimeve pati disa qindra të vrarë nga të dyja palët. Kryengritja, aty nga fundi i muajit shtator u shtri dhe në vise të tjera të Kosovës, të krahinës së Drenicës, në rrethin e Mitrovicës, madje edhe në trevën Veriore, në krahinën e Hotit, Grudës, Tuzit dhe Gucisë. Pra në udhëheqje të Kryengritjes së Shtatorit u vu një komision i posaçëm që mban emrin Qeveria e Përkohëshme e Dibrës e drejtuar nga atdhetari Sefedin Mehmet Sulejman Pustina. Gjithë dokumentacioni i kësaj qeverie përshkohet nga kërkesa e bashkimit të këtyre viseve me Shqipërinë. Në thirrjen drejtuar Fuqive të Mëdha më 15 tetor 1913, Qeveria e Dibrës kërkoi nga Europa që "t'u jepte Shqiptarëve të drejtat të rronin të lirë në Atdheun e tyre të njëshëm".

Edhe personaliteti i Aqif Lleshit ishte synonim i sfidave të brezit më të rinj. Është personalitet me vlera atdhetare me batica e zbatica dhe njëri prej figurave të shquara të dibranëve në vitet 40-50 të shekullit XX-të, e cila figurë duhet analizuar me objektivitet. Aqif Lleshi u lind dhe u rrit në familjen e Lleshajve, të njohur për kontributet në dobi të çështjes shqiptare. Në lëvizjen kombëtare u përfshi që në moshë të re, në kohën e Shpalljes së Pavarsisë së Shqipërisë, duke u shqetësuar për coptimin e trojeve shqiptare dhe padrejtësive që i bëheshin popullit shqiptar. Në vitet e luftës së dytë botërore (që nga 1942) u rrjeshtua në rradhët e LANÇ-së me shpresë se shqiptarët do të heqin qafe shtypjen serbe dhe pushtetin nazifashist në trojet shqiptare.

Aqif Lleshi iu kundërvu politikës së Beogradit për shkak të nëpërkëmbjes së të drejtës për vetvendosje dhe të vendimeve të Konferencës së Bujanit (31.12.1943, 1-2.01.1944).

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore Aqif Lleshi do të zgjidhet së pari kryetar i Këshillit të qytetit të Dibrës, mandej kryetar i Rrethit të Ohrit, si dhe deputet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë dhe në Kuvëndin Federativ.

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore 1945, trevat Lindore e Verilindore, përsëri ngelën jashtë shtetit amë, Shqipërisë dhe në kuadër të shtetit jugosllav. Ozna dhe pushteti ushtarak vendosin mbi jetën e shqiptarëve dhe mbi të ardhmen e tyre, pse ato ishin dora ekzekutuese e planit antishqiptar. Komandat dhe oznat serbe malazeze ishin zbatuese të urdhrave të Beogradit, Podgoricës dhe Shkupit.

Deputeti i krahinës së Rekës nga fshati Beliçicë, Zhivko Brahovski e qartësoi kryetarin e Këshillit Nacionalçlirimtar të Dibrës, Aqif Lleshin, lidhur më këtë shfarosje i cili koshte reaguar ashpër: "Kemi urdhër nga Llazar Kolishevski, bile edhe më lart që në rradhët e shqiptarëve duhet të bëjmë një pastrim të mirë. Elementët e zotë duhet të pastrohen qysh tani..."

Rritje të presionit të shqiptarëve në trevat lindore e verilindore pati dhe pas prishjes së marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik. Më 28 qershor 1948 u shpall Rezoluta e Byrosë Informative, më të cilën kërkohej që ushëheqja e Jugosllavisë t'u bindet urdhërave e kërkesave që vinin nga Moska. Meqënëse këto kërkesa KQ i PKJ-së nuk i pranoi, pasoi izolimi i plotë i Jugosllavisë nga ana e nënshkruesve të Rezolutës.

Shqipëria u bashkua me Rezolutën e Byrosë Informative prandaj marrëdhëniet ndërmjet Jugosllavisë dhe Shqipërisë u ndërprenë menjëherë. Kjo pati rrjedhoja shumë të rënda dhe e keqësoi më tej pozitën e popullit shqiptar në Kosovë dhe në viset e tjera etnike. Pushteti jugosllav shfrytëzoi rastin për të intensifikuar shtypjen dhe terrorin mbi shqiptarët. Vala e re e arrestimeve dhe e likujdimeve fizike e politike të shqiptarëve u intensifikua me pretekstin se ata ishin me Byronë Informative dhe i shërbenin shtetit amë – Shqipërisë. Gjatë kësaj fushate u dënuan 436 veta, prej të cilëve shumica përjetuan terret e burgut famëkeq të Goli Otokut si Qemal Agolli, Xhaferr Kodra, etj. Në shenjestër u vunë sidomos pjesëmarrësit e Konferencës së Bujanit, si dhe veprimtarë që luftonin për të drejtat kombëtare të popullit shqiptar si: Rifat Berisha, Xheladin Hana, Nexhat Agolli që u vra në prill të 1949, etj.

Në pozitë të vështirë ra edhe Aqif Lleshi i cili kishte një bagazh me veprimtari luftarake e politike që nga Kryengritja e Shtatorit 1913 dhe sfidat jetësore që pësoi kjo figurë, internimet, lufrat e veprimet politike, deri te aktiviteti i tij i LANÇ, si dhe pengesat e mëdha që ai si kuadër politik, deputet Republikan e Federativ, kryetar i Rrethit të Ohrit dhe kryetar i Komitetit Ekzekutiv të Dibrës së Madhe (nëntor 1945-shtator 1950), si dhe shumë atdhetarë të tjerë që e patën pësuar nga politika e Beogradit dhe ndjekja në çdo hap e UDB-së, e detyruan kryetarin e parë të Komunës së Dibrës pas Luftës së Dytë Botërore, Aqif Lleshin deri te akti i arratisjes së tij me gjithë familjen në Shqipëri më 4 shtator 1950.

Vendimi i Këshillit të Komunës së Dibrës për t'i hedhur në bronxë dhe për t'i përjetësuar dy figurat e dalluara të historisë së Dibrës:

Sefedin Pustinës – kryetarit të Qeverisë Provizore të Dibrës e formuar më 23 shtator 1913 dhe Aqif Lleshit kryetarit të parë të qytetit të Dibrës të zgjedhur menjëherë në nëntor të 1945 që drejtoi qytetin deri më 4 shtator 1950, është një punë e mençur dhe e qëlluar, sepse këto dy personazhe kanë lënë gjurmë në historinë e qytetit të Dibrës e më gjërë në gjysmën e parë të shekullit të XX-të.

Prof.dr.Nebi Dervishi, historian në Universitetin e Tetovës

homazh

Lamtumirë Naim Buci, botuesi dhe mecenati i librit dhe filozofisë!

Covid i merr jetën sipërmarrësit dhe botuesit të 'Dita 2000', mbështes i botimeve dhe i kolanës së Filozofisë Politike.

Largimi i njeriut të librit lë dhimbjen dhe boshllëkun më të madh, për arsyen e thjeshtë sepse mungesa nuk është vetëm individuale, por është kolektive, është një boshllëk që më shumë se të gjithë e ndjen shoqëria, e ndjen arti dhe kultura.

I tillë është edhe boshllëku i krijuar me largimin nga jeta të Naim Bucit, themelues dhe drejtues i shtëpisë botuese "Dita 2000". Një njeri me natyrë pozitive, që kontributin e tij më të madh e dha pikërisht në fushën e dijes, duke e promovuar nëpërmjet mbështetjes dhe shpërndarjes së librit, 'mediumit të përjetshëm' për formimin e njeriut.

Një njeri me ide liberale, natyrisht që edhe vizionin e kishte të tillë, duke qenë jo vetëm biznesmen në lëmin e shtypshkrimeve, por edhe një kontributor dhe sponsorizues i shumë botimeve.

"Dita 2000", ka qenë "shtëpia" e shumë shkrimtarëve të njohur shqiptarë dhe të huaj, duke i dhënë një vlerë të veçante sidomos lëmisë së përkthimeve. Kjo shtëpi botuese me mjaft reputacion, prej fillimit të aktivitetit në vitin 2000, ka qenë gjithashtu e angazhuar në botimin e librave shkollorë, por edhe në projektimin dhe prodhimin e materialeve reklamuese dhe promovuese.



Një hapësirë domethënëse "Dita 2000" i ka dhënë edhe filozofisë. Në bashkëpunim me Universitetin Europian të Tiranës, ajo ka botuar kolanën e Filozofisë Politike me 100 libra, të cilët kanë ardhur për lexuesin shqiptar nën kujdesin e Arben Imamit.

Një projekt i jashtëzakonshëm, njëkohësisht edhe risi për ambientin filozofik dhe kulturor në Shqipëri. UET, ashtu si një agora në poliset greke, mori iniciativën në promovimin e këtyre botimeve, duke shfaqur një tjetër dimension, sa të vështirë aq edhe të domosdoshëm për zhvillimin e shoqërisë, duke i kthyer ambientet e veta në mjedise ku gëlon diskutimi i çështjeve filozofike e politike.

Të gjithë ata që patën fatin dhe mundësinë të bashkëpunojnë me Naim Bucin, vlerësojnë kontributin e tij në fushën e botimeve, por mbi të gjitha theksojnë natyrën e tij njerëzore, duke e quajtur të veçantë dhe të pazëvendësueshëm.

Rektori i Universitetit Europian të Tiranës, Tonin Gjuraj, shpreh mirënjohjen për bashkëpunimin ndër vite, duke e quajtur një mik të vërtetë dhe të sinqertë të UET-së.

"Bashkëpunimi me z. Naim Buci, pronar i Shtëpisë Botuese "Dita 2000", ka qenë i ngushtë dhe i vazhdueshëm me UET, por spikat viti 2007 – 2008, me kolanën e Filozofisë Politike të përkthyer dhe përgatitur nga Z. Arben Imami. Z. Buci la pas një trashëgimi të pasur librash e botimesh serioze, të shtrirë në të gjithë vendin, shkollat, bibliotekat dhe bashkitë e vendit. Ai ishte dhe mbeti një dashamirës i librit, i palodhur, por mbi te gjitha, me energji pozitive dhe bashkëpunëtor i shkëlqyer. Ai ishte një mik i vërtetë dhe i sinqertë i UET-it, për bashkëpunimin e të cilit i jemi shumë mirënjohës", nënvizon Gjuraj.

Ish-ministri i mbrojtjes dhe pedagogu Arben Imami, tregon rrugëtimin e vet me botuesin, që nisi me disa botime modeste, për t'u kthyer pastaj në kolanë me 100 libra. Imami shprehet se Buci ishte një djalë më vizion, që e dallonte të mirën dhe të bukurën, ndërsa mungesën e tij si mik e quan të pashlyer.


"Me Naimin kemi ndarë një rrugëtim të gjatë si miq dhe bashkëpunëtorë. Filluam së bashku një projekt modest për botimin në shqip të një serie veprash të mendimit politik, i cili falë edhe përkushtimit të Naimit u shndërrua në një kolanë të Filozofisë Politike, e pashoqe në serinë e botimeve shqip. Naimi nuk ishte thjesht një biznesmen botues, por një djalë me vizion dhe intuitë për të dalluar të bukurën, të mirën të nevojshmen, prandaj dhe u bë pjesë e pandashme e rrugëtimit tonë të përbashkët në sjelljen e elitës së mendimit politik në gjuhën shqipe. Si mik, mungesa e tij do jetë e pashlyer, si bashkëpunëtor do mbetet i pazëvendësueshme", shprehet Imami.

Për Dr. Mentor Beqa, bashkëpunëtor i kolanës së Filozofisë Politike, kontributi i botuesit Naim Buci do të mbetet i paçmuar. Beqa e cilëson si një magnet që tërhiqte drejt vetes gazetarë e shkrimtarë, që ishte i gatshëm të rrezikonte në emër të dashurisë për njeriun.

"Naimi ishte magnet për të gjithë ne – profesorë, gazetarë, shkrimtarë – çdokush që kishte të bënte me letrën e shtypur. Kontributi i Naimit në botimet shqiptare do mbetet i paçmuar. Botimi i kolanës së filozofisë politike (mbi 50 tekste) ku unë pata kënaqësinë të jem bashkëpunëtor i tij, mbetet një xhevahir i hapësirës së mendimit shqip. Në një kohë kur industria e botimeve gjendet në trysninë e marketizimit, Naimi ishte i gatshëm të rrezikonte. Për ata që e njohën, e dinë se përse e bënte. Ai e donte Njeriun – i njohur a i panjohur – Naimi ishte i gatshëm të bënte gjithçka.

Kjo vetëdije mbi vlerën e njeriun e bënte Naimin kaq të veçantë dhe të pazëvendësueshëm për të gjithë ne që ndamë jo pak kohë me të, për të gjithë ata që janë të përfshirë në një mënyrë a një tjetër me botën e letrave shqipe', shprehet Beqa.

(Gazeta Liberale)



Naim Buci ka qenë një ndër të parët që ka dhënë një kontribut në lobimet për ndërtimin e Rrugës së Arbrit. Me një fjalë të mirë, por edhe me mbështetje financiare.

Në foto: Gjatë një ekspeditë në rrugën e Arbërit, maj 2013.

Naim Buci, ikja e një njeriu që e deshi shumë Lurën dhe Dibrën

Projektet për Lurën, për rrugën e saj, për kthimin e Lurës në një qendër të turizmit në vend, të zhvilluar e me perspektivë, ishin bisedat kryesore sa herë shiheshim. Ishte aq optimist për krijimin e "Union Lura" sa i buzëqeshnin sytë...

Lajmi për ikjen nga kjo botë të Naim Bucit, ishte një nga lajmet më të trishta të këtij viti.

Naim Buci ishte një nga miqtë më të hershëm në Tiranën e tranzicionit. E kam njohur kur kontribuonte politikisht në partinë Aleanca Demokratike dhe prej atëherë shiheshim shpesh.

Gjatë kohës që kam punuar si gazetar, Naim Buci ishte prej atyre që kërkonte të përcillej përmes shtypit lajmin e mirë. Lajmi për një rrugë, për një shkollë, për një botim të ri, një autor e veprimtari.

Më pas më është dashur të punoj me të dhe them se kemi ndarë së bashku plot vështirësi të punës e të jetës, por ishte prej atyre që optimizmin e kishte pakufi.

Projektet për Lurën, për rrugën e saj, për kthimin e Lurës në një qendër të turizmit në vend, të zhvilluar e me perspektivë, ishin bisedat kryesore sa herë shiheshim. Ishte aq optimist për krijimin e "Union Lura" sa i buzëqeshnin sytë...

Naim Buci ka qenë një ndër të parët që ka dhënë një kontribut në lobimet për ndërtimin e Rrugës së Arbrit. Me një fjalë të mirë, por edhe me mbështetje financiare.

Broshura, fletëpalosje, libra e plot materiale të tjera kishin dashamirësinë e tij dhe kontributin e tij modest, por me shumë dashuri. Kur rruga e Arbërit e nisur nga Tirana në vitin 2011, mbeti në mes, ai ia përcolli shqetësimin një njeriut të rëndësishëm në qeverinë e kohës, i cili nuk e besonte.

"A ikim të bëjmë ca fotografi, - më tha në telefon. Na duhet t'ia tregojmë dikujt e ti themi që nuk po punohet".

"Kur do të më vijë radha mua të sponsorizoj krejtësisht një numër" - më thoshte shpesh kur takoheshim. "Kur të shkojmë së bashku në Lurë dhe prej atje të shkruajmë reportazhin". Nuk u bëmë mbarë kurrë. Dhe kurrë nuk na shkonte mendja se kjo nuk do të realizohej... Por ndoshta një ditë do ta shkruajmë edhe reportazhin për Lurën me të njëjtën dashuri siç ai donte.

Dhe bisedat me Naimin ishin të hapura. Për autorë e krijues dibranë, për mundësitë që kishte dhe që donte, për hapsirat e botimit dhe promovimit. Dhe kurrë nuk do të harrohet që ngrihej vetë dhe bënte dhuratë botimet e reja. Kolanën e madhe të librave filozofikë, me të cilën krenohej. Dhe jo vetëm për ta, por për dhjetëra botime të tjera të Xhafer Martinit, Velo Cfarkut, Islam Çengës, Ahmet Prençit e plot të tjerë...

***

Ky vit ishte i trishtë për familjen Buci. Pas ndarjes nga kjo jetë të Sulejmanit, 5 muaj më parë dhe Sanijes para dy muajsh, ikja e Naimit, 54 vjeç, ishte një dhimbje e papërshkruar.

Ndarja nga kjo jetë e botuesit Naim Buci ishte një lajm i hidhur për të gjithë. Jo vetëm për familjarët, miqtë e tij, lurjanët mbarë, por për të gjithë shoqërinë.

Ai ishte një ndër botuesit më të mirë në vend, një i pasionuar pas librit dhe botimeve, një mbështetës i autorëve dhe krijuesve, një nga njerëzit e mirë të Lurës që do të na mungojë.

Naim Buci nuk ka qenë një njeri i mbyllur pas librit. Por ishte edhe i angazhuar në politikë që në fillimet e demokracisë. Ai shpeshherë ishte në prapaskenat e liderëve politikë, duke i mbështetur e inkurajuar për të mirën e Lurës, Dibrës dhe Shqipërisë.

Ishte një nga lobuesit më të parë për Lurën dhe një nga mbështetësit moral e financiar të Rrugës së Arbrit dhe autorëve dibrane, dhjetëra botime të të cilëve, u bënë të mundur falë ndihmës së Naimit.

Botimet "Dita Print", nën drejtimin e Naimit ka qenë një mbështetëse e fortë e autorëve të teksteve shkollore e universitare.

Naim Buci u lind më 3 tetor 1966 në Arrmallë të Lurës. Shkollën fillore dhe tetëvjeçare i ka mbaruar në vendlindje. Shkollën e mesme mekanike bujqësore në Shkozet, Durrës. Shkollën e lartë për Agronomi e në Institutin Bujqësor.

I martuar me Albina Lleshi nga Rubiku, me të cilën kanë qenë në një klasë në shkollë të lartë. Së bashku kanë punuar për dy vite si mësues në shkollën e mesme Arrmallë. Kanë dy fëmijë, Arlindin dhe Arjolën.

***

"Si mund të shkruaj për ikjen tënde në amshim! Për këtë ikje të beftë e të parakohshme!", shkruan një homazh për të profesor Adem Bunguri.

"Naimin e kam njohur si nxënës në shkollën 8 vjeçare Arrën-Mallë në vitet 1976-1979! Ishte nxënës i shkëlqyer dhe fëmijë i mrekullueshëm! Djali i dytë i Sulejman dhe Sanie Bucit, pas vëllait Jashar dhe para vëllait Shefki! Një familje e nderuar dhe shumë arsimdashëse! I mëkuar që në vogëli me ndjenjën e dashurisë për njerëzit dhe vendin, ai u bë një djalë me vlera, që nderonte Lurën dhe gjithë Dibrën! Si i rritur, ai e ruajti dhe e zhvilloj më tej fisnikërinë e familjes Buci, dhe me formimin, kontributin, sjelljet dhe mirësitë e tij, krijoj figurën e një të riu të plotësuar, të cilin të gjithë donin ta kishin mik! Në bisedën e fundit në telefon, folëm për projekte botimesh, por më gjatë folëm gjatë për hyjneshën tonë, Lurën magjepse, për ripyllëzimin e saj, për rrugën Kurbnesh-Lurë, që do ta lishte këtë "Zvicër" të vogël në mes të Shqipërisë, me Tiranën", e kujton profesor Bunguri.

***

Redaksia e gazetës u shpreh ngushëllimet familjarëve, bashkëshortes Albinës dhe fëmijëve Arlindi e Arjola, vëllezërve Jasharit dhe Shefkiut dhe gjithë miqve e shokëve të tij.

Ikja e parakohshme e Naimit do të na dhëmbe gjatë, por do ta kutjojmë gjithmonë të qeshur e të mirë!

BUJAR KAROSHI

Kushtuar Mustafa dhe Sanie Ndrekës

Përjetësisht bashkë

Nga **OSMAN XHILI**



Doktor Tafa është gjithnjë pranë familjes. Kudo nëpër shtëpi ka një pjesë të tijën, një dhuratë, një libër, një ditar, një fotografi. Në memoriet e tyre është trupi i tij, fytyra e qeshur, këshillat e vyera, duart që përkëdhelin. Profesore Sania ka shkruar disa poezi për bashkëshortin e saj, doktor Tafën. Ka dashur ta portretizojë, ta gdhendë në vargje, që të mos i ikë më e të jenë përjetësisht bashkë.

Doktor Mustafa Ndreka vinte nga Grykë Noka e Dibrës, një perlë e Dibrës, sa e bukur, aq dhe me tradita e histori. Familja e tij ishte e madhe, me plot vëllezër e motra, siç ishin dhe shumë të tilla në atë kohë. Aty, në qelizën familjare, shpirti i tij u mbrujt me dashurinë njerëzore, dashuri për familjen, profesionin, për njerëzit e tjerë, për atdheun.

Mustafai i vogël donte të bëhej i vlefshëm për të tjerët, por nuk dinte se si. Koha do ta mësonte e për këtë duhej punë e sakrifica, duheshin njohuri, që ai do ti fitonte hap pas hapi.

Kështu nisi rrugëtimi i jetës, i shkollës dhe i profesionit për djaloshin e ri. Fitoi një bursë studimi në shkollën e mesme mjekësore të Vlorës, që e përfundon shkëlqyeshëm. Tashmë ishte bërë i qartë profesioni i tij, drejtimi i jetës së tij. Dyert e universitetit hapen për të, për ti bërë akoma më të plota njohuritë e marra në shkollën e mesme. Pasi diplomimit me rezultate gjithnjë të shkëlqyera, doktor Tafa shkon në vendlindje. Atje do ti testonte njohuritë e marra, do t'ju shërbente njerëzve, gjë që aq shumë e kishte ëndërruar, si një engjëll i zbritur në tokë për ti shëruar të sëmurët.

Pesë vite në spitalin e Reçit, pesë vite ngarkuar me punë, që vetëm mosha e rinisë i përballon. Ata njerëz në dukje të sertë, ishin aq të dashur, po të depërtoje në shpirtin e tyre. Ishin bijtë e nipërit e atyre njerëzve që ishin kapur fyta fyt me serbin, në mbrojtje të atdheut e familjeve të tyre. Doktor Tafa u kishte dhënë mjaft atyre njerëzve, por dhe kishte përfituar mjaft në këmbim. I dukej se kishte kryer dhe një fakultet tjetër. Por dhe sa të tillë do të kryente doktori në të ardhmen? Gjithë jeta e tij do të ishte një binom i pandarë pune dhe shkolle.

Doktori i ri fiton të drejtën e një specializimi dy vjeçar në Tiranë, në fushën e pediatrisë. Gjatë atyre pesë viteve të para të punës ai kishte pasur shumë punë me fëmijët. Ata ishin më pak të imunizuar, nuk dinin të flisnin e të tregonin problemet dhe sëmundjet që kishin. Por ama kishin pafajësinë e moshës dhe doktor Tafa ishte lidhur pazgjidhshmërisht me këtë grup moshe, më e bukura e jetës njerëzore.

Në mbarim të specializimit dy vjeçar doktori do të kishte dashur të punojë në spitalin e Peshkopisë, aty ku kontributi i tij do të ishte më i madh, ku mjetet dhe infrastruktura spitalore ishte më moderne, por jo. Regjimi i kohës nuk i dha okejin, ndoshta duhej akoma kohë për këtë. Duhej të shkonte në Fushë Alie, ku vdekshmëria foshnjore ishte në një nivel të lartë. Kush më mirë se doktor Tafa mund ta realizonte këtë mision? Ashtu zemërthyer doktori merr rrugët e vendlindjes. Jo se nuk e donte atë, por mendonte se do të ishte më i vlefshëm, në spitalin e madh, ku nevoja ishte imediate. Katër vite të tjerë pas përvojës së Reçit, deri në prag të demokracisë. Doktor Tafa i kishte shtuar akoma më shumë njohuritë në teori e praktikë. Tashmë kishte krijuar dhe familje e kishin ardhur në jetë dy fëmijë të mrekullueshëm, Denisa dhe Darieli.

Shtëpia e tyre ishte afër dhe përballë spitalit. Një oaz qetësie e relaksi veshur me lule të shumta e gjelbërimin e pemëve. Për të tjerët mund të kishte pushim, por jo për doktor Tafën. Atëherë nuk kishte telefona dhe dera e e shtëpisë së tyre trokiste pa pushim. Trokisnin burra, gra, apo fëmijë, në çdo orë të ditës apo natës. Asnjëri prej tyre nuk e pati "luksin" të marrë një përgjigje negative, një jo prej gojës së doktor Tafës. Në jo pak raste dhe gjumi, buka, apo kafeja liheshin përgjysëm, në shërbim të shpëtimit të jetës së njeriut.

Profesore Sania, bashkëshortja e doktor Tafës tregon një rast të vitit të largët 1988. Ishte vjeshtë, një stinë ku era dhe shiu i linin vendin njeri tjetrit, apo shpesh dhe bëheshin bashkë. Gjethet e pemëve kishin humbur freskinë e dikurshme dhe binin një nga një. Një stinë e bukur, plot fruta, por dhe me shumë viroza e alergji të ndryshme. Dy fëmijët e çiftit ishin me kollë e temperaturë. U jepnim çaj dhe shurup dhe herë pas here u vinim termometrin. Shumë pak ndryshim kishin, ndaj e parashikonim një natë të vështirë. Kur ora po e kalonte nëntën, u dëgjuan trokitje në portë. Menduam se ishte era që frynte, por jo, trokitjet u bënë më të forta. Doktori hapi derën dhe dy burra u futën në sallon. Kishin një fëmijë të sëmurë në shtëpi dhe kërkonin doktorin të shkonte me ta.

-Nuk e sollëm këtu doktor, - tha njëri prej tyre, që me sa dukej qe babai. – Para pesë vitesh, këtu në spital ndërroi jetë djali i parë, ndaj dua të vish te shtëpia. Doktor Tafa mbeti në mëdyshje për një pjesë kohe. Nuk e dinte se sa kishte qenë ky segment, kur je nën presionin e kohës dhe duhet të marrësh vendime të mëdha. Nuk kishte lidhje kë të zgjidhte, jetën e fëmijëve të tij, gjendja e të cilëve mund të komplikohej në çdo çast, apo ti përgjigjej ftesës së atyre burrave , që e shihnin si shpëtimtar me sytë e tyre lutës? Tu thoshte që kam fëmijët e mi të sëmurë, ndoshta nuk do ta besonin. Fëmija e personit përballë ishte vetëm tre muajsh. Po nëse ai nuk shkonte dhe fëmija ndërronte jetë, a kishte më dinjitet njerëzor për ti dalë përpara? Kur e mori vendimin ca bula djerse i dolën në ballë.

Ashtu sfidant e altruist, si gjithmonë kishte zgjedhur tu shërbejë të tjerëve. Fëmijët e tij do ti linte nën kujdesin e të shoqes dhe infermieres së turnit. Doktori mori çantën e zezë, futi ilaçe e ndonjë serum në të dhe u nisën. Dera u mbyll dhe tre burrat u mbështollën nga errësira, që vështirë se çahej nga një fenerë dritëpakët që ata kishin marrë me vete. Në orën gjashtë të mëngjesit doktor Tafa u kthye në shtëpi. Dukej i lodhur e i pagjumë, por gëzimi që kishte shpëtuar fëmija ishte më i rëndësishëm për të. Menjëherë pyeti për fëmijët tanë dhe kur i pa disi më të qetë u lumturua akoma më shumë. Kjo ishte vetëm një grimcë nga ata mijërat që pati në jetë doktor Tafa e po ti bashkosh mund të bëhet një roman, aspak i trilluar e me fantazi, por mëse real, i shkruar me heroizëm e sakrifica të panumërta.

Vitet kalonin dhe doktor Tafa më së fundi pati luksin të punojë në spitalin e Peshkopisë. Tashmë ai kishte fituar një përvojë të vyer, falë praktikës e trajnimeve të shumta. Dibra kishte nevojë për infermierë e mami dhe doktori u vendos të ishte drejtor i këtyre kurseve e shkollave për specializimin e tyre, por njëkohësisht dhe në rolin e mësimdhënies. Profesionalizmi, aftësitë komunikuese dhe ndershmëria spikatën dhe njëherë akoma, duke shtuar pikë të reja në sivinë e doktorit që mbushej e mbushej .

Detyra dhe eksperienca të reja e presin akoma doktor Tafën. Shef shërbimi në poliklinikën e spitalit, inspektor i shëndetësisë në prefekturën e Dibrës e më pas drejtor i DSHP Dibër. Bilbil Hoxha, një nga bashkëpunëtorët e tij të dikurshëm, thotë se nuk mund të gjeje asnjë të çarë dhe asnjë mangësi në personalitetin e këtij njeriu të mrekullueshëm. Kudo fjalë të mira, kudo përkushtim, kudo vlerësime maksimale, për njeriun që sakrifikonte veten në shërbim të të tjerëve.

Vite më pas transferohet pranë A.R.Sh. së në Tiranë, si mjek pediatër për shkolla, kopshte e çerdhe. Ju përgjigj pa hezitim një kërkese për të punuar 6 muaj në Tropojë, dhe pse larg familjes, dhe pse tashmë mosha kishte ecur disi. Por tropojanët nuk e lëshuan për gjashtë muaj, e mbajtën gati dy vjet, duke përfituar shërbimet cilësore të doktor Tafës, këshillat e tij të vyera, fjalën e tij të ngrohtë.

Vitet ecnin pa u ndalur. Do të vinte një natë dimri e vitit 2010, kur zemra e tij pushoi. Ishte vetëm 57 vjeç, kur akoma shumë mund të jepte, kur akoma shumë jetë të tjera mund të shëronte. Ai kishte qenë vërtetë një qiri, që u kishte dhënë jetë të tjerëve duke konsumuar të tijën.

PPROFESORE SANIA

Ajo tashmë sapo ka dalë në pension dhe sërish i shkon mendja tek viti i largët 1984. Ishte viti, kur sapo qe diplomuar dhe dallgët e jetës e kishin përpirë, në përpjekje për të krijuar identitetin e saj. Kishte mbaruar në Shkodër për gjuhë e letërsi, në djepin e kulturës e të dijes. Do tu mësonte vogëlushëve gjuhën e bukur e të ëmbël, vargjet e Naimit, do t'u fliste për rilindasit e mëdhenj, do tu fuste në gjak dashurinë për librin, që më vonë të bëheshin dhe vetë shkrimtarë e krijues.

Filloi në shkollën e Sohodollit për tre vite e shumë shpejt e sheh veten si drejtoreshë në shkollën e Arrasit. Ishte vetëm 27 vjeç dhe kishte një kolektiv që dominohej nga burrat. Por ajo diti t'ia dalë mbanë , falë tolerancës, falë komunikimit njerëzor. Fitoi një eksperiencë që do ti duhej e do ti vlente gjithë jetës.

Pesë vjet të tjera jep mësim në shkollën e mesme "Gjergj Kastrioti",tamam aty ku lindi e mori jetë epopeja e heroit tonë kombëtar, Skënderbeut. Ajo i mëkoi mekëto histori të bukura e të lavdishme dhe nxënësit kurrë nuk i harruan rrënjët e tyre të ngulura thellë në këto troje. Tetë vite të tjera shërben si zv.drejtoreshë në shkollën 9 vjeçare "Selim Alliu" të qytetit të Peshkopisë, për tu larguar më pas, bashkë me familjen në Tiranë.

Ishte mbyllur një kapitull në vendlindje me plot mbresa, kujtime e arritje jo të pakta, me të cilat çdo kush do të ndjehej krenar. Ajo kishte kryer një sërë kualifikimesh e angazhimesh të tjera, jashtë procesit mësimor. Ishte trajnuar për metodat e reja të mësimdhënies, pranë organizatës "Save the children". Ishte trajnuar për braktisjen e fshehtë të nxënësit dhe kishte fituar disa miniprojekte. Ishte angazhuar në zgjidhjen e problemeve të dhunës ndaj grave e fëmijëve, duke qenë një zë i fuqishëm në mbrojtje të tyre. Ku ishin krijesat e dobëta, do të ishte dhe ajo për ti mbrojtur.

Profesore Sania nuk mbeti vetëm në suazën e mësimdhënies, por u ngjit në një stad akoma më të lartë, si krijuese. Për vite me radhë ishte bashkëpunëtore aktive e gazetës "Dibra". Në vitin 1997 sheh dritën e botimit libri i parë i saj me poezi, i titulluar " Ëndrra të vrara". Më pas shkruan " Një buqetë për grup moshat" dhe vetëm para një viti, një tjetër libër me poezi, i titulluar "Të jesh grua".

Jo më pak i vogël ishte kontributi i profesore Sanies në Tiranë. Punoi si mësuese gjuhe e letërsie në shkollat "Loudans", " Qazim Turdiu" dhe " Kongresi i Lushnjes". Nga viti 2010 dhe për shtatë vite në vazhdim shërbeu si drejtoreshë e kopështit privat " Fluturat".

Ne vetëm i cekëm shkurt këto stacione të jetës së saj, por secili prej tyre ka mbresat, kujtimet, historitë, gëzimet e trishtimet e veta specifike. Me siguri, profesorja me dellin e saj poetik, do ti sistemojë e do të na i japë në formën e një romani, që do të ketë shumë mesazhe për brezat e rinj.

PËRJETËSISHT BASHKË

Kur profesore Sania takoi për herë të parë doktor Tafën, iu duk se gjeti gjysmën tjetër të qenies së saj. Kishte qenë me një krah e tani i kishte të dy dhe kështu do të fluturonin së bashku në kohë e hapësirë. Të dy i kishte krijuar Zoti për të shëruar njerëzit, doktor Tafa për të shëruar trupin dhe ajo për të shëruar shpirtin njerëzor. Ardhja në jetë e fëmijëve e bëri akoma më të ngrohtë folenë që kishin krijuar.

Denisa e Darieli po rriteshin pak nga pak, silleshin mirë e mësonin shkëlqyeshëm, duke i bërë krenarë prindërit e tyre. Fotot e tyre kishin zënë vend në këndet e klasave ku mësonin, te tabela e më të dalluarve. Kështu ecën së bashku motër e vëlla, për tu ndarë vetëm nga profesionet që morën në jetë. Denisa studioi për psikologji, duke arritur me shumë meritë gradën e doktores së shkencave. Fati e njohu me Elvisin, me të njëjtin profesion dhe krijuan një familje të mrekullueshme me dy fëmijë po të tillë. Darieli ndoqi degën e administrim biznesit dhe tani punon te gjigandi i telefonisë " Vodafon".

Vazhdojnë plot energji në rrugën që u trasuan prindërit e tyre, duke i pasuar si modele të jetës. Por, dhjetë vite më parë, kur ata ishin akoma studentë, shpirti i babait të tyre fluturoi lart në qiell. Menduan se do tu mungonte, por jo.

Doktor Tafa është gjithnjë pranë familjes. Kudo nëpër shtëpi ka një pjesë të tijën, një dhuratë, një libër, një ditar, një fotografi. Në memoriet e tyre është trupi i tij, fytyra e qeshur, këshillat e vyera, duart që përkëdhelin. Profesore Sania ka shkruar disa poezi për bashkëshortin e saj, doktor Tafën. Ka dashur ta portretizojë, ta gdhendë në vargje, që të mos i ikë më e të jenë përjetësisht bashkë.

Shkëputur nga libri i autores Sanie Ndreka "Të jesh grua"

In memorie 4

Ka shekuj, bota është krijuar,
Kështu ka qenë, kështu do të jetë
Ku amanet një peng i madh
Ka për të mbetur në këtë jetë.

Gjithë jetën tënde ke dhuruar
Veç përkushtim e dashuri
Por ky dreq fati është i shkruar
Nga hera bën dhe ironi

Gjithë jetën tënde ke shëruar
Mrekullisht, engjëj fëmijë
Po ja që fati kaq tinzar
Ndonjëherë është dhe fat i zi.

Nëse një fjalë të fundit do më thoje
Këtë mundesha veç ta di
Apo m'i the gjatë gjithë jetës,
Ashtu siç dije vetëm Ti.

E di ç'kam humbur, mirë e di,
Ka bota gra e burra plot
Ar, smerald, margaritar.
Por unë kam humbur një thesar.

Që jeta ka dhe një fund
Kush lind, fort mirë këtë e di
Të na mbeten të shtrenjtat kujtime
Dhe dashuri në përjetësi!

in memoriam

I përjetshëm qoftë vetëm për mirë kujtimi i tij!

Një homazh për mësuesin dhe oficerin **Rushdi Spata**

Nga **ALI HOXHA**

Rushdi Xhetan Spata nga Blliçja, Çidhën, Dibër, ish-mësues mbi 20 vjet në periudhën e monizmit dhe ish-oficer i forcave të rendit publik pas viteve '90 deri sa doli në pension, pra person publik, ndërroi jetë në fund të gushtit 2020, në moshën 71 vjeçare nga "Corona virusi -19" duke na shkaktuar një hidhërim të madh jo vetëm familjes dhe të afërmve të tij, por edhe të gjithë neve, shokëve dhe ish-kolegëve të tij, me të cilin kemi pas punuar dhe për të cilin ruajmë kujtimet më të mira.

Me Rushdi Spatën jam njohur për herë të parë kur kemi punuar së bashku një vit të tërë, në vitin shkollor 1969-1970, kur ai filloi për herë të parë detyrën e mësuesit në shkollën 8-vjeçare të Sinës, e cila nga që kishte vetëm dy klasë (të pestën dhe të gjashtën) ende nuk e kishte statusin e drejtorisë më vete, por ajo varej nga drejtoria e shkollës 8-vjeçare të Grykë-Nokës, ku unë isha drejtor, edhe për shkollat e Sinës dhe të fshatit Mustafaj. Rushdiu në atë kohë ishte një djalë njëzet vjeçar, i cili sapo kishte përfunduar studimet e larta në degën e matematikës në Institutin Pedagogjik 2-vjeçar në Shkodër dhe po hidhte hapat e para në jetë. Përgatitja e tij shkencore dhe metodike ishte e përsosur. Si mësues ishte korrekt. Por ajo që unë tash plot 50 vjet rresht nuk e kam harruar për mirë dhe që nisur edhe nga proverbi latin "verba volant, scripta manent" (fjalët i merr era, fluturojnë, zhduken nga kujtesa, kurse e shkruara mbetet), dua ta theksoj e ta përmend për mirë edhe këtu që t'ua bëj të njohur edhe bashkëkohësve si dhe brezave të ardhshëm, që ta kenë si model, si shembull për mirë, një akt të Rushdiut, sa burrëror, po aq të guximshëm, nga i cili dalin në pah cilësitë më të mira të karakterit dhe të qëndrimit parimor në zgjidhjen e një problemi të caktuar, konkretisht sa vijon:

Në shkollën 8 vjeçare të Sinës, në vitin shkollor 1969-1970, përveç dy klasave në sistemin e ditës (kl.V dhe kl.VI) ndiqnin mësimet në sistemin e shkollës së mbrëmjes pa shkëputje nga puna dhe tri klasa (kl.V, VI, VII) me nxënës punëtorë kooperativistë. Por në fund të vitit shkollor, në qershor 1970, në shkollën e mbrëmjes nuk ishte realizuar programi mësimor as në masën 50% të orëve vjetore, sepse brigadieri i arave, njëherësh dhe sekretar i organizatës bazë të fshatit Sinë, pra si funksionar partie, për egon e vet personale që të fitonte lëvdata nga eprorët e vet, për sasinë e orëve të punës në brigadën e tij, i detyronte punëtorët në punë jo vetëm tej orarit tetë orësh, por ata që ndiqnin shkollën e natës dhe nuk i lejonte të ndiqnin shkollën e natës, përfshirë këtu edhe vetveten e tij, edhe pse një veprim i tillë ishte në kundërshtim me ligjet e shtetit, ndaj për të mos ua djegur nxënësve vitin mësimor kurse mësuesve orët suplementare të shkollës së natës, unë, si drejtor i zonës, mora miratimin nga seksioni i arsimit për t'i marrë nxënësit në provim me qëllim që atyre t'u njihej viti shkollor në formën e korrespondencës. Ndërkohë që po zhvillonim provimet me nxënësit e natës, njëri prej nxënësve të natës, F.P, mu pranë dritares së klasës ku po zhvillohej provimi, nga jashtë, po thërriste me zë të lartë duke ironizuar me vetveten: "Librat në librari, e ne merr klasën në Sinë!" (me nëntekstin se ne jo vetëm që nuk kemi ndjekur rregullisht shkollën, por nuk kemi pasur as edhe tekste shkollore përkatëse).

Në atë çast unë ndërpreva provimin dhe bëmë një mbledhje me dy mësuesit e asaj shkolle, njëherësh anëtarë të komisionit të provimit, para të cilëve u shtrova këtë alternativë:

"A e ndëgjuat ironinë e F.P? Ligji është i tillë që nëse kalojnë klasën mbi 50% të nxënësve , juve ju paguhen orët suplementare që keni bërë gjatë vitit, por nëse mbeten në klasë mbi 50% të nxënësve, atëherë juve ju "digjen", nuk u paguhen orët suplementare që keni bërë në shkollën e mbrëmjes. Ndaj para nesh shtrohet kjo alternativë:

Ose të mbajmë qëndrim parimor, të jemi objektivë dhe ta ruajmë dinjitetin tonë moral dhe integritetin intelektual e profesional, duke mos u bërë as liberale dhe as inatçi, por të kalojë klasën kush ta meritojë me të drejtë;



Për aq sa e kam njohur unë Rushdi Spatën, nisur edhe nga profesioni i tij i mësuesit dhe i oficerit të rendit për mbrojtjen dhe zbatimin e ligjeve të shtetit ligjor nga masat, pa dyshim që gjithë veprimtaria e tij profesionale ka qenë në shërbim të mësimit dhe të edukimit të brezit të ri dhe më gjerë...

Ose të tregohemi liberale, të humbim nderin dhe dinjitetin tonë personal moral dhe integritetin intelektual e profesional dhe të bëjmë lëshime dhe ju të merrni "pare e marre" për pasojë edhe unë jam i detyruar të vij pas jush, sepse unë nuk dëmtohem ekonomikisht si ju!"

Pas një heshtjeje prej disa minutash nga dy të pranishmit, meqenëse, mësuesi që ishte më i vjetër në detyrë, njëherësh dhe përgjegjësi i shkollës, të cilit i takonte të merrte fjalën i pari, ai nuk po fliste, atëherë heshtjen e theu mësuesi i ri, i vitit të parë në detyrë, 21 vjeçari Rushdi Spata, duke zgjedhur alternativën e parë si vijon:

"Ora e fundit e shkollës së natës mbaronte në orën tetë të darkës ose në orën njëzet siç thuhet zyrtarisht. Dhe unë kur nisesha nga Sina nisesha pas orës tetë të darkës, gjatë dimrit, nëpër shi e dëborë, në baltë e në lladosë, kur arrija në Blliçe, ora kishte kaluar dhjetë e darkës (ose njëzet e dy), por paret e mia do t'i hedh mu ke kamarja e urës dhe ato shkofshin teposhtë për Drini, prandaj do të kalojnë klasën vetëm ata që do ta meritojnë!"

Për atë vendim dhe qëndrim të drejtë dhe heroik, bile historik, pas përgëzimit të çastit nga ana ime me urimin: "Paç faqen e bardhë!" më pas vijuam provimet rregullisht. Si përfundim, nga të tri klasat e mbrëmjes vetëm një nxënës, i ndjeri Kasem Kadriu, meritoi kalimin e klasës së shtatë në provimet e qershorit, ndërsa të tjerëve, në lëndët me cikël të hapur, d.m.th me vijimësi në vite, në gjuhë shqipe dhe në matematikë, u krijuam mundësinë që të merrnin klasën në riprovimet e vjeshtës. Reagimi i ish-brigadierit, njëherësh dhe sekretar i org.bazë të Partisë së Punës në pushtet, për Sinën, qe i shpejt tek Instruktori i Partisë për Lokalitetin disa ditë më pas. Kur ma shtroi ankesën Instruktori i Partisë. Përgjigja ime qe si vijon: "Megjithëse kanë kaluar mbi 10 ditë, dhe për aq kohë mund të përgatitesh për më shumë se një lëndë, etj, por ti shko në Seksion të Arsimit dhe ngre një komision provimi në Peshkopi, por me një kusht: që përpara se ai ose cilido nga ankuesi që do të paraqiten në provim, unë t'ju dorëzoj juve diplomën time të Universitetit, ndërsa ai ose ato të dorëzojnë tek ju teserën e Partisë, me kushtin që nëse ai ose ata do të meritojnë kalimin e klasës, atëherë diploma ime do të digjet, ndërsa në rast të kundërt dokumenti i tij apo të tyre të mbeten në kasafortën tuaj, të Komitetit të Partisë!"

Edhe pse vlerësimet tona, të komisionit të provimeve për nxënësit e shkollës së natës të Sinës ishin të pakontestueshme, bile ishin dashamirëse, sepse qëllimi ynë ishte t'u jepnim mundësinë që në lëndët me cikël të hapur në vijimësi, nxënësit të përvetësonin programin mësimor gjatë verës, gjë të cilën disa vjet më pas, po njeri nga ata nxënës njëherësh edhe anëtar partie që ishte pjesëmarrës në ato provime, i ndjeri Shaban Tafa, disa vjet më pas, kur po vazhdonte shkollën e mesme bujqësore të mbrëmjes në Fushë-Çidhën, ai më ka deklaruar shprehimish:

"Ali! Kur na ngelët për vjeshtë në provimet e klasës së shtatë në shkollën e mbremjes në Sinë, të kam urryer me gjithë shpirt! Por tani që po vazhdoj shkollën e mesme, vetëm tani po e kuptoj se e paskam pas gabim, prandaj tani që po më jepet rasti, të kërkoj ndjesë dhe të falenderoj me gjithë shpirt, sepse po të mos ishit bërë ju shkak që ne të studionim gjatë asaj vere për të përvetësuar programin e mësimit, atëherë kurrësesi nuk do të kisha arritur që të vazhdoja shkollën më tej".

Reagimi im qe: "Qëllimi ynë për rastin konkret ishte që ne t'ju nxisnim që ju të studionit për të përvetësuar programin mësimor, për të mirën e të gjithë nxënësve. Po t'ju kishim dashur të keqen, atëherë do t'ju kishim vlerësuar të gjithëve me të gjitha notat dhjeta dhe nuk do të kishim asnjë përgjegjësi. Por, nëse do t'ju kishim dhënë klasën pa meritë, do të kishim bërë një krim, sepse krimi më i madh në arsim për një mësues është kur ai bën vlerësime subjektive, të pamerituara, në të dy senset e masës, si në rastin pozitiv, kur i jep notën pa meritë, aq më tepër në atë negativ, kur i mohon hakun (të drejtën, meritën) tjetrit."

U zgjata pak për sa sipër për të theksuar se akti i lartpërmendur i Rushdi Spatës, kur tha "... Paret e mia shkofshin teposht për Drini mu te kamarja e urës!", fjalët e tij kanë një kuptim filozofik me "peshë specifike" shumë të madhe:

Së pari, një qëndrim parimor i tillë i prerë, dhe pa u menduar gjatë, aq më tepër nga një djalë vetëm 21 vjeçar, nuk mund të ishte i rastësishëm. Me atë qëndrim e mendim të pjekur, ai argumentoi se geni i tij ishte trashëgimi e një fisi të përmendur për mirë, për atdhetari e mençuri jo vetëm në Çidhën, siç është fisi Spata, njëri ndër pesë pleqtë ose pesë "konaçet" e Çidhnës, por edhe më gjerë, në të gjithë Dibrën;

Së dyti, të mohosh e të sakrifikosh shpërblimin e punës një vjeçare në arsim, nuk është gjë e vogël, aq më tepër kur në atë kohë vlera e një ditë pune në kooperativën bujqësore arrinte në 30 lekë të vjetra, ndërsa në arsim me po aq sasi parash vlerësohej një orë mësimi suplementare në shkollat e asaj kohe. Mohimi dhe flakja e shpërblimit të mundimit të punës një-vjeçare, ishte një sakrificë shumë e madhe në aspektin ekonomik dhe për gjithë familjen. Në këtë aspekt nuk duhet harruar se vlera reale, fuqia blerëse në mallra e disa dhjetra mijëra lekëve të asaj kohe, në kohën e sotme do të barazohej me vlerën e disa milionëve. Prandaj duhet pas parasysh se një sakrificë të tillë jo kushdo mund të bënte as atëherë dhe as sot.

Së treti, që të mbahej një qëndrim i tillë si ai, është edhe një argumnt trimërie për personat pëkatës, sepse në rastin konkret të ndeshesh me kuadro drejtues të partisë, të cilëve u cënoheshin jo vetëm interesat materiale, por edhe egoja e shumë e shumë kuadrove duke filluar, së pari nga ish brigadieri, i cili njëherësh dhe sekretar i organizatës bazë të Partisë në pushtet, të cilit i kishin ngritur kultin vetvetes deri në atë shkallë sa që e konsideronin vetveten deri në "Perëndi", mbi ato që i kishin nën komandë etj, si në rastet kur shkelnin ligjet, nuk zbatonin as edhe ligjet e shtetit, si në arstin konkret kur brigadieri nuk lejonte kooperativistët për të shkuar në shkollë, edhe pse veprimi i tij ishte në kundërshtim flagrant jo vetëm me ligjet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, por ai veprim i tyre ishte dhe në kundërshtim flagrant edhe ligjet e shtetit të asaj kohe, në kundërshtim me politikën arsimore të Partisë së Punës për arsimin e masave. Pra Rushdiu ishte i qartë dhe i ndërgjegjshëm për të gjitha pasojat që mund të kishte pas atij qëndrimi, por atij nuk iu dridh as qerpiku i syrit dhe nuk i përfilli fare pasojat e mundshme, edhe pse ai ishte i ndërgjegjshëm për "cenin në biografi", qoftë nga dajat, apo edhe nga fisi Spata, i mirënjohur për atdhetari e nacionalizëm, kur ai mbajti atë qëndrim parimor, si një pinjoll i genit të fisit të vet. Prandaj pikërisht për atë krenari dinjiteti të lartë të Rushdiut dhe për mosnënshtrimin e tij ndaj ish-drejtuesve lokalë injorantë të asaj kohe, e transferuan më pas Rushdiun në zonat më të thella të Dibrës si në Lurë, Arrën-Mallë etj. Ndërsa pas viteve '90 pas ndryshimit të sistemit politik Rushdiu u angazhua si oficer në Forcat e Rendit të Policisë së Shtetit derisa doli në pension të pleqërisë.

Një parantezë: Nisur nga këshilla kur'anore në vargjet e para të sures "ABESE" (Ai u vrenjtë) e cila fillon me një qortim për Profetin tonë Muhamedin (a.s) me fjalët "Ai që u vrenjt dhe ktheu kurrizin, kur i erdhi pranë një i verbër për ta pyetur për diçka", në një moment kur Profeti (a.s) ishte duke biseduar me një person jobesimtar nga paria e Mekës, të cilin donte ta bindëte për të përqafuar Islamin, pra, përderisa Allahu i Madhëruar ka kritikuar edhe Profetin tonë H.Muhamedin (a.s) për një gjest kaq të vogël, për ne, të papërfillshëm, atëherë, është e natyrshme të konkludohet se ç'mund të thuhet për ne, njerëzit e thjeshtë?! Nënteksti filozofik i kësaj këshille kur'anore, thënë më qartë, është konkluzioni se nuk ka njeri të pagabueshëm në këtë jetë. Pra, nisuar nga ky këndvështrim, për të përcaktuar e klasifikuar një njeri nëse ai i përket kategorisë së njerëzve të mirë, apo kategorisë së të këqinjve, ne duhet të nisemi së pari, nga kriteri i nijetit, i qëllimit të veprimeve të tij, nëse ai ka pas qëllim me veprimin e tij për t'i bërë mirë apo keq tjetrit, pavarësish nga rezultati i veprimit, edhe nëse ai mund të përfundojë me rezultat të kundërt nga dëshira e autorit të veprimit;

Së dyti, duhet të nisemi edhe nga sasia e veprimtarisë së personit: nëse shumica e veprimtarisë së një personi ka qenë e mirë, duhet ta llogarisim në kategorinë e njerëzve të mirë.

Mbështetur në sa sipër dhe për aq sa e kam njohur unë Rushdi Spatën, nisur edhe nga profesioni i tij i mësuesit dhe i oficerit të rendit për mbrojtjen dhe zbatimin e ligjeve të shtetit ligjor nga masat, pa dyshim që gjithë veprimtaria e tij profesionale ka qenë në shërbim të mësimit dhe të edukimit të brezit të ri dhe më gjerë me njohuri shkencore dhe me ruajtjen e zbatimin e ligjeve shtetërore e njerëzore e rendit Rushdi Spatën në kategorinë e njerëzve të mirë. Veç sa sipër, edhe sikur të mos kishte bërë asgjë tjetër të mirë, por qoftë edhe vetëm për aktin e tij historik të lartpërmendur: "Paret e mia shkofshin teposhtë për Drinin...", Rushdi Spata, e meriton të renditet ndër ata burra që historia do ta përmendë për mirë. Ndaj edhe lutja ime për Rushdi Spatën është: "I përjetshëm qoftë vetëm për mirë kujtimi i tij!"

Aktin e ish-mësuesit Rushdi Spata: "Paret e mia shkofshin për Drini!" duke e krahasuar me gjendjen aktuale se në ç'derexhe është katandisur figura e mësuesit si ajo në rastin e kronikës në gazetën "Fjala" të datës 28 shtator 2020, fq.6-7, me titull: "Universitetet Publike" dhe me nëntitull: "Profesorët e korrupsionit, sezoni i provimeve apo sezoni i mitmarrjes", ku ndër të tjera theksohet:


"Universitetet publike në vendin tonë janë kthyer në burime korrupsioni ku gjatë sezoneve të provimeve këto institute, të cilat duhet të shërbejnë për dhënien e dijeve dhe formimin e studentëve kthehen në biznes. **Edhe pse këto vitet e fundit shumë pedagogë janë arrestuar apo janë vënë nën hetim për mitmarrje, sërisht nuk është bërë i mundur frenimi i këtij fenomeni negativ.** Por kush janë pedagogët e arrestuar ndër vite dhe sa para merrnin ata për dhënien e një note kaluese? ..."

Apo me fenomene të tjera më skandaloze si ai i publikuar në kronikën "Ç'kemi asaj Dibre" në gazetën "Rruga e Arbërit" të muajit shtator 2020 fq.2, ku mësojmë:

"Viti shkollor filloi dhe në këtë rast u zbulua se rrogën më të mirë e merr mësuesi që jeton në ... në Londër..."

Me këtë rast nuk do ta tepronim aspak, por e meriton plotësisht që t'u propozojmë organeve kompetente që në kujtim të aktit të Rushdi Spatës t'i ngrihej një bust m'u përpara Ministrisë së Arsimit, shoqëruar me një pllakë me mbishkrimin "Paret e mia shkofshin për Drini!"

Botime




800 lekë



700 lekë



1000 lekë




1500 lekë




1000 lekë



700 lekë



600 lekë



600 lekë



1000 lekë




1200 lekë



700 lekë




900 lekë



1000 lekë



1000 lekë




1500 lekë




1000 lekë




700 lekë



800 lekë



1000 lekë



500 lekë

BOTIMET M&B

mbbotime@gmail.com
069 20 68 603 / 04 22 33 283

Të gjitha botimet tona mund ti gjeni pranë librarisë sonë në Tiranë në rrugën "Isa Boletini", pranë kryqëzimit te Selvia; rrjetit të librarive "ADRION"; librari "Art's" të Stacioni i Trenit në Tiranë; FletaXXI *në Peshkopi ose mund ti porosisni përmes agjencive të shpërndarjes së librit ose online në* ëëë.bukinist.al

cyan magenta yelloë black